www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 81

Tiranë – E premte, 10 maj 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 36/2024, datë 18.4.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut"	9467
Dekret i Presidentit nr. 167, datë 8.5.2024	Për shpallje ligji	9468
Ligj nr. 38/2024, datë 18.4.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar"	9468
Dekret i Presidentit nr. 168, datë 8.5.2024	Për shpallje ligji	9470
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 2.5.2024	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024–2026	9471
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 8.5.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar	9536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 278, datë 8.5.2024	Për autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit), që, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, si autoritet shitës, të kryejë procedurat e ankandit publik të artikujve të ndryshëm për skrap	9542
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 8.5.2024	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi institucionit të Presidentit të Republikës	9542
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 8.5.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar	9545

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 282, datë 8.5.2024	Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës.....	9546
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 8.5.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar.....	9559
Urdhër i brendshëm i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 214, datë 2.5.2024	Për delegim kompetencash.....	9592

LIGJ
Nr. 36/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 107/2016, "PËR PREFEKTIN E QARKUT"

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, dhe 114 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pika 1 e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

"1. "Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.".

Neni 2

Në nenin 6 pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi, si dhe të mos i jetë hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni.".

Neni 3

Në nenin 8 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën "a" fjalët "vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave" zëvendësohen me fjalën "akteve".

2. Pas shkronjës "j" shtohen shkronjat "l" dhe "ll" me këtë përmbajtje:

"l) përcjelljen e kërkesës së arsyetuar për fillimin e inspektimit pranë institucioneve të ngarkuara me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit;

ll) ndërmarrjen e nismave dhe propozimeve për dhënien e titujve të nderit për persona me kontribut të veçantë në qark, sipas legjislacionit në fuqi.".

Neni 4

Në nenin 10 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Në rast të ndryshimeve strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark, ndryshimet i bëhen me dije prefektit të qarkut.".

Neni 5

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 12/1
Këshillat vendorë të sigurisë publike

1. Me propozimin e prefektit të qarkut pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ngrihen këshillat vendorë të sigurisë publike (KVSP) për identifikimin e problematikave për rendin dhe sigurinë publike në komunitet.

2. Për shqyrtimin e problematikave për sigurinë publike në komunitet, të identifikuara nga KVSP-ja, krijohet dhe funksionon Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKSK).

3. Përbërja, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike (KVSP) dhe të Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKSK) përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
Detyrat për mbrojtjen civile

1. Në raste të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës për Mbrojtjen për angazhimin e njësive të Forcave të Armatosura dhe kërkon mbështetje për përballimin e detyrave me

karakter civil dhe në veçanti në përballimin e situatave të emergjencave civile e të krizave.

2. Prefekti i qarkut i kërkon mbështetje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë.

3. Prefekti i qarkut koordinon në nivel qarku veprimet në terren të njësive të Forcave të Armatosura, të cilat angazhohen bazuar në deklarimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, me qëllim realizimin e detyrave me karakter civil, që u ngarkohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.".

Neni 7

Në pikën 2 të nenit 16 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalia hyrëse e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:".

2. Në shkronjën "a" të pikës 2 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar për problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi.".

Neni 8

Në pikën 1 të nenit 18 fjalët "sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave" hiqen.

Neni 9

Pas pikës 1 të nenit 22 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

"1/1. Nënprefekti zëvendëson prefektin sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

1/2. Parashikimet e nenit 7 të këtij ligji për papajtueshmëritë e funksionit të prefektit zbatohen edhe për nënprefektin.".

Neni 10
Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 167, datë 8.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 167, datë 8.5.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 36/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016, 'Për prefektin e qarkut'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 38/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 82/2021, "PËR PËRKTHIMIN ZYRTAR DHE PROFESIONIN E PËRKTHYESIT ZYRTAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 7/1
Përjashtime për raste të veçanta

1. Përjashtimisht, përkthimi zyrtar mund të kryhet nga një person që nuk është certifikuar për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar, kur:

a) për shkak të ligjit përkthimi nuk mund të kryhet nga përkthyes zyrtarë të certifikuar;

b) gjuha e synuar ose gjuha e burimit nuk përfshihet në listën e gjuhëve të huaja të miratuar nga ministri i Drejtësisë, sipas shkronjës "ë" të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji; ose

c) shtetasi nuk mund të certifikohet ose nuk ka shprehje interesi për t'u certifikuar sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ministria, për nevoja të ushtrimit të kompetencave, sipas pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, si dhe organet që ligji u ka njohur të drejtën për përkthimin zyrtar të akteve ose të dokumenteve, sipas këtij ligji, për kryerjen e përkthimit zyrtar mund të kërkojnë ndihmën e:

a) misioneve diplomatike ose të posteve konsullore;

b) organizatave ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë ose institucioneve të Bashkimit Evropian; ose

c) autoriteteve të tjera të huaja.

3. Përkthimi zyrtar sipas këtij neni kryhet rast pas rasti dhe me shpërblim, i cili përcaktohet në marrëveshje me subjektin që do të kryejë përkthimin zyrtar. Ministria dhe organet që ligji u ka njohur të drejtën për përkthimin zyrtar të akteve ose të dokumenteve, sipas këtij ligji, mund të lidhin marrëveshje me subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, që zbatohet sa herë që përmbushet njëri nga kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, dhe lidhja e marrëveshjeve rast pas rasti nuk është eficiente.

4. Marrëveshja e përcaktuar në pikën 2 përmban parashikime për:

a) kryerjen e përkthimit zyrtar, duke vepruar me kujdesin e duhur, si dhe duke zbatuar kodin e etikës dhe rregullat e ushtrimit të profesionit;

b) zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "ç" të nenit 24 të këtij ligji;

c) masën e shpërblimit për përkthimin e kryer. Në përcaktimin e masës së shpërblimit mbahen parasysh, për aq sa është e mundur:

i. tarifat e përkthimit të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat, sipas nenit 11 të këtij ligji;

ii. tarifat e përkthimit që zbatohen në shtetin përkatës nga organizata ndërkombëtare ose autoritetet e tjera të huaja; dhe

iii. kostot për kryerjen e përkthimit.".

Neni 2

Në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 2 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) në shkronjën "a" fjalët "shqiptarë nga shtetet e huaja" zëvendësohen me fjalët "sipas legjislacionit procedural në fuqi";

b) në shkronjën "dh" pas fjalëve "tekstit të përkthyer" shtohen fjalët "në gjuhën shqipe".

2. Në pikën 3 në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi "dhe, kur është rasti, në përputhje me nenin 7/1 të këtij ligji.".

Neni 3

Në pikën 4 të nenit 16 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjat "a" dhe "b" fjala "dy" zëvendësohet me fjalën "një".

2. Shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja. Nëse për gjuhën për të cilën do të zhvillohet provimi, institucionet e arsimit të lartë nuk ofrojnë programe studimi ose kur asnjë përfaqësues nuk shpreh interesin ose nuk plotëson kriteret për përzgjedhje në komisionin e posaçëm, ministria u dërgon ftesën për shprehje interesi:

i. misioneve diplomatike ose posteve konsullore;
ii. organizatave ndërkombëtare, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë;
iii. autoriteteve të tjera të huaja; ose
iv. përkthyesve zyrtarë të certifikuar për gjuhën përkatëse.".

Neni 4

Në nenin 18 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
1. Në pikën 1 fjalët "Ministria pajis përkthyesin zyrtar" zëvendësohen me fjalët "Përkthyesi zyrtar dhe interpreti i gjuhës së shenjave pajiset";
2. Në pikën 2 fjalët "e cila lëshohet nga Ministria e Drejtësisë" hiqen.
3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:
"3. Forma, përmbajtja dhe karakteristikat e tjera të vulës dhe të kartës së identifikimit, si dhe rregullat për pajisjen e administrimin e tyre përcaktohen me urdhër të ministrit.".

Neni 5

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime:
1. Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
a) fjalia e parë shfuqizohet;
b) në fjalinë e dytë togfjalëshi "15 (pesëmbëdhjetë)" zëvendësohet me togfjalëshin "5 (pesë)".
2. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 6

Shkronja "c" e pikës 1 të nenit 35 ndryshohet si më poshtë:
"c) një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja. Nëse për gjuhën për të cilën është certifikuar përkthyesi zyrtar, institucionet e arsimit të lartë nuk ofrojnë programe studimi ose kur asnjë përfaqësues nuk shpreh interesin ose nuk plotëson kriteret për përzgjedhje në komisionin disiplinor, ministria u dërgon ftesën për shprehje interesi:
i. misioneve diplomatike ose posteve konsullore;
ii. organizatave ndërkombëtare, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë;
iii. autoriteteve të tjera të huaja; ose
iv. përkthyesve zyrtarë të certifikuar për gjuhën përkatëse.".

Neni 7

Në nenin 39 pika 2 shfuqizohet.

Neni 8
Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 3 të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 168, datë 8.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 168, datë 8.5.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 38/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 82/2021, 'Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 271, datë 2.5.2024

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MIGRACIONIN 2024-2030 DHE TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT 2024–2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024–2026, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, për të cilat në strategji dhe në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PASQYRA E LËNDËS
PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK
Hyrja dhe qëllimi i dokumentit
Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, dhe mësimet e nxjerra
Kuadri strategjik kombëtar
Kuadri ndërkombëtar dhe dokumente kryesore strategjike për Shqipërinë
Kuadri institucional
Arritjet dhe mësimet e nxjerra për periudhën 2019–2022
Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të migracionit
Zhvillimi i kuadrit ligjor
Qeverisja institucionale e migracionit
Bashkëpunimet rajonale dhe ndërkombëtare
Mësimet e nxjerra
Forcimi i sistemit të azilit
Prespektiva gjinore
Vizioni i strategjisë
Vizioni
Treguesit e ndikimit dhe treguesit e rezultateve
PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË
Qëllimi i politikës I: Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri
Qëllimi i politikës II: Zhvillimi i politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin social-ekonomik kombëtar/vendor
Qëllimi i politikës III: Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare
Qëllimi i politikës IV: Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme
PJESA III – MEKANIZMAT KOORDINUES, ZBATUES DHE MONITORUES
PJESA IV – PLANI I VEPRIMIT DHE ZBATIMI I BURIMEVE FINANCIARE
Shtojca 1: Formati i përmbledhur i planit të veprimit
Shtojca 2: Formati i kostuar dhe i detajuar i planit të veprimit
Shtojca 3: Formatet e pasaportave të indikatorëve
Shtojca 4: Formatet e masave prioritare

PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK

HYRJA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024–2030 pasqyron prioritetet e qeverisë së Shqipërisë për menaxhimin efektiv të migracionit. Ky dokument strategjik është shprehje konkrete e zotimit dhe angazhimit të qeverisë shqiptare për të trajtuar sfidat, në lidhje me menaxhimin e flukseve migratore, identifikimin e mundësive që ofrojnë mbrojtje dhe zgjidhje të qëndrueshme për migrantët, si dhe maksimizimin e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit. Hartimi i këtij dokumenti strategjik pasqyron njëkohësisht përpjekjet e përbashkëta të institucioneve për të bashkërenduar punën ndërmjet tyre, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve efektive për promovimin e të drejtave të migrantëve, si dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Strategjia është konceptuar si një udhërrëfyes vizionar që përshkruan qasjen strategjike drejt mirëqeverisjes së migracionit.

Në këtë dokument pasqyrohen aspiratat e qeverisë shqiptare për t'iu përgjigjur detyrimeve, në kuadër të agjendës kombëtare të integrimit në BE,

që ka të bëjë kryesisht me përmbushjen e detyrimeve të kapitullit 24 në fushën e azilit dhe migracionit, dhe kapitullit 23 për lëvizjen e lirë, si dhe detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara në këtë fushë. Për më tepër, formulimi i objektivave specifikë dhe masave prioritare është në përputhje me pesë shtyllat e planit të veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, strategjia plotësohet edhe nga Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (2021–2027) dhe, për sa i përket luftës kundër kontrabandës së migrantëve, nga Strategjia Kombëtare Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, si dhe nga angazhimi sipas një Aleance Globale Kundër Kontrabandës së Migrantëve, e nisur nga Komisioni Evropian në nëntor 2023.

Për sa i përket harmonizimit me politikat kombëtare, objektivat dhe masat e parashikuara në strategjinë e re janë të ndërlidhura me programin e qeverisë 2021–2025, ku një ndër prioritetet kryesore është vëmendja e shtuar ndaj promovimit të politikave për të maksimizuar përfitimet e migracionit për migrantët dhe shoqërinë shqiptare. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024–2030 bazohet gjithashtu në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE), e cila është një ndër dokumentet ombrellë të politikave që siguron zhvillimin e vendit në të gjitha fushat, në përputhje me drejtimet strategjike dhe në kuadër të integrimit të tij në BE. SKZHIE-ja e konsideron migracionin si një aspekt të rëndësishëm për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë.

Hartimi i këtij dokumentit të ri strategjik shënjon gjithashtu një moment të rëndësishëm në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian, prioritetit i cili udhëheq agjendën qeverisëse të vendit. Vlen të theksohet se në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integrimit të vendit në BE, ofrimi i një përgjigjeje të plotë ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit paraqet vizionin e qeverisë shqiptare në fushën e migracionit deri në vitin 2030. Si i tillë, vizioni i strategjisë është fryt i frymëzimit të lëvizjeve dhe trendeve globale migratore, të kombinuara me procese reformuese të vendit në përmbushje të standardeve ndërkombëtare dhe integrimit të Shqipërisë në BE. Në këtë drejtim, qëllimi strategjik është qeverisja efektive e migracionit përmes trajtimit dhe menaxhimit të çështjeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet migratore, me synimin për të rritur ndikimin e migracionit në zhvillimin e migrantëve dhe shoqërisë.

Vlen të përmendet se, zbatimi i strategjisë do të konsiderohet i lidhur ngushtësisht me realizimin e angazhimeve të qeverisë shqiptare, në kuadër të zbatimit të nismave ndërkombëtare dhe forcimit të partneriteteve me vendet e rajonit dhe të botës. Nevoja për të rritur në maksimum mundësitë që sjell lëvizshmëria dhe për t'u përballur me sfidat e saj është pranuar si e tillë me përfshirjen e migracionit në Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe me miratimin e Paktit Global për Migracion të Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt, dhe Paktit Global për Refugjatët. Në këtë këndvështrim, ky dokument strategjik është hartuar në përputhje të plotë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe më konkretisht me objektivin 10.7 për zhvillimin e "Politikave të mirëmenaxhuara të migracionit", si dhe objektivat e Paktit Global për Migracionin (PGM), të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt për përmbushjen e objektivave të SKZHIE-së, në lidhje me qeverisjen e migracionit. Shqipëria ka votuar pro miratimit të PGM-së dhe është angazhuar në mënyrë aktive në procesin e zhvillimit të tij, duke përfshirë disa takime konsultimi në nivel kombëtar dhe rajonal. Për këtë arsye, përzgjedhja dhe formulimi i objektivave të Strategjisë Kombëtare të Migracionit është bazuar në prioritizimin e objektivave të Paktit Global për Migracionin.

Për sa i përket ndërlidhjes me proceset dhe dokumentet strategjike ndërkombëtare, për hartimin e këtij dokumenti, janë marrë parasysh të gjitha konventat dhe marrëveshjet që mbrojnë të drejtat e migrantëve dhe promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024–2030 janë hartuar nga grupi ndërinstitucional i punës, i ngritur me urdhrin e kryeministrit nr. 9, datë 26.1.2023, si dhe në bashkëpunim me institucionet e përfshira në zbatimin e politikave dhe dokumenteve strategjike në fushën e migracionit. Procesi i hartimit të strategjisë është mbështetur me ekspertizë kombëtare dhe me ekspertizë ndërkombëtare, nga Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM).

Ky dokument politik do të shërbejë si instrumenti kryesor operacional për të bashkërenduar ndërveprimin institucional për

arritjen e katër objektivave strategjikë. Strategia ka përcaktuar detyrat kryesore të të gjitha institucioneve të përfshira për realizimin e masave konkrete, dhe e përcakton Ministrinë e Brendshme si një institucion lider në drejtim të menaxhimit të migracionit. Si e tillë, strategjia promovon qasjen e bashkëpunimit dhe gjithëpërfshirjes së të gjithë aktorëve që mund të kontribuojnë për arritjen e objektivave strategjikë. Kjo qasje nënkupton gjithashtu krijimin e një sinergjie midis institucioneve shtetërore, institucioneve të pavarura, shoqërisë civile, si dhe partnerëve ndërkombëtarë për të trajtuar sfidat e migracionit dhe për të kapitalizuar mundësitë e paraqitura nga migracioni, duke u përqendruar tek zhvillimi ekonomik, integrimi social dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve.

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL, ARRITJET DHE MËSIMET E NXJERRA

Kuadri ligjor

Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë sa i takon garantimit të të drejtave të migrantëve, ku përfshihet dhe zbatimi i të drejtave themelore për punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilat mbrohen nëpërmjet dispozitave të kuadrit ligjor kombëtar dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, veçanërisht instrumenteve, të tilla si:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së tyre (ICRMW);
- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr. 97 dhe nr. 143;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC);
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR);
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR);
- Konventa e vitit 1951 mbi Statusin e Refugjatëve dhe protokolli i saj i vitit 1967;
- Konventa për Statusin e Personave pa Shtetësi;
- Konventa mbi Zvogëlimin e Pashtetësisë.

Zbatimi i dispozitave të konventave të ratifikuara në lidhje me të drejtat e migrantëve në përgjithësi dhe punëtorëve migrantë, sigurohet nga legjislacioni kombëtar nëpërmjet ligjeve, akteve nënligjore, urdhrave apo udhëzimeve në fuqi.

E drejta parësore parashikohet nga ligjet themelore, të tilla si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i cili rregullon marrëdhëniet e punonjësve vendas dhe të huaj, dhe zbatohet njëlloj si për shtetasit shqiptarë ashtu edhe për të huajt, si dhe ligje të tjera kryesore, si: ligji nr. 79/2021; "Për të huajt"; ligji nr. 10/2020, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi"; ligji nr. 10221/2020, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", etj. Ndërkohë që legjislacioni dytësor është kuadri rregullator që buron nga këto akte ligjore, kryesisht vendime të Këshillit të Ministrave dhe urdhra apo udhëzime specifike që rregullojnë dhe lehtësojnë procedurat e qëndrimit të ligjshëm për të gjithë të huajt që dëshirojnë të jetojnë apo punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Legjislacioni kombëtar për migracionin, në përgjithësi, pasqyron parimet e konventave ndërkombëtare për të drejtat e migrantëve. Zbatimi i këtyre të drejtave realizohet nëpërmjet disa parimeve të përgjithshme si: respektimi i të drejtave të njeriut, mosdiskriminimi, mosnënshtrimi ndaj torturës, trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues, parimi i integritetit dhe dinjitetit, bashkimit familjar, garantimit të kujdesit shëndetësor, arsimimi, integrimi social, etj.

Më konkretisht, ligji "Për të huajt", si një nga aktet ligjore në përputhje me 18 akte të *acquis* të BE-së, garanton pajtueshmërinë e dispozitave të tij me të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtarë të ratifikuar, në mënyrë të veçantë për t'u siguruar që dispozitat e tij të jenë në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e të drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente. Ky ligj synon përmirësimin e fushës së të drejtave të të huajve, në drejtim të mbrojtjes së migrantëve dhe anëtarëve të familjes së tyre, refugjatëve dhe azilkërkuesve.

Ligji gjithashtu garanton të drejtën e qëndrimit apo punësimit të ligjshëm në RSH, nëpërmjet pajisjes me leje qëndrimi dhe leje unike, sipas disa kategorive përkatëse, siguron të drejtën për akses në programe dhe shërbime integrimi për të huajt, mundësinë e ofrimit më të mirë të informacionit, procedurave të lehtësuara për t'u pajisur me leje qëndrimi dhe leje unike, të drejtën e pajisjes me dokumente sipas standardeve ndërkombëtare të certifikuara, si dhe me dokumente të posaçme udhëtimi në raste humbjeje, dëmtimi, apo zëvendësimi të tyre. Në parashikimet e ligjit "Për të huajt" nuk përjashtohet dhe mundësia

apo e drejta e ankimimit në rrugë administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Sa i takon akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj, ato rregullojnë dhe japin hollësi lidhur me aspekte të rëndësishme të migracionit të rregullt dhe migracionit të parregullt. Më konkretisht, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, është akti kryesor që përcakton rregullat për kriteret, procedurat dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për hyrjen, qëndrimin e ligjshëm, si dhe trajtimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto rregulla përcaktohen sipas motivit dhe qëllimit të aplikimit, dhe lejojnë pajisjen me leje qëndrimi apo leje unike në Shqipëri.

Vendimi nr. 857, datë 29.12.2021, si një bashkëpropozim i ministrive përgjegjëse për të dhënat e migracionit në vend, përkatësisht Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratoi ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për të Huajt (REKH) në Republikën e Shqipërisë, si baza kryesore shtetërore që do të administrojë, mbledhë dhe përditësojë të dhënat për shtetasit e huaj. Konkretisht, nëpërmjet moduleve përkatëse ky regjistër do të përmbajë të dhëna lidhur me shtetasit e huaj të pajisur me vizë, me leje qëndrimi dhe leje unike, sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara, si dhe për personat me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Trajtimi i të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë, si dhe procedurat për sigurimin e asistencës në transit, procedurat e kthimit apo organizimin e operacioneve të përbashkëta të kthimit në rrugë ajrore, trajtohen në udhëzimet e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, duke u bazuar në direktivat përkatëse komunitare.

Gjithashtu, janë miratuar dhe shumë akte të tjera nënligjore, të cila rregullojnë bashkëpunimin e strukturave përkatëse për migracionin apo përcaktojnë dispozita rregullatorë, lidhur me procedurën e zgjatjes së afatit të qëndrimit, regjistrimit të të huajit në autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, pajisjes me ftesë paraprake, përcaktimit të vlerës së investimit për pajisjen me leje unike për investitorët, për miratimin e lejes unike, si dhe format e dokumenteve të ndryshme për të huajt, në rast humbjeje apo dëmtimi të tyre.

Edhe ligji nr. 10 2021, "Për azilin në RSH", si një akt ligjor i përafruar me Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit apo konventat ndërkombëtare, në dispozitat e tij parashikon si të drejtë themelore të drejtën për azil, për të gjithë shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët ndodhen jashtë territorit të vendbanimit të tyre, por për arsye objektive si: frika e persekutimit për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar apo të bindjes politike, nuk kërkojnë mbrojtjen e atij vendi.

Ndër parimet kryesore ku bazohet ky ligj, diktuar dhe nga Konventa e Gjenevës, vlen të përmendet parimi i moskthimit, ndërkohë që respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara dhe nga konventat e tjera ndërkombëtare, ndalimi i dëbimit, e drejta për lirinë nga tortura dhe trajtimi mizor, çnjerëzor dhe degradues, e drejta e procedurave dhe garancive ligjore për ndihmën juridike falas nga shteti, e drejta për kushtet minimale të jetesës, për kujdes shëndetësor, për arsimim, për punësim dhe trajnime profesionale, e drejta për bashkim familjar, për të pasur një përkthyes, apo dhe e drejta e ankimimit, mbeten kryefjala e këtij ligji.

Respektimi i të drejtave të punëtorëve migrantë sigurohet jo vetëm nëpërmjet kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, por edhe nëpërmjet veprimtarisë së të gjithë institucioneve që ushtrojnë aktivitetet e tyre në këtë fushë, organizatave të ndryshme jofitimprurëse dhe OJF-ve, apo organizatave ndërkombëtare që ndihmojnë Shqipërinë, si: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF). Po ashtu kontribut të vazhdueshëm dhe të vlefshëm për arritjen e standardeve evropiane në politikat migratore kanë agjencitë e Bashkimit Evropian, si: FRONTEX dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA). Këto organizma i përqendrojnë veprimtaritë e tyre te mbrojtja e të drejtave të njeriut, të të drejtave të fëmijëve, të të drejtave të grave dhe të të drejtave të grupeve të tjera të cenueshme. Nëpërmjet programeve apo projekteve të tyre, ato kanë ndikuar në përmirësimin e kuadrit ligjor, në përgatitjen e statistikave dhe studimeve të ndryshme, si dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore që merren me çështjet e migracionit. Përpjekjet e tyre bashkëpunuese

kontribuojnë, po ashtu, në sigurimin e të drejtave dhe mirëqenies së punëtorëve migrantë dhe popullatave të cenueshme.

Në përmbushje të angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e mbrojtjes, ligji nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", përcakton kushtet për dhënien e formave të ndryshme të mbrojtjes për azilkërkuesit, duke përfshirë statusin e refugjatit, mbrojtjen plotësuese dhe të përkohshme. Miratimi i ligjit ka përafruar kuadrin shqiptar të mbrojtjes me standardet e përcaktuara në Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Ligji përcakton procedurën për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, duke kërkuar që të ekzistojnë kushtet e duhura për një vlerësim gjithëpërfshirës të arsyeve për dhënien e statusit të refugjatit ose njohjen e statusit të mbrojtjes plotësuese dhe vendosjen e afateve kohore për shqyrtimin e kërkesës. Përcaktohen nocionet "vend i sigurt i origjinës", "vend i tretë i sigurt", "procedurë e përshpejtuar" dhe "aplikime dukshëm të pabazuara". Përshkruhen rrethanat në të cilat një person humb statusin e mbrojtjes ndërkombëtare. Ligji përcakton se në cilat kushte mund të kufizohet liria e lëvizjes së aplikantit ose mund të kryhet largimi i tij/saj nga territori i vendit. Parashikohen masa të dedikuara për të përballuar një trajtim të veçantë për personat që i përkasin kategorisë së veçantë, të përcaktuar përmes vlerësimit individual. Në veçanti, të miturve të pashoqëruar duhet t'u caktohet një kujdestar dhe t'u ofrohet strehim dhe kujdes i specializuar. Ligji përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatëve dhe përfituesve të mbrojtjes plotësuese. Brenda dy viteve nga marrja e mbrojtjes, refugjatët dhe personat që gëzojnë mbrojtje plotësuese kanë të drejtë për bashkim familjar nëse mund të dëshmojnë se kanë strehim të duhur, të ardhura të qëndrueshme dhe sigurim sëmundjeje.

Sa i takon reduktimit të pashtetësisë, në zbatim dhe të konventave kryesore në këtë fushë, është miratuar udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 87, datë 21.6.2023, "Mbi dokumentacionin dhe procedurën për aplikimin, vlerësimin, miratimin dhe refuzimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë". Qëllimi i miratimit të këtij akti është shpallja apo dhënia e statusit të pashtetësisë, të gjithë atyre shtetasve të cilët kërkojnë përfitimin e këtij statusi, me qëllim garantimin e të drejtave dhe të lirive themelore, në cilindo vend që gjenden ata.

Marrja e këtij statusi i shërben një personi të huaj pa shtetësi që të aplikojë për t'u pajisur me leje qëndrimi për personat pa shtetësi, apo leje humanitare, si dhe për t'u pajisur me dokument udhëtimi për këtë kategori, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt. Dokumenti i udhëtimit i lejon personit pa shtetësi të udhëtojë me të drejtën e rikthimit në Republikën e Shqipërisë, brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit (dokumenti është i vlefshëm për një periudhë 2-vjeçare).

Më konkretisht, udhëzimi është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare ekzistuese dhe praktikat më të mira të shteteve që kanë procedura për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, të cilat vlen të përmendet se janë të ngjashme me procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit. Gjatë hartimit të tij, janë marrë parasysh dhe garancitë themelore procedurale për të garantuar drejtësi dhe transparencë, të cilat zbatohen dhe në praktikat aktuale të vendeve të tjera, të tilla si: mundësia për intervistë, ndihma me përkthim, përcaktimi i afatit për marrjen e vendimit pas dorëzimit të aplikimit, e drejta për të marrë vendimin në formë të shkruar, si dhe e drejta e ankimimit.

Procedurat për përcaktimin e pashtetësisë marrin parasysh dhe nevojat e veçanta të aplikantëve, sidomos kur personi është i mitur ose person me aftësi të kufizuara, i shoqëruar nga prindi apo një përfaqësues ligjor i autorizuar, që ndikon në aftësinë e tij/saj për të marrë pjesë në procedura në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Gjithashtu, në bazë të Konventës së vitit 1954, rekomandohet që shtetet palë të lehtësojnë sa më shumë të jetë e mundur natyralizimin e personave pa shtetësi. Procedura për përcaktimin e pashtetësisë është mënyra e duhur për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare pashtetësisë së një personi, përmes marrjes së një statusi të caktuar apo marrjes së shtetësisë.

Për sa i përket ofrimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për migrantët dhe konkretisht garantimit të qëndrimit afatgjatë nëpërmjet marrjes së shtetësisë shqiptare, baza ligjore ofrohet nga ligji nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i cili mundëson fitimin e shtetësisë shqiptare sipas kategorive dhe kushteve përkatëse (me lindje, me origjinë, me natyralizim, birësim apo kur ka interes kombëtar për fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë, sportit).

Ligji kryesor që trajton migracionin për shtetasit

shqiptar dhe atyre të rikthyer, duke zëvendësuar ligjin e mëparshëm për migracionin, është ligji "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi".[1] Ky ligj synon të rregullojë çështjet e emigracionit që kanë të bëjnë me shtetasit shqiptarë që largohen nga vendi për punësim ose arsim profesional. Ligji synon të rregullojë një pjesë të proceseve të emigrimit, si dhe të sigurojë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave ekonomike dhe sociale të emigrantëve. Për më tepër, ligji synon të zgjerojë mundësitë e migrimit të rregullt për të parandaluar emigracionin e parregullt dhe veçanërisht trafikimin e qenieve njerëzore.

Menaxhimi i emigracionit në logjikën e këtij ligji nënkupton procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave për përmirësime ligjore, si dhe rritjen e kapaciteteve administrative të institucioneve zbatuese, por edhe harmonizimin me legjislacionin dhe politikat e vendeve pritëse. Në kuadër të agjendës së integrimit të Shqipërisë në BE, ky proces ka nisur tashmë me vendet anëtare të BE-së.

Pavarësisht sfidave që paraqet ky ligj lidhur me zbatimin, ai mbetet ende ligji kryesor që trajton një pjesë të çështjeve të migracionit, duke u përqendruar tek emigracioni. Ndryshimet e miratuara në vitin 2011 tregojnë një përpjekje shtesë për sa i përket zbatueshmërisë së ligjit, me fokus riintegrimin e emigrantëve të kthyer, duke përcaktuar përgjegjësitë konkrete të ministrive të linjës, në lidhje me përfitimet e shërbimeve specifike në fushën e shëndetësisë, arsimit, punësimit apo sipërmarrjes, mbrojtjes sociale dhe strehimit.

Strategjia Kombëtare e Migracionit dhe Plani i Veprimit 2019–2022 ishte dokumenti politik kryesor i fushës së migracionit, i cili udhëhoqi punën e institucioneve të përfshira. Sipas këtij dokumenti, migracioni për motive punësimi është një faktor me ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e vendit. Si i tillë, dokumenti parashikonte masat dhe objektivat përkatëse. Një nga shtyllat kryesore të këtij dokumenti ishte zhvillimi i politikave efektive për migracionin për motive punësimi, me qëllim rritjen e ndikimit pozitiv të migracionit në zhvillimin social-ekonomik vendor dhe kombëtar. Pavarësisht se periudha e zbatimit ka përfunduar, qasja për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të ardhshme të punësimit, duke marrë parasysh ndikimin e migracionit në tregun e punës, mbetet e rëndësishme. Objektiva të tjerë synonin mbështetjen e formave të ndryshme të migrimit, si dhe nxitjen e përfshirjes së diasporës në zhvillimin social-ekonomik të vendit.

Ligji për nxitjen e punësimit[2] përmban dispozita specifike që synojnë lehtësimin e përfshirjes së emigrantëve të kthyer në masat aktive dhe pasive të tregut të punës. Ky ligj përcakton si anëtarë të kategorisë së grupeve të veçanta punëkërkuesit e papunë që janë kthyer nga emigracioni gjatë dy viteve të fundit. Kategoria e grupeve të veçanta përfshin po ashtu individët nën moshën 29 vjeç, si një përpjekje strategjike për të trajtuar një nga shkaqet kryesore të emigrimit. Në përputhje me dispozitat e ligjit për nxitjen e punësimit, janë ratifikuar akte të shumta nënligjore. Këto akte nënligjore vendosin rregulla dhe kritere që rregullojnë programet e veçanta të punësimit, duke përfshirë aspekte të tilla si: punësimi, trajnimi, praktikat profesionale, vetëpunësimi, puna në komunitet etj. Ky ligj vë theksin tek integrimi në tregun e punës dhe integrimi social i këtyre grupeve të veçanta. Ai parashikon krijimin e infrastrukturës dhe burimeve thelbësore në nivel rajonal dhe vendor për të ofruar shërbime të personalizuara. Kjo përfshin këshillim të specializuar për karrierën dhe punësimin, të përshtatura sipas nevojave të individëve.

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"[3], rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me të gjitha grupimet e parashikuara në të, dhe ka për qëllim sigurimin e të drejtës së çdo personi për mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë këtu mundësi të barabarta trajtimi si për kategorinë e migrantëve të rregullt dhe atyre të parregullt.

[1] Ligji nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi", i ndryshuar.

[2] Ligji nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit".

[3] Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i përditësuar, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/11/LMD-i-perditesuar-1.pdf.

Ndryshimet e miratuara në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore" në vitin 2019,[4] i ngarkuan njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV) përgjegjësi shtesë duke kërkuar ngritjen e një njësie të posaçme për diasporën dhe migracionin. Funksionet e kësaj strukture përfshijnë ofrimin e mbështetjes, informacionit dhe shërbimeve për migrantët, në lidhje me mundësitë e investimit, si dhe riintegrimin social të migrantëve të kthyer.

Një funksion tjetër i NJVV-ve ka të bëjë me mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me emigrantët dhe diasporën nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit. NJVV-të kërkohet të koordinojnë veprimtarinë e tyre me ministritë përgjegjëse për migracionin dhe punët e jashtme, për të siguruar informacion dhe mbështetje për çështjet që lidhen me migracionin dhe diasporën.

Profilet e migracionit. Zhvillimi i profileve vjetore dhe të zgjeruara të migracionit nga institucionet përgjegjëse shërben për të ofruar informacion analitik dhe statistikor mbi tendencat migratore drejt dhe nga Shqipëria, për të udhëhequr politikat afatshkurtra dhe afatmesme, për menaxhimin efektiv të migracionit. Gjetjet e dokumentit të fundit që mbulon periudhën 2015–2018 tregojnë se tregu i punës në Shqipëri mbetet ende i dobët. Disa nga dobësitë janë niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë, niveli i lartë i papunësisë afatgjatë, tregu jofleksibël i punës edhe për të rinjtë me diplomë të arsimit të lartë, papunësia e lartë në zonat rurale dhe sektorin bujqësor, informaliteti në tregun e punës, etj.

Niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë tregon se të rinjtë kanë vështirësi të konsiderueshme për të kaluar nga arsimi tek tregu i punës. Përveç kësaj, ekziston gjithashtu një mospërputhje e madhe midis aftësive dhe nevojave të tregut, gjë që e bën më të vështirë gjetjen e punës së përshtatshme. Situata ka ndryshuar që atëherë, megjithatë disa nga çështjet e lartpërmendura vazhdojnë të jenë të pranishme. Ndërkohë, vihet re një rritje e fluksit migrator të të rinjve drejt vendeve të BE-së dhe më gjerë, për arsye pune dhe studimi. Në këtë drejtim, rekomandimet e këtij dokumenti mbeten të vlefshme, në lidhje me përmirësimin e kushteve, mundësive, aksesit dhe integrimit të të rinjve në arsimin dhe aftësimin profesional, arsimin e lartë në fushat sipas kërkesës dhe në tregun e punës.

Vazhdimisht vlerësohen të nevojshme politika më produktive për të ulur papunësinë ndërmjet të rinjve, numrin e të papunëve afatgjatë, pabarazitë në shpërndarjen territoriale të papunësisë, papunësinë në zonat rurale dhe në bujqësi, si dhe për të dekurajuar flukset migratore. Kjo mund të arrihet edhe duke ofruar stimuj për sipërmarrësit që punësojnë vajza dhe djem të rinj. Thellimi i luftës kundër informalitetit kontribuon edhe për dekurajimin e fluksit migrator, veçanërisht në tregun e punës, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe pagave të punëtorëve.

Aktualisht, Shqipëria është duke u përgatitur për të filluar zbatimin e programit të garancisë rinore, i cili po zbatohet me sukses prej disa vitesh në vendet e BE-së. Nëpërmjet këtij programi synohet që të gjithë të rinjve të moshës deri në 29 vjeç, që nuk janë të punësuar, nuk po ndjekin shkollën apo një kurs profesional, brenda 4 muajve nga momenti i identifikimit dhe regjistrimit t'i ofrohet një program/ofertë që mund të përfshijë punësimin, formimin profesional apo arsimimin. Nëpërmjet kësaj politike synohet dhe ulja e papunësisë ndërmjet të rinjtë, si dhe ulja e nivelit të migrimit të kësaj kategorie.

Krijimi dhe funksionimi i Regjistrit Kombëtar Elektronik për të Huajt[5] shënon një përmirësim në fushën e migracionit. Ai përmban të dhëna për të huajt që hyjnë në vend për qëllime qëndrimi, tranziti, studimi dhe punësimi, si dhe për dalje nga vendi. Ky regjistër përmban të dhëna edhe për migrantët e parregullt dhe ndërvepron me regjistrin TIMS, si dhe me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Një nga pesë modulet e përfshira në këtë regjistër është moduli i lejeve unike dhe të qëndrimit që përmban të dhëna të regjistruara dhe të kontrolluara nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit (DKM) dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Regjistri Elektronik Kombëtar për të Huajt mund të ofrojë statistika dhe raporte për çdo modul, sipas nevojave dhe kërkesave të institucioneve që kanë akses në to, si në rastin e AKPA-së.

[4] Ligji nr. 38/2019, datë 20.6.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 139/2015, 'Për vetëqeverisjen vendore'".

[5] VKM-ja nr. 857, datë 29.12.2021, "Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për të Huajt (REKH) në Republikën e Shqipërisë".

Kuadri strategjik kombëtar

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë, janë marrë parasysh dhe shumë dispozita nga dokumente strategjike kombëtare, si:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030;
- Plani Kombëtar për Integrim Evropian 2022–2024;
- Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe Plani i Veprimit 2021-2023;
- Strategjia Kombëtare për Diasporën dhe Plani i Veprimit 2021–2025;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023;
- Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025 dhe Plani i Veprimit 2021–2022;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2021–2023;
- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019–2022 (si dokument bazë);
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Plani i Veprimit;
- Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019–2023;
- Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet, 2021–2026 dhe Plani i Veprimit 2021–2023.

Çështjet e lidhura me migracionin trajtohen kryesisht në disa dokumente politike, si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2030, Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023–2030.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian[6] (SKZHIE) është dokumenti politik që siguron zhvillimin e vendit në të gjitha fushat, në përputhje me drejtimet strategjike dhe në kuadër të integrimit në BE. SKZHIE-ja, e cila mbulon periudhën deri në vitin 2030, në vijim të strategjisë së mëparshme, vazhdon ta konsiderojë migracionin si një aspekt të rëndësishëm për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë. Menaxhimi i duhur i migracionit mbetet një prioritet kryesor edhe për perspektivën e integrimit të vendit në BE. Përgjithësisht, Shqipëria vazhdon të jetë një vend origjine për migrantët ekonomikë, por është gjithashtu një vend tranziti dhe destinacioni për migrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët.

SKZHIE-ja ka si objektiv parësor zhvillimin dhe zbatimin e një dokumenti të ri gjithëpërfshirës për migracionin. Në frymën e proceseve globale të migracionit dhe të integrimit të vendit në BE, duke dhënë një përgjigje të plotë ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, ky dokument përfaqëson vizionin e qeverisë shqiptare në fushën e migracionit deri në vitin 2030. Në këtë drejtim, qëllimi strategjik është qeverisja efektive e migracionit, duke trajtuar dhe menaxhuar problematikat dhe sfidat që dalin nga lëvizjet migratore, me synim rritjen e ndikimit të migracionit për zhvillimin e individëve dhe shoqërisë migrante.

Ky dokument thekson se, pavarësisht nga niveli i pranueshëm i zbatimit të SKM 20219–2022, ka ende sfida të patrajtuara, të tilla si përmirësimi i mekanizmave të riintegrimit për të siguruar mbështetje të qëndrueshme për migrantët e kthyer, si dhe forcimi i politikave dhe strukturave të menaxhimit të migracionit për integrimin e migrantëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Nxitja e investimeve njerëzore dhe kapitale të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë është një tjetër aspekt i vlerësuar si i rëndësishëm.

Bazuar në këtë dokument strategjik, objektivat politikë kryesorë të fushës së migracionit do të synojnë zhvillimin e politikave efikase të migracionit për motive punësimi, për të rritur ndikimin pozitiv të migracionit në rritjen social-ekonomike vendore dhe kombëtare. Gjithashtu, synimi është promovimi i migrimit të rregullt dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve, si dhe riintegrimi i tyre në shoqërinë tonë.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030[7] ofron një vlerësim të situatës së migracionit nga këndvështrimi i punësimit dhe aftësive, duke theksuar se plakja e popullsisë dhe lëvizjet migratore kanë zvogëluar rritjen e fuqisë punëtore në vend. SKPA-ja, në masat që synojnë të realizojnë vizionin e saj për punësim dhe aftësi për

[6] VKM-ja nr. 88, datë 22.2.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian 2022–2030".

[7] VKM-ja nr. 173, datë 24.3.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024".

të gjithë, gjatë të gjithë jetës, në mënyrë specifike për lëvizshmërinë e fuqisë punëtore, parashikon ndërhyrje që synojnë lidhjen me platformën evropiane të zyrave të punësimit (EURES), përmirësimin e kuadrit rregullator për rekrutimin e drejtë të punonjësve, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet zyrave publike dhe private të punësimit, identifikimin e aftësive të munguara në vend e rajon dhe plotësimin e tyre nëpërmjet promovimit të lëvizshmërisë në rajonin e Evropës Juglindore. Ndërtimi i dialogut dypalësh ose shumëpalësh për të promovuar sisteme të mirëqeverisura të migrimit për motive punësimi dhe mbështetja e riintegrimit në tregun e punës të të kthyerve janë masa të tjera të parashikuara në këtë dokument. Të dy dokumentet strategjikë në fushën e punësimit dhe migracionit mbështesin dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 [8] identifikon mangësitë dhe masat prioritare për përafrimin e legjislacionit dhe standardeve kombëtare me ato të BE-së në të 33 kapitujt e *acquis*-it të BE-së. SKM-ja është në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në shumë kapituj, kryesisht: me kapitullin 24 "Drejtësia, Liria, Siguria"; kapitullin 2 "Lëvizja e Lirë e Punëtorëve"; kapitullin 3 "E drejta e biznesit dhe liria për të ofruar shërbime"; kapitullin 18 "Statistikat" dhe kapitullin 19 "Politika Sociale dhe Punësimi". PKIE-ja ofron një vlerësim të detajuar të situatës, dhe mangësive dhe identifikon fushat prioritare relevante si qeverisja e migracionit të rregullt dhe të parregullt, azili, politika e vizave (kapitulli 24), aksesi i barabartë dhe jodiskriminues në tregun e punës dhe koordinimi i sistemit të sigurimeve shoqërore (kapitulli 2), njohja reciproke e kualifikimeve profesionale (kapitulli 3), statistikat demografike, sociale dhe ekonomike (kapitulli 18), standardet minimale dhe mosdiskriminimi në punë, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin, në lidhje me punësimin, punën dhe çështjet sociale (kapitulli 19).

Strategjia Kombëtare për Diasporën[9] vlerëson potencialin e imigrantëve jo vetëm sa i takon remitancave, por dhe rolit për zhvillimin e vendit përmes njohurive dhe vlerave të fituara në shtetet e tjera. Nga ana tjetër, programi shtetëror për mbështetjen dhe përfshirjen e diasporës shqiptare ka si qëllim të forcojë politikat dhe strukturat institucionale për ta parë migracionin si një mundësi për zhvillimin e vendit. Përfitimet neto të kapitalit njerëzor (kontributi në aftësi i imigrantëve) dhe integrimi i suksesshëm i emigrantëve të kthyer, janë ndër objektivat kryesorë të këtij dokumenti politik.

Lehtësimi i migracionit të organizuar, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm, nëpërmjet zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë, është ndër synimet kryesore të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit,[10] së bashku me parandalimin e migrimit të parregullt dhe menaxhimin e fluksit migrator.

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Plani i Veprimit 2020–2023[11] përfshin gjithashtu aktivitete që synojnë migrantët dhe ndërgjegjësimin për migracionin për qëllime punësimi, rrugët ligjore për migrimin e rregullt, si dhe pasojat e migrimit të parregullt.

Një pjesë e çështjeve të migracionit trajtohen edhe në Strategjinë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda[12] nga këndvështrimi i luftës kundër kalimit të paligjshëm të kufirit nga emigrantët, i njohur ndryshe si kontrabandimi i migrantëve. Nga ana tjetër, Plani Kombëtar i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2021–2023 parashikon rritjen e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë që merren me migrantët, për të identifikuar viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit, si dhe për të informuar vazhdimisht migrantët e parregullt për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga trafikimi në një gjuhë që ata kuptojnë.

[8] https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/NPEI_2022-2024_EN-.pdf

[9] VKM-ja nr. 585, datë 22.7.2020, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare dhe Planit të Veprimit 2021–2025".

[10] VKM-ja nr. 1117, datë 16.12.2020, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe Planit të Veprimit 2021–2023".

[11] VKM-ja nr. 878, datë 11.11.2020, "Për miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të strategjisë së edukimit ligjor për publikun 2019–2023".

[12] VKM-ja nr. 1140, datë 24.12.2020, "Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025".

Kuadri ndërkombëtar dhe dokumente kryesore strategjike për Shqipërinë

Kompakti Global për Migracionin[13]. Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen Globale për Migrim të Sigurt, të Ligjshëm dhe të Rregullt (GCM), gjatë Konferencës Ndërqeveritare të Marrakeshit, në dhjetor të vitit 2018, duke shprehur përkushtimin e saj ndaj kuadrit global të migracionit, në mbrojtje të interesave kombëtare dhe përmes përmirësimit të bashkëpunimit. Një objektiv i rëndësishëm i GCM-së është të maksimizojë të gjitha përfitimet e lëvizjes së njerëzve dhe të lehtësojë sfidat e saj. Shqipëria ka përgatitur dhe dorëzuar, në mars të vitit 2022, raportin e vlerësimit vullnetar të situatës së zbatimit të GCM-së në Shqipëri, për periudhën 2019–2021.

Një ndryshim i madh në krahasim me SKM-në dhe PV-në 2019–2022 është vendimi i qeverisë së Shqipërisë për të përafruar dokumentin aktual strategjik me kornizën GCM, në mënyrë që të nxisë marrëdhënien pozitive midis migrimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm për të arritur Agjendën 2030 dhe për të siguruar koherencë ndërmjet politikave, legjislacionit dhe kornizave të reja ndërkombëtare. Për këtë qëllim, IOM-ja hartoi një udhëzues për të mbështetur qeverinë në raportimin e zbatimit të GCM-së. Udhëzuesi theksoi ndërlidhjet midis GCM-së dhe SKM 2019–2022 dhe se si ato kontribuojnë ndaj njëra-tjetrës.

Shqipëria paraqiti një raport vullnetar rishikimi në rishikimin rajonal të GCM-së për Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Rajonin e Evropës në vitin 2020 dhe paraqiti një raport vullnetar rishikimi kombëtar të GCM-së për Forumin Ndërkombëtar të Rishikimit të Migracionit 2022.[14] Raporti njohu migracionin si një çështje jetike të zhvillimit dhe prioritet kyç për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Ndalimi i daljes së shtetasve të kualifikuar dhe të arsimuar përmes promovimit të kthimit vullnetar u konstatua si një mënyrë për të tërhequr potencialin intelektual. Kthimi dhe riintegrimi i të miturve të pashoqëruar dhe të kthyerve të tjerë në rrethana të cenueshme u njoh si një detyrë e rëndësishme. Raporti theksoi, gjithashtu, urgjencën e parandalimit të keqpërdorimit të regjimit pa viza në zonën Shengen dhe uljen e shkallës së kërkesave për azil në BE. Raporti bëri thirrje për një përgjigje të duhur ndaj flukseve të përziera të migracionit, duke vënë në dukje përparimin e bërë për zhvillimin e infrastrukturës pritëse, duke lejuar hapësira të dedikuara për të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, azilkërkuesit, refugjatët, migrantët, personat pa shtetësi dhe viktimat e trafikimit.[15]

Gjatë procesit të prioritizimit të GCM-së, të kryer në vitin 2023, objektivat 8, 9 dhe 10 u përjashtuan nga prioritizimi, sepse ato tashmë ishin trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nga dokumente të tjera strategjike dhe nuk konsideroheshin të rëndësishme nga palët kombëtare të interesit për Strategjinë e re të Migracionit. Disa objektiva të GCM-së u mbuluan në mënyrë të ngjashme nga dokumente të tjera strategjike, por ato u konsideruan të rëndësishme për Strategjinë e re të Migracionit nga palët e interesit kombëtar. Prandaj, ato janë përfshirë në raport si pjesërisht të rëndësishme. Këto objektiva ishin objektivat 11 dhe 18. Për më tepër, megjithëse ekzistonte një fushë e qeverisjes së migracionit ku shumica e nevojave ishin përmbushur nga Strategjia e mëparshme 2019–2022, disa nevoja të vogla në të ardhmen mbetën për t'u trajtuar në strategjinë e re, e cila u përafrua me objektivin 13 të GCM-së.

Është e rëndësishme të theksohet se pothuajse të gjitha objektivat e GCM-së u identifikuan si kontribuues të drejtpërdrejtë për përmbushjen e objektivave të SKZHIE-së, në lidhje me qeverisjen e migracionit dhe kapitujt e marrëveshjes së anëtarësimit në BE, që trajtojnë mangësitë, siç identifikohen nga Komisioni i BE-së në Raportin e Progresit për Shqipërinë, për vitin 2022. Për më tepër, raporti i prioritizimit theksoi se objektivat e GCM-së duhet të shihen përmes një këndvështrimi shumësektorial dhe gjithëpërfshirës, dhe jo thjesht si detyra që duhet të menaxhohen nga ministritë individuale të izoluara. Kjo perspektivë gjithëpërfshirëse pranon se zbatimi i suksesshëm i këtyre objektivave kërkon një përpjekje të

[13] Kompakti Global për Migracionin: https://refugeesmigrants.un.org/sites/default/files/180711_final_draft_0.pdf.

[14] Procesi GCM, Rrjeti i Kombeve të Bashkuara për Migracionin (UNMN) Një Rrjet i OKB-së për Migracionin (Rrjeti) në Shqipëri u krijua dhe filloi zyrtarisht më 15 prill 2021. Më 22 shkurt 2022, rrjeti u mblodh për të diskutuar progresin në zbatimin e GCM-së. Vendi ka paraqitur një zotim politikash, duke u angazhuar të zhvillojë Strategjinë e re Kombëtare për Migracionin të rrënjosur plotësisht në GCM.

[15] Qeveria e Shqipërisë, Raporti Vullnetar i Rishikimit mbi Statusin e Zbatimit të Kompaktit Global për Migracionin në Shqipëri në 2021, f. 1.

koordinuar dhe bashkëpunuese ndërmjet sektorëve dhe palëve të ndryshme.

Kompakti Global për Refugjatët[16] është një kornizë që synon të adresojë krizën globale të refugjatëve. Ai u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në dhjetor 2018. Kompakti nuk është ligjërisht i detyrueshëm, por ofron një qasje gjithëpërfshirëse ndaj situatave të refugjatëve, duke theksuar nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndarjen e barrës. Elementet kryesore të Kompaktit Global për Refugjatët përfshijnë:

- Kuadrin Gjithëpërfshirës për Përgjigjen ndaj Refugjatët: kompakti promovon një qasje të të gjithë shoqërisë ndaj situatave të refugjatëve, duke përfshirë jo vetëm qeveritë, por edhe organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat;
- Bashkëpunim Ndërkombëtar: thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për të ndarë barrën dhe përgjegjësinë e pritjes dhe mbështetjes së refugjatëve. Kjo përfshin asistencë financiare dhe teknike, si dhe forma të tjera mbështetjeje;
- Zgjidhje Afatgjata: kompakti fokusohet në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për refugjatët, të cilat mund të përfshijnë riatdhesimin vullnetar, integrimin lokal ose zhvendosjen në një vend të tretë;
- Bashkëpunim Humanitar dhe Zhvillimor: inkurajon koordinimin e përpjekjeve humanitare dhe zhvillimore për të adresuar shkaqet rrënjësore të zhvendosjes dhe për të promovuar zgjidhje të qëndrueshme;
- Mbrojtjen e të Drejtave të Refugjatëve: kompakti ripohon rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të refugjatëve dhe sigurimin që ata të kenë akses në arsim, kujdes shëndetësor dhe mundësi jetese.

GRF-ja e parë në vitin 2019 mblodhi mbi 1400 premtime dhe iniciativa, njëra prej të cilave ishte nga Shqipëria. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë (MB), nëpërmjet autoritetit të saj për azilin, u zotua: të zhvillojë një mekanizëm për të vlerësuar proceset e azilit dhe vendimmarrjen me synimin për të rritur drejtësinë, efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e tyre. MB-ja ka përgjegjësinë kryesore për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare të aplikantëve për azil dhe do të bashkëpunojë me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) në shqyrtimin dhe përmirësimin e cilësisë së të gjitha aspekteve të procedurave të saj, duke i dhënë kështu akses efektiv në mbrojtjen ndërkombëtare për ata që kanë nevojë dhe lehtësimin e kthimit për ata që nuk kanë. Në sinergji me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), veçanërisht mbështetjen e saj për ngritjen e kapaciteteve, trajnime gjithëpërfshirëse zyrtarët e azilit dhe të pritjes, UNHCR-ja do të sigurojë mundësinë për të mbështetur rritjen cilësore të vendimmarrjeve dhe efektivitetin e procedurave të azilit.

Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2023 për Shqipërinë[17] konstaton se kuadri ligjor për migracionin në Shqipëri është gjerësisht në përputhje me *acquis* të BE-së, megjithatë, nevojitet një përditësim, deri më tani, 26 nga 29 aktet legjislative janë përafruar. Shqipëria ka ndihmuar në menaxhimin e flukseve të migracionit drejt BE-së, duke bashkëpunuar në zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, informacionet statistikore dhe demografike të ndara me BE-në janë sporadike dhe duhet të raportohen në mënyrë periodike. Shqipëria ka finalizuar një Marrëveshje të rishikuar të Statusit me FRONTEX-in. Duhen konkluduar draftmarrëveshjet e ripranimit me vendet e treta dhe protokollin e implementimit me Greqinë. Plani i rishikuar i Kontigjencës duhet të përfshijë alokimin e duhur buxhetor.

Duhen ngritur struktura të përhershme trajnimi, për të rritur kapacitetet e Policisë së Kufirit dhe Migracionit për identifikimin e grupeve vulnerabël, si dhe duhet përmirësuar koordinimi mes departamenteve të antitrafikut dhe mbrojtjes së fëmijës. Numri i shtetasve të vendeve të treta të kthyer nga Shqipëria është ende i ulët. Shqipëria duhet të adresojë nevojat e të miturve të pashoqëruar, integrimin e tyre në sistemin kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe ngritjen e hapësirave të dedikuara për këtë grup.

Ligji i Azilit në Shqipëri, me 15 akte legjislative të përafruara me *acquis* të BE-së, ka nevojë për

[16] Kompakti Global për Refugjatët https://globalcompactrefugees.org/sites/default/files/2019-12/Global%20compact%20on%20refugees%20EN.pdf

[17] Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2023 për Shqipërinë https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

vazhdimin e konsultimeve me EUAA-në përmes Udhërrëfyesit të Bashkëpunimit. Për të përmirësuar kapacitetet implementuese dhe ndërlidhjen me akte tjera ligjore, nevojitet investim. Implementimi i udhëzimit të rishikuar për *preescreening* duhet përmirësuar, ndërsa mangësitë në referimet dhe procedurat e kthimit kërkojnë vëmendje të veçantë. Numri i ulët i referimeve për azil tregon nevojën për të forcuar aksesin në procedurat e azilit, përmes rritjes së identifikimeve, informacionit dhe referimeve të aplikantëve të mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare dhe personave vulnerabël. Kapacitetet e Policisë së Kufirit mbeten të pakta. Shtimi i stafit në drejtorinë e azilit, megjithëse pozitiv, kërkon trajnime dhe rritje të koordinimit mes aktorëve. Mungesa e përkthyesve të kualifikuar dhe punësimi i përkthyeseve femra janë sfida të cilat duhet adresuar menjëherë. Procedurat e kthimit me Greqinë duhen përmirësuar për të përfshirë kontrollet dhe mbrojtjen e shtuar. Politika e vizave të Shqipërisë nuk është plotësisht e përafruar me *acquis* të BE-së, duhen rishikuar listat e vendeve, shtetasit e të cilëve mund të futen në territorin shqiptar pa vizë dhe të përafrohet me listën e BE-së.

Numri i kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë ka pësuar rritje në vitin 2022, duke theksuar nevojën për përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Për të adresuar këtë sfidë, është e domosdoshme të rriten strukturat e trajnimit në përputhje me standardet e BE-së për rojet kufitare dhe të përmirësohet koordinimi me departamentet e antitrafikut dhe mbrojtjes së fëmijës. Fokusi i veçantë i duhet kushtuar riintegrimit të shqiptarëve të kthyer, sidomos grupet vulnerabël.

Raporti i Progresit për Shqipërinë i Komisionit Evropian, i vitit 2023, vlerësoi progresin e bërë në fushën e lirisë së lëvizjes të punëtorëve. Komisioni njeh zhvillimet për përafrimin e legjislacionit për të huajt dhe punën e bërë për lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe për sigurimet shoqërore, si dhe përgatitjen për zbatimin e EURES. Në të ardhmen, Komisioni rekomandon zbatimin e ligjit për të huajt dhe lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe për sigurimet shoqërore, veçanërisht me shtetet anëtare dhe vazhdimin e punës për lidhjen me EURES në të ardhmen. Rishikimi i marrëveshjeve ekzistuese dypalëshe të punës dhe lidhja e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit në fushën e migrimit të punës ishte një tjetër rekomandim i Komisionit për lëvizjen e lirë të punëtorëve, pasi ky vlerësim i Komisionit Evropian është në përputhje me masat e propozuara nga institucionet në Planin e Veprimit 2024–2026.

Kjo Strategji dhe Plani i Veprimit 2024–2030 trajtojnë disa pika kyçe, të ngritura në raportin e fundit të Komisionit në fushën e migracionit. Së pari, objektivi specifik 1.1 i përgjigjet nevojës për kuadrin ligjor dhe institucional për të mundësuar mekanizma efektivë për menaxhimin dhe koordinimin e migracionit. Së dyti, sipas objektivit 1.3, institucionet shqiptare janë të angazhuara për bashkëpunim ndërkombëtar për të "lehtësuar kthimin dhe ripranimin e sigurt dhe dinjitoz", një aspekt kyç i qeverisjes së migracionit, i monitoruar vazhdimisht nga BE-ja. Ky angazhim është i lidhur ngushtë me synimin afatgjatë për parandalimin e plotë të fenomenit të migrimit të parregullt të shtetasve shqiptarë, nëpërmjet ofrimit të informacionit, mbrojtjes dhe ndihmës në të gjitha fazat e migrimit (objektivi 1.4). Raporti i Komisionit njeh efektivitetin e kontrolleve të plota kufitare dhe fushatave ndërgjegjësuese, gjë që demonstrohet nga rënia prej 25% në vitin 2021 e numrit të shtetasve shqiptarë të cilëve iu mohua e drejta për t'u nisur për në BE në pikat kufitare shqiptare.[18] Strategjia pasqyron prioritetet e Komisionit për trajtimin e shkaqeve themelore të migrimit (përmes integrimit të qëndrueshëm të të kthyerve, objektivat 2.2 dhe 2.3, dhe bashkëpunimin e strukturuar me shtetet anëtare të BE-së (objektivi 1.3), duke i konsideruar ato si të domosdoshme për arritjen e qëllimit më të gjerë të zvogëlimit të migrimit të parregullt të shqiptarëve në BE.

Në të njëjtën kohë, Komisioni përcakton disa fusha specifike që kërkojnë vëmendje të mëtejshme. Në fushën e përafrimit ligjor, përafrimi i politikës së vizave të Shqipërisë me atë të BE-së është përcaktuar si prioritet. Sa i takon listës së vendeve të treta, shtetasve të së cilëve ju kërkohet vizë për t'u futur në Shqipëri, ndërkohë kjo listë është e ndryshme për nëntë shtete, po ashtu ka ndryshime për dhjetë shtete. Prandaj, Komisioni rekomandon rregullime të mëtejshme si për sa i përket harmonizimit të listës së vendeve të aksesit pa viza, edhe në lidhje me praktikën e heqjes së kërkesave për viza.

[18]

Për sa i përket kapaciteteve institucionale, është vënë në dukje rëndësia e rritjes së konsiderueshme të niveleve të personelit dhe krijimit të strukturave të përhershme të trajnimit në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit. Për riintegrimin e të kthyerve, veçanërisht atyre më të cenueshëm (si të miturit e pashoqëruar), Komisioni rekomandon formalizimin dhe forcimin e sporteleve të migracionit në bashki.[19] Angazhimi i fundit është përfshirë në Strategji në objektivin specifik 2.3, duke kërkuar fuqizimin e zyrës vendore për migrimin dhe diasporën, dhe sportelet e migracionit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Raporti i *Screening* i publikuar nga BE-ja në 29 korrik të vitit 2023,[20] vlerësoi progresin e Shqipërisë në fushën e menaxhimit të migracionit dhe theksoi disa veprime prioritare. U rekomandua përditësimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit përkatës, si dhe ndryshimi i planit të kontigjencës të Ministrisë së Brendshme për një numër të konsiderueshëm, të mundshëm, të flukseve të migrantëve dhe azilkërkuesve, për të detajuar ndarjet buxhetore dhe modalitetet operacionale. BE-ja ka theksuar se marrëveshja e ripranimit me BE-në është përcjellë me protokolle zbatuese që janë lidhur me 15 shtete anëtare të BE-së. U njoh gjithashtu nisma e Shqipërisë për të propozuar nënshkrimin e marrëveshjeve të ripranimit me disa vende të origjinës, por u vunë në dukje vështirësitë me të cilat u përball vendi sa i takon përfundimit të tyre. Në lidhje me migracionin e rregullt, Komisioni Evropian pranoi qëndrimin e Shqipërisë për nevojën e mbështetjes së ekspertëve për zhvillimin e dispozitave ligjore, zbatimin e direktivave të BE-së për Kartën Blu, lejen e vetme dhe bashkimin familjar. Në përputhje me raportin e BE-së, Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030 përfaqëson një përditësim të madh të strategjisë së migracionit, duke parashikuar në mënyrë specifike miratimin e ndryshimeve ligjore për migracionin, për motive punësimi dhe përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së.[21]

Strategjia e BE-së për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin,[22] publikuar në vitin 2021, promovon kthimin dhe riintegrimin vullnetar, në kuadër të një sistemi të përbashkët të kthimit të BE-së. Në kuadër të Strategjisë, BE-ja synon të nxisë qëndrueshmërinë e mbështetjes për riintegrim dhe pronësinë e vendeve partnere në proces.

Strategjia vë në dukje se ka disa arsye që ndikojnë negativisht për ndjenjën e pronësisë mbi procesin e riintegrimit të vendeve të origjinës, si: mangësitë në lidhje me kapacitetet, shërbimet publike, si dhe kuadrin politik, legjislativ dhe operacional. Referimi te shërbimet publike të përfshira në procesin e riintegrimit, duke përfshirë ofruesit e kujdesit shëndetësor, shërbimet e trajnimit dhe arsimit, si dhe agjencitë e punësimit, mund të vuajë nga moszhvillimi për shkak të mungesës së koordinimit dhe cilësisë së papërshtatshme të shërbimit. Kjo mund të pengojë efektivitetin e përpjekjeve për riintegrim, duke e bërë të vështirë për individët aksesin në mbështetjen që u nevojitet. Për më tepër, mungesa e sinergjive ndërmjet punës së aktorëve ndërkombëtarë dhe kornizave dhe nismave të zhvilluara nga vendet e origjinës, duke përfshirë strukturat paralele, mund të ketë një ndikim të dëmshëm në procesin e riintegrimit. Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet këtyre subjekteve mund të çojë në mungesë efikasiteti dhe përpjekje të fragmentuara, duke penguar kështu riintegrimin e suksesshëm të individëve në vendet e tyre.

BE-ja do të promovojë një rritje graduale të pronësisë së vendeve të origjinës mbi procesin e riintegrimit në nismat kombëtare dhe vendore në vendet partnere, duke siguruar qëndrueshmëri dhe kontekstualizim, si dhe duke rritur efektivitetin, duke përfshirë gjithashtu shoqërinë civile dhe sektorin privat për të mobilizuar pikat e tyre të forta. FRONTEX-i do të kontribuojë për forcimin e kapaciteteve për kthimin dhe riintegrimin vullnetar, duke përfshirë vendosjen e oficerëve ndërlidhës në vendet e treta për të ndihmuar në organizimin e

[19] *Po aty.*

[20] https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023 07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

[21] Si pjesë e masës prioritare 2.1.1, përafrimi është planifikuar në mënyrë specifike nën kapitujt 2, 3, 19 dhe 24.

[22] Komisioni Evropian, Komisioni nga Komisioni në Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e BE-së për Kthimin dhe Riintegrimin Vullnetar, Bruksel, COM (2021) 120 final, 27 prill 2021, gjendet në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021DC0120&qid=1632401748181

ripranimit dhe riintegrimit, ndërtimin e kapaciteteve vendore dhe nxitjen e pronësisë. BE-ja do të ndihmojë për forcimin e organeve qeveritare dhe strukturave të qeverisjes së migracionit dhe shmangien e vendosjes së sistemeve paralele, duke ofruar trajnime dhe duke mbështetur zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrove operacionale, duke përmirësuar kështu qëndrueshmërinë dhe duke zvogëluar varësinë nga ofruesit e jashtëm dhe financimi i donatorëve. Vendet e origjinës do të mbështeten për të rritur përgjegjësitë për pritjen dhe orientimin e të kthyerve, duke ngritur qendra të integruara të shërbimit publik me një ndalesë (*one stop shop desks*), të cilat do të lehtësojnë aksesin në shërbimet publike dhe do të koordinojnë referimet për riintegrim dhe projekte të tjera zhvillimore. Në nivel strategjik, dialogu do të faktorizojë prioritetet strategjike në hartimin dhe ofrimin e programeve të riintegrimit ndërsa, në nivel operacional, nëpërmjet lehtësimit të koordinimit dhe menaxhimit të informacionit, duke përdorur mjetet e referimit dhe shkëmbimit të informacionit të përshkruara në strategji, do të maksimizohet përdorimi i burimeve dhe do të përmirësohet cilësia e referimeve në të gjitha programet.

Strategjia e BE-së për kthim vullnetar dhe riintegrim ka ndikuar në hartimin 2024–2030, në disa aspekte kyçe. Së pari, në objektivin e politikës II janë përfshirë një sërë masash për të lehtësuar mënyra të ndryshme në të cilat migrantët shqiptarë mund të kontribuojnë në zhvillimin lokal, duke filluar nga përfshirja e tyre financiare deri tek kthimi i sigurt dhe i rregullt deri tek mbështetja e synuar për riintegrim. Së dyti, janë planifikuar përpjekje për të koordinuar ofrimin e shërbimeve për të kthyerit, përmes zhvillimit të udhëzimeve në fushat e punësimit, arsimit dhe trajnimit profesional, investimeve dhe strehimit (masa prioritare 2.3.1). Së fundi, të gjitha ministritë e linjës duhet të përfshihen në zhvillimin e një mekanizmi ndërinstitucional për kthimin dhe riintegrimin.

Plani i Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor[23], i paraqitur përpara samitit të dhjetorit 2022 dhe Këshillit të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, fokusohet në 20 masa operacionale të strukturuara në pesë shtylla. Këto shtylla përfshijnë forcimin e menaxhimit të kufijve, procedurat e shpejta të azilit, luftimin e kontrabandës së migrantëve, rritjen e bashkëpunimit për ripranimin dhe arritjen e harmonizimit të politikave të vizave. Masat përqendrohen në mbështetjen ose veprimet e partnerëve të Ballkanit Perëndimor dhe veprimin në BE. Ai synon të forcojë bashkëpunimin për migracionin dhe menaxhimin e kufijve me partnerët në Ballkanin Perëndimor, në dritën e statusit të tyre unik me perspektivën e anëtarësimit në BE dhe përpjekjeve të tyre të vazhdueshme për të harmonizuar rregullat e BE-së. Masat kryesore përfshijnë forcimin e menaxhimit të kufijve përmes FRONTEX-it, mbështetjen e kapaciteteve për azil përmes bashkëpunimit me EUAA-në, luftimin e kontrabandës, zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit dhe harmonizimin e politikave të vizave. Plani thekson bashkëpunimin e ngushtë me partnerët e Ballkanit Perëndimor për të adresuar sfidat e përbashkëta të migracionit.

Shtyllat e planit të veprimit janë konsideruar si çështje prioritare në këtë strategji për të përforcuar bashkëpunimin rajonal në kuadër të politikës 1 të strategjisë, garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit, objektivi specifik 1.3: forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve për migrim të sigurt dhe të rregullt. Zhvillimi i bashkëpunimit dhe partneriteteve rajonale mbetet çështje kyçe në qeverisjen efektive të migracionit, duke synuar partneritet dhe platforma rajonale të orientuara nga shtyllat e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Raporti i gjashtë në mekanizmin e pezullimit të vizave[24] vlerëson se Shqipëria ka arritje pozitive në politikën e saj të vizave, pasi më shumë vende kanë përjashtim të përhershëm dhe për disa kanë një përjashtim sezonal. Po ashtu vlerësohen si arritjet e rëndësishme rritja e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare, ulja e numrit të kalimeve të ligjshme të kufirit, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me FRONTEX-in. Në fushën e sigurisë, Shqipëria është aktive në operacione policore ndërkombëtare dhe ka rritur bashkëpunimin me EUROPOL-in. Po

[23]https://home-affairs.ec.europa.eu/document/download/e63e3b92-4f0c-4d95-a7f9-b0aff2dd0efc_en?filename=Western%20Balkans_en.pdf

[24] Komisioni Evropian (2023, 18 shkurt). Lex - 52023DC0730 - en - EUR-lex. Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin l& Nbsp; Raporti i gjashtë nën Mekanizmin e Pezullimit të Vizave. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52023DC0730; (f. 15–17)

ashtu, ka ngritur një oficer të dytë ndërlidhës në EUROPOL.

Gjithashtu, është pjesë e platformës evropiane kundër kërcënimeve kriminale. Rekomandimet kryesore të këtij raporti, si vazhdimi i përafrimit të politikës së vizave me listën e vendeve të BE-së dhe intensifikimi i bashkëpunimit për menaxhimin e kufijve dhe parandalimin e azilkërkimit abuziv, janë çështje pritoritare të cilat trajton SKM-ja, duke vendosur objektiva specifikë dhe ndërmarrjen e masave konkrete në të 4-ta politikat e saj.

Gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2024–2030, i është kushtuar vëmendja e duhur rezultateve të vlerësimeve të fundit të zbatimit dhe arritjes së objektivave të qeverisjes së migracionit të SKM-së dhe PV-së 2019–2022, në këndvështrimin e instrumenteve të ndryshme ndërkombëtare:

- Vlerësimi i Kapaciteteve Institucionale për Qeverisje Efektive të Migracionit në Republikën e Shqipërisë (2021);

- Udhëzues/manual referencë për raportimin e GCM-së për qeverinë e Shqipërisë (2021);

- Raport mbi prioritizimin e objektivave të GCM-së për zhvillimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit në Shqipëri (2023);

- Indikatorët e Qeverisjes së Migracionit: Profili i Dytë i Republikës së Shqipërisë (2023).

Vlerësimi i Indikatorëve të Qeverisjes së Migracionit (IQM) është një dokument që monitoron progresin e Shqipërisë për arritjen e IQM-ve që nga viti 2018, ndërsa identifikon nevojat e pazgjidhura brenda gjashtë dimensioneve të kuadrit të qeverisjes së migracionit. Për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të migrantëve, profili IQM ka nxjerrë në pah pengesa për aksesin në tregun e punës për migrantët me qëndrim jo të përhershëm. Në të theksohet se dhënia e lejes së punës rregullohet me kuota vjetore pa një sistem monitorimi të kërkesës dhe ofertës kombëtare për punë. Mungesa e një mekanizmi koordinues të krijuar për të përpiluar dhe harmonizuar të dhënat e migracionit të mbledhura nga agjenci të ndryshme qeveritare ka penguar politikëbërjen e bazuar në të dhëna. Për të trajtuar çështjen e burimeve të shpërndara të informacionit, u rekomandua zhvillimi i një portali qendror *online,* që konsolidon informacionin mbi rregullat e migracionit dhe shërbimet e disponueshme për migrantët.

Sa i takon përfshirjes së aktorëve joshtetërorë në zbatimin e politikave të migracionit, IQM-ja ripohon diagnozën e SKM-së dhe PV-së lidhur me natyrën e kufizuar dhe *ad hoc* të pjesëmarrjes. Për më tepër, u vu re se nuk kishte politika të dedikuara që lidhin politikat e ndryshimeve klimatike me lëvizshmërinë njerëzore në raportet SKM dhe PV për 2019–2022. Në kuadër të avancimit të mirëqenies social-ekonomike të migrantëve dhe shoqërisë, profili IQM nënvizoi domosdoshmërinë e kryerjes së vlerësimeve të rregullta të kërkesës kombëtare të tregut të punës për emigrantët. Një fushë tjetër që kërkon zhvillim të mëtejshëm është ngritja e "një mekanizmi gjithëpërfshirës të përqendruar te tërheqja e shtetasve shqiptarë që kanë emigruar jashtë vendit".

Kuadri institucional

Ministria e Brendshme është autoriteti kryesor në fushën e migracionit. Organet kryesore nën mbikëqyrjen e saj, përgjegjëse për zbatimin e politikave të migracionit janë: Drejtoria e Politikave për Migracionin dhe Antitrafikun, si struktura kryesore që garanton monitorim efektiv, raportim dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve të përfshira për çështjet e migracionit, Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

- Departamenti për Kufirin dhe Migracionin është autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, i cili i shtrin kompetencat e tij në të gjithë territorin e vendit, nëpërmjet strukturave përgjegjëse në nivel vendor për trajtimin, përkatësisht Drejtoritë Vendore për Kufirin dhe Migracionin. Ky autoritet është përgjegjës edhe për qendrat e ndalimit, për kthimet, organizimin e fluturimeve të përbashkëta, bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar me vendet e tjera, si dhe për trajtimin e rasteve të aplikimeve për leje qëndrimi, leje unike, apo dhe konstatimit të ligjshmërisë së të huajve në territor.

Ministria e Financave (MF) është përgjegjëse për arritjen e stabilitetit ekonomik, nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) është institucioni përgjegjës për garantimin e të drejtës për arsim dhe formim profesional si dhe punësim të denjë, duke përfshirë edhe migracionin për motive punësimi. Kjo ministri është institucioni përgjegjës për qeverisjen e migracionit për motive

punësimi, në bashkëpunim me ministritë e tjera, për krijimin e skemave të migracionit për motive punësimi, si dhe për negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të punës. MEKI-ja gjithashtu monitoron veprimtarinë e agjencive të punësimit dhe agjencive të punësimit të përkohshëm, që janë aktorë të rëndësishëm jopublikë.

- Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë (AKPA) mbulon shërbimet, programet e punësimit dhe programet e formimit profesional për të huajt dhe migrantët e kthyer. Zyrat vendore të AKPA-së kanë krijuar sportele migracioni për të ofruar shërbime dhe ndihmë për këtë grup të veçantë. Sipas rregullores së brendshme të AKPA-së, sektori i migracionit dhe marrëdhënieve të punës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe përditësimin e udhëzimeve operacionale, për zbatimin e shërbimeve që lidhen me lëvizjet migratore, për menaxhimin e procesit të dhënies së lejes së punës për të huajt dhe harton raporte periodike, në lidhje me monitorimin e lëvizjeve migratore në tregun e punës.

- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale kryen inspektime për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punonjësve.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së vizave dhe negocimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit, mbështetjen e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, organizimin e diasporës shqiptare etj., në bashkëpunim me ministritë e tjera. Për sa i përket marrëdhënieve me diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën nëpërmjet pranisë diplomatike dhe konsullore në vendet ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët. Promovimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës, dhe përfshirja e diasporës në zhvillimin politik, ekonomik dhe kulturor në vend janë ndër objektivat kryesorë kombëtarë.

Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme, lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Ministria e Arsimit dhe Sportit harton dhe zbaton politika që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, zhvillimin perspektiv të arsimit, respektimin e interesave të individit, të komunitetit e të shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe evropiane; krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor e shërbimeve. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton dhe zbaton politikat për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, në mbështetje të politikave të zhvillimit të vendit. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar.

Misioni i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është hartimi dhe zbatimi i politikave dhe strategjive zhvillimore në sektorët e shëndetësisë dhe të kujdesit social. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për rregullimin e të gjitha shërbimeve për popullsinë dhe nëpërmjet saj agjencitë dhe drejtoritë duhet të garantojnë shërbime sociale dhe shëndetësore për të huajt që janë rezidentë, fëmijët e pashoqëruar dhe të huajt e tjerë të cenueshëm që kanë nevojë për shërbime.

- Shërbimit Social Shtetëror, i cili ofron shërbime thelbësore për kategoritë e cenueshme, përfshirë migrantët viktima të trafikimit dhe të miturit e pashoqëruar.

- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) është autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procesin e mbrojtjes. Kjo agjenci luan rol të rëndësishëm dhe në nivelin vendor, nëpërmjet njësive të mbrojtjes së fëmijëve (NJMF) të ngritura pranë bashkive të vendit për të funksionuar si

struktura të posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe koordinimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen, kujdesin, shëndetin, mirëqenien dhe edukimin e mirë të fëmijëve. Ministri bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile dhe diasporën.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor koordinon zbatimin e politikës shtetërore të migracionit në njësitë e qeverisjes vendore. Ministria është përgjegjëse edhe për monitorimin e veprimtarisë së NJQV-ve në drejtim të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është institucioni koordinues në varësi të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, i cili mbështet qeverisjen vendore për zgjidhjen e problematikave dhe vështirësive që shfaqen gjatë ushtrimit të funksioneve prej tyre. Konkretisht, AMVV-ja shërben edhe si hallkë ndërmjetëse midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për përmirësimin dhe pasurimin e legjislacionit në funksion të rritjes së nivelit të shërbimeve që ju ofrohen komuniteteve. Në këtë funksion, ky institucion kryen edhe detyrën e Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore. Ky është një organizëm që ka për funksion të konsultojë akte, strategji të qeverisjes qendrore që kanë ndikim mbi vetëqeverisjen vendore, dhe është një risi që ka bërë të mundur përfshirjen e njësive të vetëqeverisjes vendore në diskutimet me vendimmarrësit, me qëllim përafrimin sa më të mirë të vendimmarrjes me hapësirat për zgjidhjen e problemeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Për realizimin e misionit të saj, AMVV-ja është në kontakt të vazhdueshëm me drejtuesit dhe personelin e njësive të qeverisjes vendore, si dhe të institucioneve të ndryshme të qeverisjes qendrore, me synim mbështetjen e tyre për trajtimin e të gjitha problematikave dhe sfidave, të lidhura me ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave qeverisëse.

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara ofron shërbime publike nëpërmjet vendosjes dhe administrimit të sporteleve të pritjes për qytetarët (*front office*), si dhe qendrave të integruara të shërbimit publik me një ndalesë (*one stop shop*), për shërbimet e kryera nga institucionet dhe agjencitë e qeverisë qendrore dhe/ose të njësive të qeverisjes vendore.

Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për mundësimin e kanaleve të sigurta dhe të ligjshme për transferimin e remitancave.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve lehtëson dhe mbështet investimet direkte në Shqipëri, nëpërmjet identifikimit dhe promovimit të mundësive për investime, duke ofruar shërbime dhe mbështetje për investitorët ekzistues ose potencial.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) luan rol të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë, pjesë e departamenteve dhe sektorëve përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe politikave në fushën e migracionit dhe për monitorimin e zbatimit të strategjisë së migracionit.

Instituti i Statistikave (INSTAT) është përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave administrative, si dhe për sigurimin e statistikave për migracionin.

ASPA dhe INSTAT-i mund të kontribuojnë gjithashtu për rritjen e kapaciteteve institucionale, mbledhjen e të dhënave administrative për migracionin, si dhe për kryerjen e studimeve mbi migracionin nëpërmjet trajnimeve, përfshirë trajnime në vendin e punës, vizita studimore, etj.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron sigurimet shoqërore për të gjithë personat e siguruar, përfshirë të huajt, si dhe menaxhon politikat e pensionit.

Bashkitë janë gjithashtu përgjegjëse dhe kontribuese të rëndësishme për ruajtjen e marrëdhënieve me diasporën dhe forcimin e bashkëpunimit me emigrantët, ku sipas parashikimeve të ligjit nr. 139/2019, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar në vitin 2019, atyre iu ngarkuan përgjegjësi të reja për ngritjen dhe funksionimin e njësive të posaçme për diasporën dhe migracionin. Konkretisht, funksionet e kësaj strukture përfshijnë ofrimin e mbështetjes, informacionit dhe shërbimeve për migrantët, në lidhje me mundësitë e riintegrimin social dhe ekonomik të migrantëve të kthyer, mundësitë e investimit të tyre apo investimit nga diaspora, si dhe koordinimin e bashkërendimin e punës me strukturat e tjera vendore dhe ministritë përgjegjëse për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për

diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e të informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.

Duke marrë parasysh dimensionin e të drejtave të njeriut të integrimit të emigrantëve, si dhe trendin në rritje të imigracionit, roli i institucioneve të të drejtave të njeriut si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bëhet më i rëndësishëm në fushën e migracionit për të garantuar të drejtat civile, ekonomike, sociale dhe kulturore të tyre.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Një tjetër aktor i rëndësishëm, që ka një rol të dyfishtë në migrimin për motive punësimi, janë agjencitë private të punësimit dhe agjencitë e punësimit të përkohshëm. Edhe pse nuk janë aktorë publikë, por duke qenë se veprimtaria e tyre i shërben dhe prek drejtpërdrejt interesin publik, veprimtaria e tyre licencohet dhe monitorohet. Veprimtaria e tyre licencohet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punës dhe kontrollohet nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Ato janë të detyruar t'i paraqesin MEKI-t raporte periodike për veprimtarinë e tyre.

Arritjet dhe mësimet e nxjerra për periudhën 2019–2022

Bilanci migrator. Shqipëria vazhdon të konsiderohet si vendi i origjinës për emigrantët ekonomikë, vend tranziti dhe destinacioni për emigrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët. Migrimi në kontekstin shqiptar vazhdon të karakterizohet më shumë nga emigracioni ndërkombëtar i popullsisë vendase dhe më pak nga imigrimi i të huajve në vend. Migrimi neto është rritur ndjeshëm që nga viti 2018 (-15 030 persona) në -32 853 në 2021-shin dhe është stabilizuar në -32 497 në vitin 2022.[25] Megjithatë, shkalla e flukseve migratore ka rritur ritmin që nga viti 2021, pasi 46 460 persona emigruan nga Shqipëria në vitin 2022 (9,9% më shumë se në vitin 2021 kur numri ishte 42 048 persona),[26] dhe numri i banorëve të huaj të Shqipërisë u rrit nga 9 195 në vitin 2021 në 13 963 (51,9% më shumë) në vitin 2022.[27]

Tabela 1. Imigracioni në Shqipëri dhe emigracioni nga Shqipëria, 2018–2022

Bilanci Migrator në Shqipëri 2018—2022			
	Imigrantë	*Emigrantë*	*Migracioni neto*
2018	23,673	38,703	-15,030
2019	20,753	43,835	-23,082
2020	7,170	23,854	-16,684
2021	9,195	42,048	-32,853
2022	13,963	46,460	-32,497

Burimi: INSTAT, 2023

Emigracioni. Numri i përgjithshëm i migrantëve shqiptarë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020[28] ishte rreth 1.3 milionë, ose afër gjysma e popullsisë së vendit. Në mënyrë domethënëse, rreth 70% e tyre banojnë në vendet anëtare të BE-së dhe ky grup ka shënuar një rritje nga 835 730 në vitin 2020 në 897 297 në vitin 2021. Sipas të dhënave të EUROSTAT-it,[29] në vitin 2021 shumica e shqiptarëve që jetojnë në Evropë me leje qëndrimi banojnë në Greqi (404 574), Itali (396 883), Gjermani (42 423) dhe Francë (20 443). Sa i përket emigrantëve shqiptarë të vendosur në BE, në vitin 2021 krahasuar me numrin e shqiptarëve të vendosur në vitin 2022, ka një rënie të numrit nga 24 842 në vitin 2021 në 20 435 emigrantë për vitin 2022.

[25] INSTAT: Indikatorët demografikë. https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/migracioni-dhe-integrimi-i-migrant%C3%ABve/#tab2

[26] INSTAT: https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/migracioni-dhe-integrimi-i-migrant%C3%ABve/#tab2

[27] INSTAT: https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/migracioni-dhe-integrimi-i-migrant%C3%ABve/#tab2

[28] Fleta informative e Shqipërisë https://albania.iom.int/sites/g/files/tmzbdl1401/files/documents/2023-03/IOM%20Albania%20Infosheet.pdf

[29] EUROSTAT: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/MIGR_RESVAS__custom_6568453/default/table?lang=en

Tabela 2. Shtetasit shqiptarë me leje qëndrimi për herë të parë në vendet evropiane, 2019–2022

	Shqiptarë me leje qëndrimi në Evropë			
	2019	*2020*	*2021*	*2022*
Belgjikë	774	766	844	1,023
Bullgari	167	97	157	151
Republika Çeke	254	105	109	148
Danimarkë	47	42	65	236
Gjermani	12,014	8,308	4,492	13,334
Estoni	11	9	10	6
Irlandë	142	104	151	468
Greqi	15,733	7,768	10,201	14,313
Spanjë	312	422	622	723
Francë	2,344	1,951	2,313	2,455
Kroaci	2,216	1,695	1,819	2,003
Itali	21,221	13,627	29,732	34,864
Qipro	59	33	33	65
Lituani	26	12	15	35
Luksemburg	157	138	140	177
Hungari	335	246	275	321
Maltë	1,178	415	1,142	2,009
Holandë	357	244	299	444
Austri	384	300	402	544
Poloni	-	236	348	626
Portugali	13	24	6	22
Rumani	275	266	261	249
Slloveni	111	61	113	134
Finlandë	146	174	263	430
Suedi	1,723	1,124	1,067	1,210
Islandë	34	31	31	40
Norvegji	143	101	127	118
Zvicër	306	-	356	419

Burimi: EUROSTAT, 2023

Sipas të dhënave të UNHCR-së dhe *Home Office UK*[30], pesë vendet kryesore të kërkesave për azil për vitin 2022 janë: Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut me një numër prej 14 223 azilkërkuesish, e ndjekur nga Franca me 9 048 azilkërkues, Gjermania me 3 572 azilkërkues, Greqia me 2 784 azilkërkues dhe Italia me 1 278 azilkërkues. Numri i kërkesave për azil të paraqitura nga shtetasit shqiptarë në BE, në periudhën janar–prill 2023 ishte 3,125, 21,4% më e ulët krahasuar me katër muajt e parë të vitit 2022 (3,875 kërkesa).

Tabela 3. Vendet kryesore të kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë, 2019–2022

	Kërkesat për azil nga shqiptarët 2019–2022			
	2019	*2020*	*2021*	*2022*
Franca	8 510	2 010	4 885	5 690
Gjermania	1 695	815	1 210	1 745
Greqia	2 795	1 025	1 125	885
Italia	1 545	450	760	1 280
Mbretëria e Bashkuar	2 784	4 522	14 223	3 453

Burimi: Databaza e EUROSTAT & Home Office UK, 2023[31]

Imigracioni. Shqipëria po bëhet gjithnjë e më shumë një vend destinacioni për emigrantët që kërkojnë punë, studentët, azilkërkuesit dhe refugjatët, megjithëse shifrat janë relativisht të vogla. Aktualisht në Shqipëri jetojnë me vendbanim të rregullt 16 505 emigrantë, nga të cilët, siç shihet në figurën e mëposhtme, 48% janë për arsye punësimi. 10 147 persona aplikuan për leje qëndrimi në vitin 2022, nga të cilët shtetasit italianë përbëjnë grupin më të madh (2 324 persona)[32]. Pjesë e shkaqeve të rritjes së numrit

[30] UNHCR statistika për azilkërkuesit shqiptarë, 2022, https://www.unhcr.org/refugee-statistics/doënload/?url=tKZ2A3

[31] Të dhëna nga EUROSTAT https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/migr_asyappctza__custom_9266187/default/table?lang=en

[32] Informacion nga MB-ja.

të imigrantëve është edhe ligji nr. 79/2021, "Për të huajt", i cili ka lehtësuar procedurat për qëndrimin e rregullt të të huajve në Shqipëri, duke diversifikuar dhe shtuar disa arsye të reja qëndrimi, lejen unike (të vetme) të qëndrimit. Gjithashtu, forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve përbën një vlerë të shtuar të ligjit.

Tabela 4. Banorët e huaj në Shqipëri sipas qëllimit të deklaruar të qëndrimit, 2019–2022

	Shtetas të huaj me qëndrim në Shqipëri Sipas Motivit			
	2019	*2020*	*2021*	*2022*
Bashkim familjar	2178	1614	1840	2646
Punësim	4208	3069	3469	6
Humanitare	603	2482	3362	191
Studim	755	274	438	694
Të tjera	343	334	487	1158

Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, 2023

Në kuadër të ndërlidhjes me strategjitë e tjera në nivel kombëtar, SKM-ja referon Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, specifikisht parashikohen ndërhyrje për: përmbushjen e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë migrante; rritjen e aksesit të grave migrante në shërbime dhe produkte financiare, informimin e grave migrante për të drejtat pronësore; reduktimin e barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritjen e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (migrantë dhe azilkërkues etj.), për punë të denjë edhe në sektorët e punësimit jotradicional (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë) dhe përmirësimin e shërbimeve të specializuara mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, nga të gjitha grupet e grave (përfshirë gratë migrante).

Referuar detyrimeve ndërkombëtare, strategjia po ashtu adreson vërejtjet përmbyllëse të Komitetit CEDAW, mbi zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (2023) dhe Raportin e Grupit të Ekspertëve për masa ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave (GREVIO), mbi zbatimin nga shteti shqiptar të Konventës së Këshillit të Evropës, mbi luftimin dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Lidhur me institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjisë, MSHMS-ja parashikohet të jetë institucioni kryesor përgjegjës për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave në fushën e barazisë gjinore.

Në lidhje me analizën e bilancit migrator në vend, parashikohet përdorimi i të dhënave të disagreguara sipas gjinisë, nga raporti i INSTAT-it për përcaktimin e impaktit të migracionit në popullsi. Gjithashtu, SKM-ja parashikon ndërhyrje specifike për rritjen e kapaciteteve institucionale për mbledhjen e të dhënave të disagreguara dhe shtimin e një treguesi të veçantë për përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat e migracionit.

VIZIONI I STRATEGJISË

VIZIONI

Qeveria e Shqipërisë ka përcaktuar në SKZHIE vizionin, objektivin strategjik dhe synimet politike

mbi të cilat do të bazohen politikat e migracionit deri në vitin 2030, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe politik të vendit.

Vizioni për migracionin është që: "Deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integrimit të Shqipërisë në BE, të ofrohet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, në kuadrin e Shqipërisë".

Qëllimet e politikës (ndikimi dhe treguesit e rezultateve)

Objektivi kryesor strategjik është:

"Qeverisja e efektshme e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problematikave dhe sfidave që lindin nga lëvizjet migratore, duke synuar rritjen e ndikimit të migracionit te zhvillimi, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare".

Qeveria shqiptare ka vendosur të arrijë objektivin kryesor strategjik, duke u përqendruar në katër qëllimet kryesore politike, si më poshtë:

- Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri;
- Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal;
- Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare;
- Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme.

Treguesit e ndikimit dhe treguesit e rezultateve

Niveli i përfshirjes së institucioneve publike, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile në çështjet e migracionit

Migracioni është një fenomen shumëdimensional dhe kompleks i cili nuk mund të trajtohet nga një sektor i vetëm apo institucion. Për të zhvilluar dhe zbatuar politika dhe praktika efektive të migracionit, nevojitet një "qasje e gjithë qeverisë" [*whole society approach*] e cila siguron koherencë horizontale dhe vertikale të politikave në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024–2030 janë përgatitur në bashkëpunim të ngushtë dhe me kontributin aktiv të ministrive të linjës të përfshira në zbatimin e politikave në fushën e migracionit, përfshirë këtu institucionet e varësisë, institucionet pavarura, si: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, INSTAT-i, etj. Njëkohësisht, gjatë procesit të hartimit të strategjisë, janë mbajtur një sërë takimesh konsultimi me shoqërinë civile, si dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri, kontributi i të cilëve vlerësohet edhe në procesin e përcaktimit dhe zbatimit të masave të caktuara. Aktorë të tjerë të rëndësishëm që kanë një rol kryesor në migrimin për motive punësimi, janë agjencitë private të punësimit dhe agjencitë e punësimit të përkohshëm, veprimtaria e të cilave do të licencohet dhe monitorohet.

Përtej nivelit të gjithëpërfshirjes, faktor kyç për rritjen e pronësinë institucionale mbi qeverisjen e migracionit është koordinimi ndërinstitucional dhe përcaktimi i qartë i roleve dhe i përgjegjësive të institucioneve për qeverisjen e migracionit. Ndonëse ekzistojnë mekanizma për koordinimin ndërinstitucional për qeverisjen e migracionit, ende mungon një mekanizëm efikas dhe funksional për të koordinuar qasjen ndërinstitucionale në mënyrë sistematike dhe të strukturuar. Objektivi strategjik 1 i SKM-së parashikon masa për përmirësimin e mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit. Ky koordinim do të arrihet përmes funksionimit të mekanizmit të dyfishtë të monitorimit, të përbërë nga Komiteti Teknik për Migracionin dhe Grupi Drejtues për Migracionin. Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me të gjithë aktorët e institucionet bashkëzbatuese të strategjisë, do të realizohet përmes nënshkrimit të disa marrëveshjeve partneriteti me aktorë joqeveritarë në fushën e migracionit, për të përmirësuar zbatimin e politikave të migracionit.

Njëkohësisht, ndjekja e proceseve rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe krijimi i partneriteteve të reja për migracionin e punës pasqyrojnë përpjekjet për një partneritet horizontal mes të gjitha institucioneve në kuadër të mirëmenaxhimit të migracionit.

Ndikimi i migracionit në PBB

Ndikimi i lëvizjeve migratore të popullsisë shqiptare në zhvillimin social-ekonomik të vendit ka qenë domethënës. Strategjia parashikon zhvillimin e politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi, me qëllim rritjen e ndikimit pozitiv të migracionit në PBB dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Dërgesat "e parave" të emigrantëve, të njohura

ndryshe si remitanca, kanë ndihmuar për zbutjen e nivelit të varfërisë dhe ende vazhdojnë të japin një kontribut të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Strategjia ka parashikuar masa për promovimin e transferimit më të shpejtë, më të sigurt dhe më të lirë të remitancave, dhe nxitjen e përfshirjes financiare të migrantëve. Po ashtu, strategjia përfshin masa për lehtësimin dhe nxitjen e kthimit të emigrantëve të kualifikuar në Shqipëri dhe maksimizimin e potencialit të tyre për zhvillimin ekonomik të vendit përmes promovimit të kapitalit njerëzor dhe investues të tyre, krijimit të paketave informuese mbi procesin e kthimit dhe riintegrimit, si dhe kushtet e tregut të punës.

Vlen të theksohet gjithashtu se, Shqipëria po bëhet gjithnjë e më tepër një vend destinacioni për një sërë kategorish të huajsh, përfshirë ata që vijnë për motive punësimi, ndonëse shifrat janë relativisht të ulëta. Në këtë këndvështrim, strategjia parashikon masa për informimin mbi format, mundësitë dhe procedurat e migrimit për arsye pune në/nga Shqipëria, si dhe masa për përmirësimin e veprimtarisë së agjencive private të punësimit dhe punëdhënësve, me qëllim zbatimin e standardeve të punësimit etik.

Ulja e migracionit neto (diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve)/indeksi i aksesit në shërbime dhe të drejta për të huajt

Shqipëria është dominuar përherë nga cikle migratore, të cilat mund të konsiderohen intensive, të parregullta dhe në evoluim, si pasojë e veprimit të kombinuar të faktorëve shtytës ekonomikë, social dhe politikë. Të dhënat e publikuara nga INSTAT-i tregojnë se nga viti 2011–2020 janë larguar nga vendi 423.7 mijë persona (emigrantë). Për të njëjtën periudhë janë kthyer 242.8 mijë imigrantë, duke bërë që migracioni neto për këtë periudhë të jetë -181 mijë persona. Flukset e larta dalëse edhe pas disa dekadash, tregojnë që Shqipëria nuk e ka mbyllur ciklin e tranzicionit migrator. Tranzicioni migrator përfundon kur nuk ka më ikje në ritme të larta dhe intensive, dhe kur ka kryesisht një fluks në rritje të imigrantëve, të personave të ardhur për të jetuar dhe punuar në Shqipëri. Edhe pse gjatë viteve të fundit shihet një tendencë në rritje e personave që hyjnë në Shqipëri, flukset e larta dalëse kanë rritur dukshëm migracionin neto. Migracioni neto, ose ndryshe diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve, shihet të ketë pësuar një rritje në vlerë absolute.

Për të trajtuar këtë sfidë, në epiqendër të strategjisë së re do të jetë ulja e migracionit neto përmes promovimit të migracionit të rregullt, si dhe fuqizimit dhe integrimit të të huajve në shoqërinë shqiptare, dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për të huajt. Për këtë arsye, një sërë ndërhyrjesh konkrete janë parashikuar me qëllim fuqizimin e migrantëve dhe integrimin e tyre për një përfshirje sa më të plotë dhe kohezion social. Strategjia ka parashikuar hartimin dhe miratimin e një mekanizmi informues mbi programet orientuese të integrimit, i cili do të evidentojë, përmes raporteve periodike monitoruese, të dhëna mbi aksesin e migrantëve në shërbimet. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet plotësimit të nevojave specifike të fëmijëve, të rinjve dhe kategorive të cenueshme. Në këtë strategji konkretisht do të synohet mbrojtja nga diskriminimi i të gjithë të huajve që qëndrojnë në territor, objektiv i cili do të ketë si tregues të dhënat e përfituara nga raportet e monitorimin të aksesit në të drejta të të huajve, përfshirë fushatat ndërgjegjësuese mbi të drejtat e migrantëve. Kështu, plani i ri do të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe aktiviteteve në nivel vendor, si dhe duke i përfshirë migrantët në procese politikbërëse apo vendimmarrëse.

Reduktimi i kohëzgjatjes së procedurave të azilit: Një sfidë kryesore për një sistem në zhvillim të trajtimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare është kohëzgjatja e proceseve për përcaktimin e vlefshmërisë së aplikimeve, identifikimin e personave me nevoja të veçanta, shqyrtimin e plotë të kërkesës dhe aksesin në mjetet juridike efektive, si dhe sigurimin e zbatimit të shpejtë të masave, si p.sh. ndalimi, transferimi dhe largimi nga territori. Në mënyrë që procedura të jetë transparente, efektive dhe respektuese e të drejtave të aplikantëve dhe garancitë kryesore procedurale, nevojiten përpjekje të mëtejshme për reduktimin e kohëzgjatjes së fazave të procedurës nëpërmjet mbajtjes së periudhave standarde, të përcaktuara në ligj, përmirësimit të teknikave për përcaktimin e identitetit dhe moshës, si dhe për mbajtjen e intervistave duke përfshirë përkthimin dhe asistencën psikologjike. Koha e reduktuar e shqyrtimit do të ndihmojë Shqipërinë të ulë barrën mbi qendrat pritëse, duke përmirësuar aftësinë e saj për pritjen e aplikantëve të rinj, ndërkohë që redukton kohën e ndalimit dhe ankthin që lidhet me pasigurinë e pritjes së vendimeve për aplikantët dhe

familjet e tyre, në të njëjtën kohë procedurat duhet t'i lënë kërkuesit një mundësi reale për të vërtetuar aplikimin e tij dhe aftësi reale për autoritetin përcaktues për të shqyrtuar kërkesën brenda afateve kohore.

PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

Qëllimi i politikës I: Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri

Qasja e koordinuar strategjike ndaj çështjeve të migracionit, duke ndjekur parimin "e gjithë qeveria", është një element kyç për detyrën e përgjithshme të Shqipërisë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të reja në fushën e qeverisjes së migracionit.

Miratimi i ligjit nr. 79, "Për të huajt", në vitin 2021, i cili përafron kuadrin ligjor kombëtar me *acquis*-në e BE-së, duke rregulluar kushtet e hyrjes, qëndrimit, punës, arsimimit dhe daljes së shtetasve të huaj në Shqipëri, ka hedhur themelet për një sistem bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kyçe përgjegjëse për çështjet e migracionit. Më konkretisht, ligji i ri shpërndan përgjegjësi midis autoriteteve shtetërore për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave personale për të huajt dhe ka përmirësuar Regjistrin Elektronik Kombëtar për të Huajt. Në këtë drejtim janë krijuar module të reja për ruajtjen e dokumenteve të identifikimit/ udhëtimit të të huajve. REKH-ja përmban module të veçanta për të dhënat për vizat e lëshuara, kontrollet e kalimit kufitar, lejet unike dhe të qëndrimit, qëndrimin e parregullt dhe dokumentet e identifikimit.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është përpunimi dhe shpërndarja e udhëzimeve për statistikat e migracionit, të cilat synojnë ndërtimin e një modeli standard të mbledhjes së të dhënave administrative.[63] Megjithatë, disa fusha kërkojnë vëmendje të vazhdueshme. Këto përfshijnë mbledhjen e të dhënave, me qëllim përdorimin për zhvillimin e politikave të të dhënave për stokun e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe zbatimin e një modeli të ri të mbledhjes së të dhënave administrative, që do të koordinohet nga Sekretariati Teknik për Migracionin.[64]

Një fushë tjetër jetike për të siguruar një përgjigje efektive afatgjatë ndaj sfidave të migracionit është bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar. Si Raporti Kombëtar Vullnetar (RKV), MGI-ja dhe vlerësimet e BE-së vënë në dukje progresin e madh të Shqipërisë kohët e fundit, si në angazhimin në proceset rajonale (Procesi i Pragës, Procesi i Budapestit, Procesi i Berlinit, Migrimi, Azili, Iniciativa Rajonale e Refugjatëve), dhe në operacionet e ndërmarra në bashkëpunim me FRONTEX-in. Megjithatë, gjatë përcaktimit të prioriteteve të GCM-së, palët e interesit vunë në dukje nevojën për intensifikimin e shkëmbimit të informacionit me shërbimet e migracionit, misionet diplomatike dhe ndërlidhjet e jashtme, si të vendeve fqinje ashtu edhe të vendeve të destinacionit. Shkëmbimi në kohë dhe gjithëpërfshirës i të dhënave do të ishte thelbësor për zhvillimin e përgjigjeve efektive ndaj flukseve të përziera të migracionit.

Qëllimi i parë i politikës *(garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri)* është planifikuar të realizohet nëpërmjet ndjekjes së tre objektivave specifikë (fig. 2), të cilat, nga njëra anë, ofrojnë një vazhdimësi me synimet e strategjisë së mëparshme dhe, nga ana tjetër, harmonizojnë qeverisjen strategjike të Shqipërisë me kuadrin GCM (tabela 5).

[63] Qeveria e Shqipërisë, Raporti i Rishikimit Vullnetar mbi Statusin e Zbatimit të Kompaktit Global për Migracionin në Shqipëri në 2021.

[64] IOM, *Raport mbi prioritizimin e objektivave të GCM-së për zhvillimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit në Shqipëri, f. 19.*

Fig. 2: Qëllimi i politikës I. Objektivat specifikë



Tabela 5. Përafrimi i politikës GCM I

Objektivat specifikë të politikës I	Objektivat përkatës të GCM-së
1.1 Qeverisja e migracionit në Shqipëri nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional.	
1.2 Hartimi dhe rishikimi i politikave të migracionit bazuar në të dhëna të sakta dhe të koordinuara.	1: Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave të sakta dhe të disagreguara si bazë për zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi.
1.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve për migrim të sigurt dhe të rregullt.	23: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve globale për migrim të sigurt, të rregullt dhe të rregullt.
1.4 Parandalimi i migrimit të parregullt drejt dhe nga Shqipëria.	3: Sigurimi i informacionit të saktë dhe në kohë në të gjitha fazat e migrimit; 4: Sigurimi që të gjithë migrantët të kenë dëshmi të identitetit ligjor dhe dokumentacion adekuat.

Objektivi i parë *(qeverisja e migracionit në Shqipëri nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional)* synon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, i cili jo vetëm siguron përafrimin e normave dhe standardeve kombëtare me ato të BE-së dhe angazhimeve të tjera ndërkombëtare, por është gjithashtu thelbësore për arritjen e objektivave të tjera të strategjisë.

Në përmbushje të këtij qëllim të politikës për periudhën e ardhshme do të vijojë përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar për migracionin me *acquis* të BE-së, përfshirë përkufizimin në legjislacion të kategorisë "shtetas të vendeve të treta", në përputhje me detyrimet në kuadër të zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, "Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës".

Sipas *objektivit specifik 1.1,* palët e interesit vendosën si më poshtë:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor kombëtar dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor të BE-së për qeverisjen e migracionit;
- Rritja e kapaciteteve institucionale dhe strukturave rishikuese në institucione, në nivel qendror dhe vendor, për një qeverisje efektive të migracionit;
- Përmirësimi i mekanizmave koordinues për qeverisjen e migracionit.

Përafrimi i vazhdueshëm ligjor me *acquis* të BE-së duhet të arrihet në fazën fillestare të zbatimit të strategjisë. Në vitin 2024, do të ndërmerren dy hapa madhorë drejt hedhjes së themeleve për përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional. Këshilli i Ministrave do të miratojë një Plan të përditësuar të Kontingjencës dhe Ministria e Brendshme së bashku me Inspektoratin e Punës, AKPA-në, DKM-në dhe MEPJ-në do të miratojnë një udhëzim të përbashkët, i cili do të përcaktojë kushtet për monitorimin e rregullt nga të gjitha këto institucione të kushteve të hyrjes, qëndrimit dhe punësimit të emigrantëve në Shqipëri.

Për të përmbushur detyrimet për përafrimin ligjor me BE-në dhe për të kryer detyrat operacionale me efektivitet në fusha të ndryshme të qeverisjes së migracionit, institucionet përgjegjëse do të duhet të kryejnë vlerësimet fillestare të nevojave, duke mundësuar identifikimin e mangësive për sa i përket personelit, aftësive,

ekspertizës apo pajisjeve.[65] Do të kërkohen gjithashtu trajnime të vazhdueshme për normat dhe standardet ligjore në zhvillim, si dhe çështjet e lidhura me zbatimin.[66] Sipas masës prioritare 1.1.2, parashikohen tre lloje specifike trajnimesh: rritja e kapaciteteve për çështjet e migracionit dhe azilit, zbatimi i legjislacionit, veçanërisht për menaxhimin e migracionit, përcaktimi dhe identifikimi i personave në situata të cenueshme, si dhe kryerja e procedurave të kthimit. Në këtë kuadër, ngritja e planifikuar e një njësie të dedikuar për trajnimin mbi çështjet e migracionit, e mbikëqyrur nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me disa organe shtetërore, pritet të sjellë standardizimin dhe profesionalizimin e mëtejshëm të programeve të trajnimit.

Strategjia aktuale gjithashtu i kushton rëndësi përdorimit të instrumenteve për të siguruar që të huajt të hyjnë dhe të banojnë në Shqipëri në mënyrë të rregullt (verifikimi i qëllimit gjatë aplikimit për vizë, intervista konsullore dhe e hyrjes në kufi). Përveç kësaj, në përputhje me kërkesat e anëtarësimit në BE,[67] parashikohet shtimi i personelit të policisë kufitare dhe territoriale, dhe caktimi i specialistëve për të ndihmuar kthimin vullnetar është caktuar si përparësi në vazhdim të strategjisë së mëparshme. Do të caktohen burimet buxhetore për rritjen e burimeve njerëzore në DKM, KMD dhe Ministrinë e Brendshme, në vitet 2024–2026.

Zbatimi i strategjisë së mëparshme nxori në pah rëndësinë e përcaktimit të qartë të përgjegjësive të institucioneve, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, gjë që është e nevojshme për shpërndarjen optimale të burimeve të pakta, koordinimin efektiv të aktiviteteve të përbashkëta dhe monitorimin, dhe raportimin e duhur të progresit të të gjitha objektivave të caktuara për organet e ndryshme. Konsultimet institucionale zbuluan një nevojë prioritare për forcimin e rolit të strukturave bashkiake për migrimin dhe diasporën. Plani i Veprimit parashikon shprehimisht që procesi i krijimit dhe personelit të këtyre organeve të përfundojë deri në vitin 2026.

SKM-ja e re përfshin në objektivin e parë të fushës së parë një masë të dedikuar, e cila vendos mekanizma për zbatimin, koordinimin e aktiviteteve dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së objektivave të Planit të Veprimit. Vlen të përmendet se deri në vitin 2026 do të hidhen bazat për një sistem koordinimi, monitorimi dhe raportimi. Ato janë parashikuar në nivele të ndryshme. Në nivelin strategjik, duhet të hartohet një udhërrëfyes për koordinimin dhe raportimin e masave sipas Planit të Veprimit. Një instrument ligjor (një urdhër) do të përcaktojë përbërjen, anëtarësimin dhe kompetencat e dy organeve koordinuese: Grupit Drejtues për Migracionin dhe Komitetit Teknik për Migracionin. SKM-ja parashikon gjithashtu krijimin e një grupi pune, të mbikëqyrur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për të bashkuar të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit. Zyrat vendore të migracionit dhe diasporës do të përfshihen më tej përmes shkëmbimit periodik të informacionit me Sekretariatin Teknik të Migracionit.

Objektivi i dytë *(hartimi dhe rishikimi i politikave të migracionit bazuar në të dhëna të sakta dhe të koordinuara),* u bën thirrje të gjitha institucioneve të mbledhin, analizojnë dhe ndajnë të dhënat e lidhura me migracionin si themeli për krijimin e politikave të bazuara në statistika. Ai i përgjigjet objektivit #1 të GCM-së dhe është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj çështjeve që penguan raportimin e progresit sipas strategjisë së mëparshme: mungesa, fushëveprimi i pjesshëm dhe papërputhshmëria e të dhënave të migracionit.

Objektivi specifik 1.2 parashikon masat e mëposhtme prioritare:

- Krijimi i një metodologjie të koordinuar për mbledhjen e të dhënave në përputhje me Programin Zyrtar të Statistikave;

- Shkëmbimi efektiv dhe ndërveprueshmëria e të dhënave të migracionit;

[65] Ministria e Brendshme është ngarkuar me koordinimin e vlerësimit gjithëpërfshirës të nevojave në fushën e kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit, duke përfshirë në vitin 2024 të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e SKM-së.

[66] Në përputhje me kërkesat e anëtarësimit në BE, objektet e përhershme të trajnimit duhet të vendosen në DKM "në përputhje me standardet bazë të trajnimit për rojet kufitare të BE-së". Shiko: shqyrtimin e BE-së të kapitullit 24 të *acquis* të BE-së.

[67] Shqyrtimi analitik i vitit 2023, i kapitullit 24 të *acquis* të BE-së vëren, për shembull, se pavarësisht shtimeve të fundit, nivelet e personelit të DKM-së *"mbeten të kufizuara"*.

- Vlerësimi dhe rishikimi i të dhënave të migracionit për hartimin e politikave dhe dokumenteve.

Programi Zyrtar i Statistikave të Shqipërisë, deri në vitin 2026, vëren disa mangësi të vazhdueshme lidhur me shtrirjen, harmonizimin dhe shpeshtësinë e mbledhjes së të dhënave në fushën e migracionit. Arrihet në përfundimin se mungesa e një regjistri statistikor të popullsisë e bën gjurmimin e lëvizjes së njerëzve që hyjnë dhe dalin nga vendi "komponentin më të vështirë për t'u matur". Sipas Programit, treguesit për "emigracionin ndërkombëtar, lëvizjet e brendshme, si dhe statistikat për të huajt dhe azilkërkuesit" duhet të publikohen çdo vit. Shtimi i treguesve dhe përmirësimi cilësor i variablave duhet të shoqërohet me harmonizimin e përkufizimeve me ato të aplikuara nga EUROSTAT-i. Në këtë kuadër, përdorimi i rregullt i të dhënave nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave, i kombinuar me burimet administrative, është planifikuar për të adresuar sfidën e një monitorimi më efektiv të lëvizjes së njerëzve që hyjnë dhe dalin nga Shqipëria.[68]

SKM-ja kërkon të përmirësojë të dhënat e migracionit në mënyrë sistematike përmes kombinimit të koncepteve (krijimi i një metodologjie të unifikuar për mbledhjen e të dhënave), operacionale (intensifikimi i shkëmbimit të të dhënave ndërinstitucionale) dhe përdorimit të të dhënave për zhvillimin e politikave (përmes hartimit të studimeve dhe vlerësimeve). Deri në vitin 2026, janë planifikuar ndërhyrje specifike për zhvillimin e standardeve dhe metodave të unifikuara për mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë përpunimin dhe shpërndarjen e një udhëzuesi për mbledhjen e të dhënave në përputhje me BE-në, dhe zhvillimin e një praktike të rregullt të monitorimit të përpjekjeve për mbledhjen e të dhënave nga të gjitha institucionet shtetërore përgjegjëse. Përvoja fillestare me mbledhjen e të dhënave dhe identifikimin e mangësive duhet të merret parasysh për zhvillimin e kurrikulave dhe formateve të trajnimeve të dedikuara për ndërtimin e kapaciteteve për mbledhjen, analizën dhe ndarjen e të dhënave. Parashikohet përdorimi më i shpeshtë dhe efektiv i moduleve ekzistuese të bazës së të dhënave të të huajve, si dhe është planifikuar krijimi i grupeve shtesë të të dhënave (kërkuesit për viza me rrezik të lartë dhe ata të besueshëm) në vazhdim të strategjisë së mëparshme. Këto masa janë në referencë të drejtpërdrejtë me angazhimet sipas Planit të Veprimit për Qeverisjen e Qëndrueshme të Migracionit në Ballkanin Perëndimor 2023–2035.

Ministria e Brendshme, në vazhdim të reformave në sektorë të rëndësishëm si migracioni, azili dhe menaxhimi i kufijve, duke pasur parasysh dhe dimensionin ndërkombëtar të kërcënimeve ndaj shtetit të së drejtës dhe sigurisë, që vijnë nga migracioni i parregullt dhe i pakontrolluar qëndron e gatshme që të bashkëpunojë me BE-në për të arritur standardet evropiane në realizimin e misioneve dhe operacioneve sipas nevojave. Konkretisht Ministria e Brendshme ka konfirmuar interesin e saj për të zhvilluar një masterplan për Shqipërinë. Ky masterplan do të krijojë një sistem informatik, në përputhje me standardet e BE-së, për identifikimin dhe regjistrimin e flukseve të përziera migratore.

Duke pasur parasysh objektivin e zhvillimit të politikave afatgjata të migracionit bazuar në prova, strategjia parashikon përdorimin e mjeteve analitike gjithëpërfshirëse, përkatësisht publikimin vjetor të një profili gjithëpërfshirës të migracionit dhe hartimin e një profili të zgjeruar çdo katër vjet. Përveç kësaj, duke marrë parasysh nevojën në rritje për aftësi specifike dhe profile arsimore, dhe profesionale në tregun kombëtar të punës, nevojiten të dhëna për migracionin për motive punësimi për ofertën e punëtorëve, si dhe për ndikimin më të gjerë social-ekonomik të emigrimit. Strategjia e re synon gjithashtu të plotësojë mangësitë në njohuri, lidhur me masën dhe përbërjen e stokut të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit. MEPJ-ja do të ngarkohet me detyrën e mbledhjes së të dhënave për shtetasit me status të rregullt dhe të parregullt, fëmijët e pashoqëruar dhe shtetasit shqiptarë të dënuar ose të ndaluar për rihyrje.

Objektivi i tretë *(forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve globale për migrimin e sigurt dhe të rregullt)* thekson rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në partneritetet globale, për të garantuar që migrimi të jetë i sigurt, i rregullt dhe i rregullt. Ky

[68] Kjo parashikohet në ligjin nr. 140/2020, "Për regjistrimin e popullsisë dhe banesave". Shih ligjin nr. 30/2022, "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026", https://www.instat.gov.al/media/10480/official-statistics-program-2022-2026.pdf

objektiv është në thelb të GCM-së, si dhe mbështet detyrimet e vendit në kuadër të proceseve rajonale dhe ndërkombëtare, interesin për zbatimin e mëtejshëm dhe përfundimin e aranzhimeve të punës për kthimin dhe ripranimin (siç përcaktohet në Strategjinë e BE-së për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin).

Në kuadër të *objektivit specifik 1.3,* janë planifikuar masat e mëposhtme prioritare:

- Pjesëmarrja në proceset rajonale dhe ndërkombëtare;
- Krijimi i partneriteteve të reja për migracionin për motive punësimi.

Objektivi 23 i GCM-së thekson solidaritetin midis vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit të migrantëve, dhe bën thirrje për "përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës", duke theksuar veçanërisht rolin e autoriteteve vendore për të lidhur migrimin me zhvillimin. Për më tepër, ai nënvizon se vetëm përmes përfundimit dhe zbatimit të partneriteteve dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe mund të zhvillohen zgjidhje për sfidat e përbashkëta të migracionit. Arritjet e fundit në bashkëpunimin rajonal të Ballkanit Perëndimor përfshijnë Deklaratën e Shkupit të vitit 2022 dhe Dialogun e Migracionit të Sarajevës të vitit 2023. Këto dokumente strategjike riafirmojnë përkushtimin e vendeve të rajonit për të trajtuar së bashku sfidat e migracionit të parregullt, rritjen e aksesit në rrugët ligjore për migrantët dhe bashkëpunimin drejt zhvillimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse të menaxhimit të kthimit.

Palët e interesit në Shqipëri kanë vendosur, në kuadër të objektivit të tretë të qëllimit të parë të politikës, të vazhdojnë të marrin pjesë aktive dhe të intensifikojnë përfshirjen e tyre në proceset rajonale dhe ndërkombëtare për të forcuar partneritetet për migrim të sigurt dhe të rregullt. Ndër aktivitetet e parashikuara janë raportimi i zgjeruar për pjesëmarrjen e Shqipërisë në proceset rajonale dhe ndërkombëtare për çështjet e migracionit në nivel teknik dhe menaxherial. Kontributi i këtyre proceseve drejt përmirësimit të politikës kombëtare të migracionit dhe kuadrit ligjor, duhet të vlerësohet dhe pas një rishikimi të partneriteteve aktuale, mund të bëhen plane për ndërmjetësimin e lidhjeve të reja institucionale.

Një fushë me rëndësi të veçantë për zbatimin e partneriteteve dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare është bashkëpunimi drejt kthimit dhe ripranimit të sigurt dhe dinjitoz. Në përputhje me objektivin 21 të GCM-së, korniza të tilla bashkëpunimi mund të rrisin mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, t'u përgjigjen nevojave specifike dhe të ofrojnë ndihmën e nevojshme konsullore, ligjore dhe riintegruese.

Masat e parashikuara në këtë fushë janë të lidhura ngushtë me objektivin e garantimit të migrimit të sigurt, të menaxhuar dhe të rregullt të shtetasve shqiptarë për qëllime pune. Së pari, partneritetet aktuale duhet të vlerësohen rregullisht, në lidhje me ndikimin e tyre në aftësinë e vendit për të menaxhuar migracionin. Së dyti, parashikohet intensifikimi i bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse të vendeve të tjera, si brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe më gjerë, për të identifikuar mundësitë për akses në tregjet e punës. Së fundi, një sërë aktivitetesh janë planifikuar për përgatitjen, negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe për migracionin për motive punësimi, duke filluar me një vlerësim bazë të nevojave përmes identifikimit të vendeve prioritare (duke realizuar angazhimin nga strategjia e mëparshme) dhe përfundimin e marrëveshjeve në periudhën deri në vitin 2030.

Objektivi i katërt (parandalimi i fenomenit të migrimit të parregullt drejt dhe nga Shqipëria) është një aspekt thelbësor i pajtueshmërisë së vazhdueshme me kushtet e liberalizimit të vizave me BE-në.

Në këtë kontekst, nevojiten përpjekje të vazhdueshme që Shqipëria të përmbushë kërkesat e përjashtimit nga vizat dhe qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar ndaj politikës afatgjatë të promovimit të migracionit të rregullt si i dobishëm, si për migrantët, ashtu edhe për vendet e tyre të origjinës dhe destinacionit.

Sipas raportit të fundit të monitorimit të pezullimit të vizave të Komisionit Evropian, në vitin 2021, u vunë re reduktime të mëtejshme të lëvizjeve të parregullta, pasi vendet anëtare të BE-së raportuan 19% më pak kalime të parregullta kufitare dhe një rënie prej 8% në kthimet e shtetasve shqiptarë. Në të njëjtën kohë, mbetet shumë punë për t'u bërë, pasi në vitin 2021 u raportua një rritje e ndjeshme e numrit të shqiptarëve që qëndrojnë në mënyrë të parregullt në BE (21% më shumë se në 2020) dhe në refuzimet e hyrjes (një rritje prej 39%) në shtetet anëtare të BE-së.

Ndërkohë, sipas raportit të 6-të të monitorimit të pezullimit të vizave të Komisionit Evropian (2023),

në vitin 2022, shtetet anëtare raportuan 746 kalime të parregullta kufitare nga shtetas shqiptarë, 36% më pak se në vitin 2021 (1 160), ndërsa numri i shtetasve shqiptarë që u zbulua se qëndronin në mënyrë të parregullt në shtetet anëtare u rrit me 11.5% krahasuar me vitin 2021 (nga 34 840 në 2021 në 38 865 në 2022). Numri i refuzimeve të hyrjes për shtetasit shqiptarë në shtetet anëtare ra me 18,5% në vitin 2022 (nga 18 850 në 2021 në 15 350 në 2022). Numri i vendimeve të kthimit të lëshuara në vitin 2022 (24 180) u rrit me 8% krahasuar me vitin 2021 (22 445). Në vitin 2022 u raportuan 9 745 kthime të shtetasve shqiptarë, krahasuar me 8 610 në 2021 (një rritje prej 13%). Norma e kthimit u rrit pak nga 38% në 2021 në 40% në 2022 duke shënuar një ndryshim pozitiv të trendit nga vitet e kaluara.

Gjithashtu raporti thekson se numri i aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitura në shtetet anëtare nga shtetas shqiptarë u rrit me 14% midis 2021 dhe 2022, me 12 955 aplikime të depozituara në 2022. Norma e njohjes prej 9% në 2022 mbeti e pandryshuar nga viti 2021. Sipas raportit të vitit 2023, Shqipëria ka ndërmarrë veprime për të adresuar shumicën e rekomandimeve të mëparshme të Komisionit. Megjithatë, nevojitet përparim i mëtejshëm me fokus te përafrimi i mëtejshëm i politikës së vizave të Shqipërisë me listën e vendeve të kërkuara për viza të BE-së, veçanërisht në lidhje me vendet që paraqesin migracion të parregullt ose rreziqe sigurie për BE-në dhe vazhdimi i bashkëpunimit me shtetet anëtare më të prekura nga kërkesat e pabazuara për azil nga shtetasit shqiptarë, dhe zbatimi i fushatave informuese të përshtatura për regjimin pa viza.

Ky objektiv bashkon veprimet parandaluese në të gjitha fazat e migracionit, duke lidhur, në rastin e emigrimit të shtetasve shqiptarë, stimujt për të hyrë në tregun kombëtar të punës, duke ofruar informacion mbi rreziqet që lidhen me migrimin e parregullt dhe duke mbrojtur të drejtat e grupeve vulnerabël.

Si pjesë e objektivit specifik 1.4, palët e interesit kanë vendosur të ndërmarrin veprime, me synim:

- Uljen e nivelit të emigrimit të parregullt të qytetarëve shqiptarë nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit;

- Uljen e nivelit të imigrimit të parregullt të shtetasve të huaj falë forcimit të kontrollit të kufirit dhe territorit.

Shqipëria është e përkushtuar ndaj vizionit të Kompaktit Global, i cili kërkon që shtetet të "sigurojnë që migrantët aktualë dhe potencialë të jenë plotësisht të informuar për të drejtat, detyrimet dhe opsionet e tyre për migrim të sigurt dhe të rregullt, si dhe të jenë të vetëdijshëm për rreziqet e migrimit të parregullt. Ky angazhim është përforcuar në dialogun ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, i cili përqendrohet te zgjerimi i mundësive për migrim të rregullt (më së shumti, nëpërmjet lëvizjes afatshkurtër pa viza për qëllime turistike, por edhe përmes iniciativave që lehtësojnë migracionin cirkular) dhe zvogëlimit të shkallës së lëvizjes së parregullt, si dhe minimizimin e rreziqeve të lidhura me të.

Strategjia aktuale synon të kapitalizojë suksesin e aktiviteteve të tilla parandaluese afatgjata, duke synuar qytetarët shqiptarë në shpërndarjen e informacionit mbi pasojat e shkeljes së kushteve të hyrjes dhe qëndrimit si në kufi (që synojnë udhëtarët) ashtu edhe brenda vendit (informimi i migrantëve të mundshëm). Rëndësia e shpërndarjes së informacionit dhe ndërgjegjësimit për rreziqet e migrimit të parregullt dhe përfitimet nga pajtueshmëria me kushtet ligjore të migracionit theksohet në një masë prioritare të dedikuar. Në masën 1.4.1 "Informimi dhe ndërgjegjësimi", parashikohet një kombinim aktivitetesh, duke përfshirë një fushatë kombëtare informuese, aktivitete sensibilizuese të synuara në shkollat e mesme dhe shkollat e mesme profesionale të shoqëruara me trajnime të mësuesve. Në përputhje me prioritetet e tjera, theksohet roli i njësive të qeverisjes vendore të cilat do të jenë përgjegjëse për shpërndarjen e materialeve informative mbi mundësitë e migrimit të rregullt. Veprime të tjera në nivel vendor paraqesin zgjidhje të qëndrueshme për nxitësit e migracionit ekonomik në zonat më të prekura, si nxitja e punësimit, vetëpunësimi dhe trajnimi për punë mes të rinjve.

Strategjia është gjithashtu e ndërlidhur me përpjekjet e DKM-së për parandalimin e migracionit të parregullt, të përqendruar te kontrolli i statusit të qëndrimit të shtetasve të huaj në Shqipëri. Vlen të përmendet verifikimi i planifikuar i bazave për marrjen e vizave dhe lejeve të qëndrimit nga shtetas të vendeve me rrezikshmëri të lartë, që do të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme.

Përpjekje shtesë janë planifikuar për verifikimin e arsyeve për largim dhe rregullsinë e lëvizjes për të

mbrojtur të drejtat e grupeve të cenueshme (si fëmijët e pashoqëruar). DKM-ja gjithashtu ka për detyrë të vazhdojë përpjekjet, të njohura në procesin e anëtarësimit në BE, për parandalimin e migracionit të parregullt nëpërmjet ofrimit të materialeve informative në pikat e kalimit kufitar në gjuhën kryesore të migrantëve për kushtet e migrimit të rregullt në, përmes dhe nga Shqipëria.

Qëllimi i politikës II: Zhvillimi i politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin social-ekonomik kombëtar/vendor.

Punësimi mbetet motivi kryesor për migrimin e shtetasve shqiptarë, i nxitur, së pari, nga një diferencë e konsiderueshme e pagave midis tregjeve të punës në Shqipëri dhe atyre të destinacioneve kryesore (tradicionale, si Italia dhe Greqia dhe në zhvillim: Gjermania, Mbretëria e Bashkuar ose Shtetet e Bashkuara) dhe, së dyti, nga mundësitë e kufizuara për punësim në vendin e origjinës. Në tremujorin e parë të vitit 2022, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri për popullsinë 15 vjeç e sipër, është 11.3%. Shkalla e papunësisë është ulur me 2.1%, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2021, dhe është ulur me 0.4%, krahasuar me tremujorin paraardhës. [69] Një çështje kryesore, që kërkon vëmendje, është papunësia e lartë në mesin e emigrantëve të kthyer.

Ndikimi i lëvizjeve migratore të popullsisë shqiptare mbi zhvillimin social dhe ekonomik të vendit ka qenë i rëndësishëm. Për shumë vite, remitancat ndihmuan për të kapërcyer varfërinë e ardhur si pasojë e regjimit komunist. Si të tilla, ato vazhdojnë të japin një kontribut të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Megjithëse Shqipëria vazhdon të jetë e varur nga remitancat, flukset hyrëse ranë në tremujorin e dytë të 2020-s, me një humbje vjetore prej afro 35% (rreth 65 milionë euro). Në periudhën janar–shtator 2020, vlera e remitancave arriti në 471 milionë euro ose rreth 50 milionë euro (rreth 10%) më pak se në vitin 2019.[70] Dërgesat e emigrantëve janë rritur me rreth 14.6% në terma vjetorë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2021. Remitancat vjetore kanë shfaqur prirje rritëse gjatë tre viteve të fundit. Nga viti 2020 (1,276.38 milionë euro) në vitin 2022 (1,662.64 milionë euro). Për më tepër, për vitin 2021, shuma e remitancave ishte 1,455.49 milionë euro, që është më e lartë se në vitin 2020 dhe më e vogël se në vitin 2022, duke treguar tendencë në rritje të sasisë së remitancave vjetore.[71]

Pandemia e COVID-19 uli përkohësisht emigracionin dhe zvogëloi përqindjet e pjesëmarrjes në tregun kombëtar të punës, duke çuar në një rritje të shkallës së papunësisë për një periudhë afatshkurtër. Kthimi i punëtorëve migrantë nga vendet kryesore të destinacionit nxori në pah sfidën e përdorimit sa më të mirë të aftësive të tyre dhe integrimin e tyre në tregun shqiptar të punës. Megjithëse rimëkëmbja ekonomike pas COVID 19 në tregjet e huaja të punës ka sjellë një zbehje të lehtë të seriozitetit të çështjes, nevoja për përpjekje riintegruese, duke synuar të kthyerit, në mënyrë që të shfrytëzohen asetet e tyre arsimore, njohuritë dhe aftësitë për zhvillimin e qëndrueshëm të rajoneve të vendit, mbetet prioritet.

Objektivat specifikë

Qëllimi i dytë (hartimi i politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, rritja e ndikimit pozitiv të migracionit në zhvillimin social-ekonomik kombëtar/vendor) parashikohet të realizohet përmes ndjekjes *së tre objektivave specifikë* (fig. 3). Disa nga këto kërkojnë zgjidhje efektive, të ngritura nga strategjia e mëparshme (në veçanti, nevoja për migrim efektiv të fuqisë punëtore dhe lehtësim i lëvizjes së rregullt) ndërsa të tjerat u përgjigjen çështjeve afatgjata përmes përafrimit më të ngushtë me kuadrin GCM (rritja e kontributit të emigrantëve në zhvillimin e qëndrueshëm dhe sigurimi i riintegrimit të qëndrueshëm të migrantëve shqiptarë) (tabela 6). Të tre objektivat unifikohen duke u përqendruar në kategorinë kryesore të migrantëve, shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, dhe mbulojnë faza të ndryshme të migrimit. Ato përfshijnë arritjen e emigrantëve, rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për mundësitë e kthimit dhe riintegrimit, heqjen e pengesave për transferimin e remitancave, aftësive, kualifikimeve dhe kompetencave, si dhe zbatimin e aktiviteteve riintegruese dhe monitorimin e sfidave me të cilat përballen të kthyerit dhe nevojat e tyre të shfaqura për mbështetje.

[69] Anketa tremujore e fuqisë punëtore https://www.instat.gov.al/media/10081/anketa-tremujore-e-forcave-t%C3%AB-pun%C3%ABs-t1-2022.pdf.

[70] Banka e Shqipërisë: https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Revista_Ekonimike_6M2_2020_Shqip_19286.pdf

[71] Informacion nga Banka e Shqipërisë.

Fig. 3: Qëllimi i politikës II. Objektivat specifikë



Tabela 6. Përafrimi i politikës II me GCM-në

Politika II: Objektivat specifikë	Objektivat përkatës të GCM-së
2.1 Krijimi i mundësive ligjore dhe institucionale për migrimin për motive punësimi drejt dhe nga Shqipëria	5: Rritja e disponueshmërisë dhe fleksibilitetit të rrugëve për migrim të rregullt; 6: Lehtësimi i rekrutimit të drejtë dhe etik, dhe ruajtja e kushteve që sigurojnë punë të denjë.
2.2 Krijimi i mundësive dhe stimujve për migrantët për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm	19: Krijimi i kushteve për migrantët dhe diasporën që të kontribuojnë plotësisht në zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha kualifikimet dhe kompetencat e vendit; 20: Promovimi i transferimit më të shpejtë, më të sigurt dhe më të lirë të remitancave, dhe nxitja e përfshirjes financiare të migrantëve.
2.3 Garantimi i integrimit të qëndrueshëm të qytetarëve shqiptarë që kthehen nga emigracioni	18: Investimi në zhvillimin e aftësive dhe lehtësimi i njohjes reciproke të aftësive, kualifikimeve dhe kompetencave; 21: Bashkëpunimi për lehtësimin e kthimit dhe ripranimit të sigurt dhe dinjitoz, si dhe riintegrimin e qëndrueshëm; 22: Krijimi i mekanizmave për transportueshmërinë e të drejtave të sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve të fituara.

Objektivi i parë specifik (krijimi i mundësive ligjore dhe institucionale për migrimin për motive punësimi drejt dhe nga Shqipëria) bashkon disa masa prioritare nën një kuadër të vetëm politikash që rregullojnë migracionin, për punësim duke kombinuar reformat legjislative (përmirësimi i kuadrit ligjor), përmirësimin e aksesit të migrantëve në informacionin mbi migrimin e rregullt, për qëllime punësimi dhe sigurimin e një mjedisi etik të sigurt dhe jodiskriminues rekrutimi përmes rregullimit të agjencive private të punësimit.

Në përputhje me detyrimet në kuadër të zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, "Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës", do të përmirësohen sistemet *online* për krijimin e lehtësive në aplikim dhe akses të drejtpërdrejtë në tregun e punës.

Fushëveprimi i *objektivit specifik 2.1* mbulon masat prioritare, si më poshtë:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për migracionin për motive punësimi;
- Shpërndarja e informacionit mbi mënyrat, mundësitë dhe procedurat e migrimit për motive punësimi drejt dhe nga Shqipëria;
- Përmirësimi i veprimtarisë së agjencive private të punësimit.

Në mënyrë domethënëse, strategjia synon të përfshijë çështjet e migracionit në politikat dhe programet kombëtare të punësimit dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve në të gjitha fazat e migrimit (objektivi #6 i GCM-së). Si pjesë e qasjes "e gjithë shoqërinë", strategjia prezanton konsultime të rregullta publike në fushën e imigrimit për motive punësimi, të cilat jo vetëm që duhet të ndihmojnë në vlerësimin e politikave aktuale, por edhe në identifikimin e nevojave të mëtejshme për përshtatje.

Përafrimi ligjor dhe institucional i normave dhe standardeve kombëtare, që rregullojnë migracionin për motive punësimi me *acquis* të BE-së, synon të përmbushë kërkesat sipas katër kapitujve të

negociatave të anëtarësimit.[72] Gjatë periudhës së zbatimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të mbledhë raporte periodike analitike nga një sërë institucionesh përgjegjëse, si për mangësitë ashtu edhe për ndërhyrjet e planifikuara drejt përafrimit të legjislacionit dhe kuadrit institucional.

Gjithashtu, janë planifikuar ndryshime në ligjin "Për inspektimin e punës" për të forcuar standardet e rekrutimit të drejtë dhe etik, dhe mbrojtjen e kushteve për sigurimin e punës së denjë, në veçanti përforcimin e mekanizmave kundër punësimit informal, përfshirë atë të shtetasve të huaj në Shqipëri. Këto ndryshime do të rezultojnë gjithashtu në monitorimin e rregullt të procesit të punësimit të punëtorëve migrantë nga punëdhënësit shqiptarë. Duhet të bëhen ndryshime në aktet ekzekutive që rregullojnë funksionimin e agjencive private të punësimit dhe agjencive të punësimit të përkohshëm, si dhe informacioni mbi rregulloret e reja do të shpërndahet në formën e udhëzimeve. Paralelisht, do të zhvillohen konsultime me agjencitë private të punësimit për të përpunuar dhe shpërndarë standardet etike të punësimit.

Një fushë tjetër e rëndësishme është promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për migracionin për motive punësimi. Ndërhyrjet specifike përfshijnë përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për sigurimet shoqërore, të cilat do të mundësonin një llogaritje të plotë të kontributeve në pagesat e pensioneve për punëtorët migrantë shqiptarë, si dhe negocimin e marrëveshjeve dypalëshe me BE-në dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, për ndarjen e informacionit dhe pajisjen e migrantëve me dokumentacionin e nevojshëm të punës. Do të përdoret më tej dialogu në nivel nënrajonal për promovimin e rrugëve të rregullta dhe adresimin e mungesës së aftësive në të gjithë zonën e Ballkanit Perëndimor.

Objektivi i dytë specifik (krijimi i mundësive dhe stimujve për migrantët, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm), i përgjigjet objektivave #19 dhe #20 të GCM-së në zhvillimin e mënyrave se si emigrantët mund të kontribuojnë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, gjë që do të kërkojë ndërlidhje me investimet në nivel vendi, gjithashtu planifikimin dhe lehtësimin e transferimit të remitancave dhe përfshirjen financiare të migrantëve.

Si pjesë e *objektivit specifik 2.2,* parashikohen masat e mëposhtme prioritare:

- Identifikimi dhe regjistrimi i adresave të shtetasve shqiptarë që janë shtetas të përhershëm jashtë Shqipërisë;
- Promovimi i një transferimi më të shpejtë, më të sigurt dhe më të lirë të remitancave dhe përfshirja financiare e migrantëve;
- Tërheqja e shtetasve shqiptarë, të kthyerve potencialë, duke i informuar ata për mundësitë e punësimit dhe tregun e punës në vend;
- Promovimi i investimeve.

Institucionet shtetërore shqiptare kanë identifikuar pamundësinë për të vlerësuar shkallën dhe vendosjen e linjave të komunikimit me shtetasit e vendit që banojnë jashtë vendit, si një pengesë kryesore që duhet kapërcyer, për të siguruar që emigrantët shqiptarë të kontribuojnë për zhvillimin e vendit. Një masë prioritare, e planifikuar për vitin 2024, është zbatimi i një skeme vetëdeklarimi, sipas së cilës shqiptarët me banim të përhershëm jashtë vendit mund të regjistrohen *online*. Do të përdoren kanale të ndryshme për të ndërgjegjësuar grupin e synuar për sistemin dhe përfitimet që sjell ai, si shërbimet e dedikuara për emigrantët, duke përfshirë zyrat konsullore, shoqatat e emigrantëve dhe diasporës dhe rrjetet sociale. Këto masa ekonomike do të jenë plotësuese me aktivitetet më të gjera sociale dhe kulturore të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021–2025.

Banka e Shqipërisë është ngarkuar me ndërhyrje specifike, duke synuar uljen e kostove të transaksioneve të remitancav,e në përputhje me Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 dhe objektivin nr. 20 të GCM-së, si dhe ofrimin e informacionit *online* për këto kosto. Veprime shtesë synojnë të mbrojnë migrantët nga praktikat e padrejta ose diskriminuese, duke vazhduar të luftojnë flukset e paligjshme financiare, duke u zhvilluar në bashkëpunim me sektorin bankar dhe duke bërë instrumente financiare të aksesueshme, të dedikuara për familjet me të ardhura të ulëta dhe gratë kryefamiljare.

Një sërë ndërhyrjesh nën këtë objektiv nënvizon rolin që mund të luajë migrimi i kthimit në përmbushjen e nevojave të tregut kombëtar të punës. Strategjia përqendrohet në lloje të ndryshme

[72] Këto përfshijnë kapitullin 2 "Lëvizja e lirë për punëtorët"; kreu 3 "E drejta e themelimit dhe e ofrimit të shërbimeve"; kapitulli 19 "Politika sociale dhe punësimi" dhe kapitulli 24 "Drejtësia, liria dhe siguria".

burimesh informacioni, të cilat mund t'u shërbejnë të kthyerve potencialë, duke lehtësuar rihyrjen e tyre në tregun shqiptar të punës. AKPA-ja dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë cilësohen si institucionet kyçe për ofrimin e informacionit aktual dhe gjithëpërfshirës për procesin e kthimit dhe riintegrimit, dhe për kushtet e punësimit, përpunimin e materialeve informative dhe fushatat e zhvillimit, si dhe ofrimin e shërbimeve të referimit, krijimin e kanaleve të komunikimit ndërmjet të kthyerve potencialë dhe institucioneve shtetërore, dhe organizatave joqeveritare. Një hap i madh drejt bërjes më të aksesueshme të aseteve të ndryshme të informacionit do të jetë zhvillimi i një faqeje të dedikuar interneti për riintegrim, shërbime dhe iniciativa hartografike në fushën e punësimit, arsimit dhe formimit profesional, si dhe strehimit dhe investimeve. Paralelisht, informacioni që synon të kthyerit duhet të shpërndahet vazhdimisht përmes mediave masive dhe sociale.

Strategjia përmban gjithashtu disa ndërhyrje që janë thelbësore për krijimin e një programi riintegrimi afatgjatë dhe menaxhimin fleksibël të migracionit për motive punësimi të bazuar në evidenca. Për të vlerësuar se si të kthyerit mund të kontribuojnë në tregun kombëtar të punës dhe cilat nevoja të mëtejshme për fuqi punëtore ka të ngjarë të vazhdojnë, janë planifikuar disa aktivitete diagnostikuese. Së pari, do të bëhet një auditim i kapaciteteve intelektuale dhe profesionale të emigrantëve shqiptarë. Së dyti, politikat e migracionit për motive punësimi duhet të marrin në konsideratë ndryshimin e kërkesës sektoriale për punën e migrantëve nëpërmjet konsultimeve të rregullta me organizatat e punëdhënësve dhe të punonjësve.

Strategjia njeh gjithashtu kontributin më të gjerë që shqiptarët që jetojnë jashtë vendit kanë dhënë në ekonominë e vendit dhe synon të promovojë lloje të ndryshme investimesh që do të kryhen nga kategori të ndryshme shtetasish që banojnë jashtë kufijve të Shqipërisë. Aktivitetet e parashikuara deri në vitin 2030 janë të natyrës themelore, duke synuar identifikimin e aseteve (financiare, intelektuale, aftësitë), nivelin e interesit, si dhe pengesat për investimet në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, pranohet se për përmirësimin e klimës së investimeve, angazhimi i grupeve dhe institucioneve të diasporës, përfshirë dhomat e biznesit është thelbësor.

Objektivi i tretë specifik (garantimi i riintegrimit të qëndrueshëm të qytetarëve shqiptarë që kthehen nga emigracioni), synon shfrytëzimin e potencialit të të kthyerve shqiptarë nga emigracioni. Duke pasur parasysh se të kthyerit përbëjnë një shumicë dërrmuese të emigrantëve dhe kanë lidhje të forta me rajonet e origjinës, kjo kategori emigrantësh është përzgjedhur si prioritet. Për të zhvilluar një mekanizëm gjithëpërfshirës për kthimin dhe riintegrimin, është planifikuar që roli kyç i AKPA-së të plotësohet me një qasje ndërinstitucionale, duke përfshirë grupin ndërinstitucional të punës.

Si pjesë e *objektivit specifik 2.3:* këto masa prioritare janë planifikuar:

- Hartimi dhe miratimi i programeve të dedikuara për riintegrimin e të kthyerve nga emigracioni;
- Investimi në zhvillimin e aftësive dhe lehtësimi i njohjes reciproke të aftësive, kualifikimeve dhe kompetencave;
- Përmirësimi i ofertës për arsim dhe trajnim profesional;
- Krijimi i mekanizmave për transportueshmërinë e të drejtave të sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve të fituara.

Objektivi specifik plotëson objektivat e mëparshëm, duke mbuluar fazën e kthimit të emigrantëve shqiptarë dhe duke kërkuar të trajtojë nevojat e tyre për riintegrim. E rëndësishme është se hartimi dhe modifikimi i aktiviteteve të dedikuara riintegruese, të përqendruara te punësimi aktiv i të kthyerve, duhet të bazohet në monitorimin e vazhdueshëm të nevojave të përfituesve të programit. Raportimi periodik nga ofruesit e shërbimeve duhet t'i mundësojë MEKI-t një shënjestrim dhe përshtatje më të mirë të mbështetjes së ofruar. Një faktor tjetër që synon t'u përgjigjet nevojave të veçanta të të kthyerve në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe efektive është përfshirja më e ngushtë e planifikuar e zyrave vendore të punës, zyrave vendore të zhvillimit ekonomik dhe qendrave të formimit profesional në hartimin e programeve për lehtësimin e punësimit. Të gjitha këto aktivitete paraprake duhet të vendosin themelet për objektivin përfundimtar të krijimit të një mekanizmi të përhershëm ndërinstitucional për kthim dhe riintegrim.

Një grup veçanërisht i cenueshëm është ai i shtetasve shqiptarë të ripranuar nga BE-ja. Për t'iu përgjigjur nevojave të tyre të veçanta dhe për të lehtësuar procesin e ripranimit dhe riintegrimit pas

kthimit, janë planifikuar ndërhyrje të dedikuara. Së pari, strukturat përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit do të lidhin marrëveshje, duke rregulluar bashkëpunimin operacional me organet përgjegjëse për rihyrjen e personave të ripranuar në tregun e punës, trajnimin profesional dhe ndihmën ekonomike e sociale. Së dyti, personat e ripranuar do të sigurohen nga një sërë organesh shtetërore të nivelit qendror dhe vendor, si dhe nga IOM-i lidhur me shërbimet e disponueshme të riintegrimit. Të dyja ndërhyrjet janë thelbësore për sigurimin e orientimit të qetë të të kthyerve dhe përmirësimin e aftësive të tyre për akses dhe përfitim nga një sërë shërbimesh publike dhe jopublike.

Dy masa janë krijuar në mënyrë që migrantët e kthyer të mund të kapitalizojnë aftësitë e fituara gjatë punës së tyre jashtë vendit dhe t'i zbatojnë ato për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë. Bazuar në masat që inkurajojnë migrimin e rregullt për punësim, dhe duke njohur një kërkesë në rritje për aftësitë dhe kualifikimet e migrantëve në tregun shqiptar të punës, strategjia synon të lehtësojë transferimin dhe njohjen formale të arritjeve arsimore dhe profesionale, të fituara jashtë vendit. Vëmendje i kushtohet mësimit joformal dhe informal dhe kurseve afatshkurtra, si nëpërmjet certifikimit ashtu edhe njohjes së dokumenteve të certifikimit të lëshuara jashtë vendit. Një grup tjetër ndërhyrjesh (që do të koordinohen nga AKPA-ja) synon të përmirësojë aftësitë e migrantëve aktualë dhe të mundshëm në mënyrë që të rrisë punësueshmërinë e tyre. Në veçanti, vëmendje i kushtohet si aftësive bazë, thelbësore dhe teknike (të rëndësishme për marrjen e posteve, që kërkojnë kompetenca teknike të certifikuara), edhe aftësitë digjitale, jetike për zhvillimin e punëve *online* dhe të largëta, si dhe për pjesëmarrjen në sektorin në rritje të shërbimeve. Masa tjetër synon mbrojtjen e të drejtave dhe përfitimeve të të kthyerve në fushën e sigurimeve shoqërore me anë të marrëveshjeve dypalëshe dhe partneriteteve me vendet e rezidencës së emigrantëve. Një rishikim i marrëveshjeve aktuale për njohjen e periudhave të kontributeve do të përdoret për vlerësimin e nevojës për lidhjen e marrëveshjeve të reja.

Qëllimi i politikës III: Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare.

Nën termat e liberalizimit të vizave me BE-në, nevojiten përpjekje të vazhdueshme që Shqipëria të përmbushë kërkesat për heqjen e vizave. Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar ndaj politikës afatgjatë të promovimit të migracionit të rregullt, si i dobishëm për migrantët, si dhe për vendet e tyre të origjinës dhe destinacionit. Sipas raportit më të fundit të monitorimit të pezullimit të vizave të Komisionit Evropian, në vitin 2021, u vu re ulje e mëtejshme e lëvizjeve të parregullta pasi shtetet anëtare të BE-së raportuan 19% më pak kalime të parregullta kufitare dhe u vu re një rënie prej 8% në numrin e kthimeve të shtetasve shqiptarë. Në të njëjtën kohë, mbetet shumë punë për t'u bërë pasi në vitin 2021 u raportuan rritje të ndjeshme të numrit të shtetasve shqiptarë që qëndrojnë në mënyrë të parregullt në BE (21% më shumë se në 2020) dhe në refuzimet e hyrjes (një rritje prej 39%) në shtetet anëtare të BE-së.

Zvogëlimi i shkallës së migracionit të parregullt tranzit dhe lufta kundër trafikimit dhe kontrabandës së migrantëve mbetet një prioritet, dhe Komisioni i BE-së pranon përparimin në këtë fushë. Departamenti për Kufijtë dhe Migracionin raportoi për vitin 2022 një rënie me 17% të numrit të kapjes për herë të parë të migrantëve të parregullt në Shqipëri (8,335 krahasuar me 10,062 në 2021). Vlen të theksohet se Shqipëria zbaton rregullisht procedurat për trajtimin e të miturve të pashoqëruar. Konkretisht, udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 640, datë 20.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave të veçanta për kalimin në kufi të shtetasve të mitur shqiptarë", zbatohet me qëllim minimizimin dhe zbulimin e rasteve të braktisjes dhe abuzimit nga trafikantët dhe përfituesit e tjerë. Gjithashtu është përmirësuar mekanizimi i kthimit të fëmijëve shqiptarë dhe të huaj të pashoqëruar, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional për të qenë sa më i koordinuar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Policisë së Shtetit.

Analiza e trendeve të migracionit zbulon zhvendosjen graduale të Shqipërisë nga një vend i origjinës së migrantëve në atë të tranzitit dhe destinacionit. Si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE dhe përafrimi i politikës së saj të migracionit me kuadrin e GCM-së, Shqipëria është e angazhuar të garantojë të drejta të barabarta për të huajt që banojnë në territorin e saj. Parimi i mosdiskriminimit duhet të mbahet përmes një kombinimi të ndërhyrjeve (monitorimi, dispozitat e

informacionit, shkëmbimi i të dhënave). Përpjekje shtesë janë parashikuar për të plotësuar nevojat specifike të fëmijëve, të rinjve dhe kategorive të tjera të migrantëve në situata të cenueshme.

Objektivat specifikë

Qëllimi i tretë *(promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare)* parashikohet të realizohet nëpërmjet ndjekjes së një objektivi specifik. Ai është plotësues në natyrë, duke hedhur themelet për një politikë gjithëpërfshirëse afatgjatë të integrimit të migrantëve, e cila është me rëndësi thelbësore për përmbushjen nga Shqipëria të një sërë objektivash të GCM-së (në veçanti objektivat 3 7, 15, 16 dhe 17).

Fig. 4: Qëllimi i politikës III. Objektivat specifikë



Tabela 7. Përafrimi i politikës III me GCM-në

Objektivat specifikë të politikës III	Objektivat përkatës të GCM-së
3.1 Mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare	3: Sigurimi i informacionit të saktë dhe në kohë në të gjitha fazat e migrimit; 16: Fuqizimi i migrantëve dhe shoqërive për të realizuar përfshirjen e plotë dhe kohezionin social; 17: Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit dhe promovimi i dialogut publik të bazuar në prova për të formuar perceptimet e migracionit.

Nëpërmjet objektivit specifik 3.1, rikonfirmohet angazhimi nga strategjia e mëparshme për hartimin dhe miratimin e programeve të integrimit të emigrantëve. Ky hap është i nevojshëm për të siguruar që programet afatgjata financohen, ekzekutohen dhe monitorohen siç duhet. Objektivi shtrin/përfshin garancinë e mbrojtjes së të drejtave dhe trajtimin jodiskriminues për të gjithë personat që banojnë në Shqipëri dhe kërkon që mbrojtja të jetë thelbësore dhe jo thjesht deklarative.

Objektivi specifik 3.1 parashikon si masë të parë prioritare: *informimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të të huajve që banojnë në territorin e Shqipërisë*. Katër ndërhyrje brenda fushës së tij do të drejtohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili do të bashkëpunojë me një gamë të gjerë institucionesh shtetërore, si dhe me IOM-in dhe UNHCR-në. Të gjitha ministritë e linjës janë zotuar të kontribuojnë me informacion në raportet vjetore të monitorimit mbi kushtet aktuale të aksesit të të drejtave të migrantëve sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, MEKI dhe AKPA-ja do të paraqesin raporte për zbatimin e normave të mosdiskriminimit në fushën e punësimit në sektorë të ndryshëm, siç zbatohen për shtetasit e BE-së dhe anëtarët e familjeve të tyre. Këto ndërhyrje kanë rëndësi thelbësore për: identifikimin e pengesave me qëllim realizimin e garancive ligjore; rekomandime për veprime shtesë për të kapërcyer ato pengesa dhe për të eliminuar kështu të gjitha format e diskriminimit (objektivi i GCM #17) dhe së fundi për të lehtësuar përfshirjen e plotë të migrantëve (objektivi i GCM #16).

Në përputhje me qasjen e përgjithshme, të respektuar gjatë të gjithë strategjisë, dhënia e informacionit shihet si një faktor jetik për sigurimin e mbrojtjes nga diskriminimi, në bazë të masës së parë prioritare (3.1.1). Emigrantët inkurajohen të vizitojnë faqet e internetit zyrtare të disa organeve shtetërore, veçanërisht të Ministrisë së Brendshme, për të marrë informacion mbi rrugët drejt qëndrimit të rregullt. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga ana e tij, do të udhëheqë përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e normave jodiskriminuese dhe aksesin në mekanizmat e ankesës. Informacioni për shërbimet do të vihet në dispozicion në disa gjuhë në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe materialet e dedikuara për PKK-të do të vihen në dispozicion në kufi, si dhe në zyra në të gjithë vendin.

Si pjesë e objektivit specifik 3.1, masa e dytë prioritare (lehtësimi i aksesit në shërbimet publike të garantuara me ligj) parashikohet si një hap tjetër i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Sipas masës 3.1.2, dy ndërhyrje do të drejtohen nga Ministria e Brendshme, e cila do të bashkëpunojë me ministritë përgjegjëse të linjës, por

edhe me institucionet partnere, si UNHCR.-ja Gjithashtu, MEKI dhe MSHMS-ja do të ofrojnë mbështetjen e tyre përmes ndërhyrjeve të përkushtuara, qëllimi i të cilave është të trajnojë mjekët, infermierët dhe personelin spitalor dhe shëndetësor për të përmirësuar shërbimet për të huajt dhe punëtorët migrantë në vend, duke kuptuar më mirë përcaktuesit e rreziqeve përkatëse shëndetësore dhe sociale, si dhe ndikimin e kulturës në shëndet dhe sëmundje.

Gjithashtu, për të rritur ndërgjegjësimin, përfshirjen dhe angazhimin/socializimin e migrantëve në komunitet, masa e tretë prioritare (3.1.3) fokusohet në krijimin e praktikave në nivel lokal dhe qendror për rritjen e pjesëmarrjes së migrantëve në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse në nivel vendor, të udhëhequra nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, do të mbahen seanca sensibilizuese për nxënësit dhe mësuesit në institucionet e arsimit parauniversitar për parandalimin e gjuhës së urrejtjes, racizmit dhe formave të tjera të diskriminimit ndaj migrantëve. Një hap tjetër, që pritet të bëhet, lidhet me përfshirjen në planet vendore për migracionin dhe diasporën për të garantuar të drejtat e migrantëve në komunitet, për të siguruar pjesëmarrje aktive në komunitet. Një rol thelbësor për realizimin me sukses të kësaj ndërhyrjeje do të jetë zhvillimi i dialogut tekniko-politik ndërmjet NJVV-ve dhe strukturave të pushtetit qendror për zbatimin e programeve integruese, si një nga prioritetet afatshkurtra që do të publikohet gjatë periudhës 2024–2026. Këto ndërhyrje janë në përputhje edhe me angazhimet e marra në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, "Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës".

Në përputhje me praktikat e vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera me politika të zhvilluara migracioni, Shqipëria është e përkushtuar për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme për emigrantët. Ky grup masash është plotësues i angazhimit për të hapur shtigje të rregullta për pranim dhe për të siguruar integrimin e qëndrueshëm të migrantëve, të mbuluar më parë. Strategjia e re pranon se ndërkohë që marrja e formave të rregullta të statusit është një kusht i domosdoshëm i integrimit, nevojitet mbështetje shtesë, në mënyrë që migrantët të jenë në gjendje të marrin pjesë në jetën e komunitetit lokal dhe të kontribuojnë në zhvillimin e tij, gjë që është në përputhje me vizionin e përgjithshëm të strategjisë. Të gjitha këto angazhime e sjellin qeverisjen e migracionit të Shqipërisë më afër kuadrit të GCM-së, i cili bazohet në parimet e barazisë së të drejtave dhe të mosdiskriminimit (objektivi #17).

Përafrimi sa më i plotë me politikën e vizave të BE-së do të jetë një nga synimet kryesore, në përputhje kjo edhe me zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, "Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës". Në këtë drejtim: deri në vitin 2030 do të vijojë ndërprerja në mënyrë graduale e regjimeve pa viza me vendet, qytetarët e të cilave u kërkohet viza në BE, për mekanizmin e zbatuar gjatë sezonit turistik; do të kryet një vlerësim periodik i situatës dhe i rreziqeve të abuzimit me regjimin pa viza për shtetasit e vendeve të treta, të cilëve u kërkohet vizë për të hyrë në BE, bazuar në të dhënat kombëtare, si dhe informacionin e dhënë nga FRONTEX-i dhe autoritetet e shteteve anëtare të BE-së, si dhe gjatë periudhës 2024–2025 do të miratohen marrëveshje me vendet nga të cilat shtetasit mund të hyjnë në BE pa vizë, por janë nën detyrimin për vizë në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi i politikës IV: Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve, dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme

Organizimi institucional dhe kuadri ligjor për azilin është kryesisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së, por ka nevojë për vijimin e hapave konkretë, duke marrë në konsideratë edhe përditësimin e të dhënave në përputhje me zhvillimet në vendet anëtare të BE-së. Sipas progres raportit të vitit 2023 të Komisionit Evropian, ligji i vitit 2021 për azilin është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së dhe janë miratuar të gjitha pjesët, përkatësisht 15 akte nënligjore. Duhet theksuar se Shqipëria vazhdon të jetë kryesisht një vend tranzit, i konsideruar si i tillë si nga komuniteti i refugjatëve dhe emigrantëve ashtu edhe nga autoritetet shqiptare. Në vitin 2022, 125 persona bënë kërkesë për azil në Policinë e Kufirit dhe Migracionit, krahasuar me 85 në vitin 2021. Fakti që vetëm 1% e të gjithë emigrantëve të ardhur në vitin 2022, shumica e të cilëve vinin nga vende me shkallë të lartë mbrojtjeje në BE iu referuan procedurave të azilit, nënvizon nevojën për

të përmirësuar referimet dhe aksesin në procedurat e azilit.

Ligji "Për azilin në RSH", bazohet kryesisht në parimet e Konventës së Gjenevës, por është edhe një akt ligjor i përafruar me CEAS, në dispozitat e të cilit parashikohet respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve. Megjithatë, edhe pse ligji u jep azilkërkuesve të drejtën për të aksesuar shërbimet publike në të njëjtin nivel me shtetasit shqiptarë, duhet punuar më shumë për të arritur përputhshmërinë me aktet e tjera ligjore dhe plotësimin e mungesave të kapaciteteve zbatuese që i pengon azilkërkuesit të kenë akses në shërbime në mënyrë efektive. Për zbatimin efikas të ligjit dhe arritjen e një standardi të lartë parashikohen investime shtesë në kapacitetet administrative dhe për të garantuar zhvillimin e përgjithshëm të një sistemi azili që funksionon mirë. Një udhëzim i rishikuar *prescreening* u miratua në vitin 2022 dhe fokusi parësor mbetet zbatimi i tij në praktikë.

Në vitin 2022, numri i emigrantëve të parregullt që hynë në Shqipëri u reduktua me 34% krahasuar me vitin 2021. Sa i takon kërkesave për azil, gjatë vitit 2023 janë paraqitur për shqyrtim pranë autoritetit përgjegjës në Ministrinë e Brendshme, 31 kërkesa. Ndërsa nga të dhënat e Qendrës Pritëse për Azilkërkues janë paraqitur në qendër si azilkërkues, 256 persona. Lidhur me procedurën e ndjekur autoriteti përgjegjës shqyrton brenda afatit ligjor të gjitha kërkesat për azil të cilat zgjasin mesatarisht 6 muaj.

Në këtë kontekst, përpjekjet e vazhdueshme dhe të qëndrueshme janë në vazhdim, duke përfshirë vazhdimin e bashkëpunimit me Agjencinë e Azilit të Bashkimit Evropian (EUAA) për të forcuar aksesin në procedurën e azilit përmes identifikimit, informacionit dhe referimit të zgjeruar të aplikantëve të mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare dhe personave vulnerabël, si dhe për të përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes, duke përforcuar aftësitë teknike të autoriteteve përcaktuese në shkallën e parë dhe të dytë, si dhe duke këshilluar për mekanizmat/flukset e punës për zbatimin më të mirë të procedurave të azilit. Për të adresuar harmonizimin ligjor me BE-në dhe për të kryer detyrat operacionale në mënyrë efektive, në fusha të ndryshme të qeverisjes së migracionit, parashikohet të ndërmerren hapa konkretë përmes objektivave specifike.

Objektivat specifikë

Qëllimi i katërt (Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme) parashikohet të realizohet nëpërmjet ndjekjes së tre objektivave specifikë.

Fig. 5: Qëllimi i politikës IV. Objektivat specifikë



Tabela 8. Përafrimi i politikës IV me GCR-të

Politika IV. Objektivat specifikë	Objektivat përkatëse të GCR-ve
4.1 Përmirësimi i efikasitetit, aksesit dhe apelimit në procedurën e azilit	1. Lehtësimi i presioneve ndaj vendeve pritëse
4.2 Sigurimi i identifikimit, mbrojtjes dhe pritjes, në përputhje me standardet ndërkombëtare për personat me nevoja të veçanta	2. Rritja e vetëbesimit të refugjatëve 3. Zgjerimi i aksesit në vendet e treta
4.3 Integrimi social-ekonomik i refugjatëve dhe azilkërkuesve	

Fushëveprimi i objektivit specifik 4.1: Përmirësimi i efikasitetit, aksesit dhe apelimit në procedurën e azilit do të kryhet duke bërë fillimisht vlerësimin e kuadrit ligjor kombëtar, i cili trajton çështjet e azilit dhe parashikon të drejtat dhe trajtimin e azilkërkuesve, dhe refugjatëve në RSH. Për adresimin, realizimin dhe arritjen e objektivit specifik, përfshihen masat e mëposhtme prioritare:

- Rishikimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit për azilin;
- Amendimi i ligjit për azilin dhe vijimin e përafrimit të tij me direktivat e BE-së;
- Hartimi i propozimeve për amendimin e ligjeve specifike si "Strehimi social", ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ligji i ndihmës ekonomike;
- Hartimi dhe miratimi i Planit të Kontigjencës për t'ju përgjigjur flukseve të përziera migratore.

Masat e mësipërme përfshijnë vlerësime paraprake, të cilat shërbejnë për të identifikuar më mirë pengesat aktuale dhe nevojat e paplotësuara për përmirësimin e efikasitetit dhe aksesin në procedurën e azilit. Deri në vitin 2025, MB-ja, MSHMS-ja, MEKI dhe MEPJ-ja duhet të vlerësojnë programet dhe politikat e tyre për amendimin e ligjit për azilin dhe përafrimi i tij me CEAS, për procedurën e azilit. Duke qenë se projektligji është i përafruar pjesërisht parashikohet të bëhen ndryshime në përputhje me kornizën ligjore të BE-së, si më poshtë73 dhe standardet.

Një tjetër masë prioritare (4.1.2) për arritjen e objektivit specifik është sigurimi i praktikave të thjeshta dhe standarde për aksesin në azil dhe procedurat e ankimit. Brenda vitit 2024, hartimi i formateve standarde për aplikimin në gjuhët kryesore për mbrojtje ndërkombëtare dhe për formatet të ankimit sipas parashikimeve ligjore. Nën udhëheqjen e MB-së, prioritetet afatshkurtra për 2024–2025 përfshijnë prodhimin e materialeve informuese për kushtet, të drejtat dhe detyrimet nga procesi i azilit dhe vendosja në të gjitha pikat e kalimit kufitar, si dhe ofrimin e shërbimeve zyrtare të përkthimit për t'ju përgjigjur më mirë nevojave të migrantëve për procedurat e azilit. Deri në vitin 2026, do të ofrohet përkthim zyrtar dhe mbështetje ligjore në kufi për personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Për më tepër, Udhërrëfyesi i gjeneratës së ardhshme për Bashkëpunimin midis EUAA dhe Shqipërisë parashikohet të miratohet në vitin 2024, me një kohëzgjatje zbatimi prej 3 vjetësh. Ky partneritet midis EUAA dhe Ministrisë së Brendshme do të vazhdojë të forcojë sistemet e azilit dhe pritjes, në përputhje me Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit dhe standardet e BE-së.

Në përputhje me qasjen e përgjithshme, strategjia gjithashtu parashikon edhe masën e tretë prioritare (4.1.3) rritjen e kapaciteteve të stafit përgjegjës për procedurat e azilit. Për arritjen e objektivit specifik është parashikuar organizimi i trajnimeve të vazhdueshme të oficerëve në kufi, lidhur me aksesin në procedurat e azilit dhe të autoritetit për azilin, për shqyrtimin e aplikimeve dhe marrjen e vendimeve deri në vitin 2026. Përgjatë vitit 2024, me mbështetjen e të gjitha ministrive të linjës, do të hartohet një udhërrëfyes për koordinimin ndërinstitucional për procedurat e azilit. Po kështu, gjatë 2024-s për shqyrtimin e aplikimeve për azil me efikasitet dhe për t'iu përgjigjur brenda afateve të parashikuara aplikimeve, do të rritet numri i stafit në Drejtorinë për Azilin dhe Shtetësinë, në Ministrinë e Brendshme.

Objektivi i dytë specifik (sigurimi i identifikimit, mbrojtjes dhe pritjes, në përputhje me standardet ndërkombëtare për personat me nevoja të veçanta), synon të sigurojë efektivitet gjatë procedurave, ofrim efikas të shërbimeve dhe mbrojtje në situata të cenueshme, të fëmijëve, të rinjve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Objektivi specifik 4.2 parashikon tre masa prioritare për të

Direktiva 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001, "Për standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të zhvendosur dhe për masat që nxisin një ekuilibër përpjekjesh midis anëtarëve të shtetit për pritjen e këtyre personave dhe përballimin e pasojave".

Direktiva 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003, "Për të drejtën e bashkimit familjar".

Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, "Për standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët. ose për personat që kanë të drejtën e mbrojtjes plotësuese, dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së ofruar".

Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Për procedurat e zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare".

[73] Direktiva 2013/33/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Për përcaktimin e standardeve për pranimin e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare".

përmbushur të drejtën e të gjithë individëve për një identitet ligjor, duke u ofruar të gjithë shtetasve prova të shtetësisë dhe dokumentacionin përkatës.

Si masë e parë prioritare 4.2.1 parashikohet identifikimi i shpejtë i personave me nevoja të veçanta gjatë procedurave të përzgjedhjes, duke hartuar procedura standarde, me tregues të qartë për identifikimin e grupeve vulnerabël në kufi. Deri në vitin 2026, pritet përmirësim në nivelin dhe cilësinë e ofrimit të ndihmës juridike falas për të gjithë aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare dhe shërbimeve të specializuara psikologjike, rehabilituese dhe këshilluese për personat që kanë përjetuar dhunë, abuzim, shfrytëzim seksual dhe trafikim, përkatësisht ofrimi i përkthimit të licencuar zyrtar dhe ndihmës psikologjike për grupet vulnerabël në procesin e përzgjedhjes/prescreening. Një hap tjetër për të siguruar marrjen e masave të duhura për personat me nevoja të veçanta është edhe trajnimi i oficerëve të policisë në kufi për komunikimin etik dhe efektiv me grupet vulnerabël.

Masa e dytë prioritare (përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve njerëzore në qendrat pritëse dhe tranzitore për të siguruar plotësimin e nevojave të grupeve vulnerabël) synon përshtatjen e infrastrukturës në qendrat pritëse për personat me nevoja të veçanta, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në kuadër të përgjigjes së nevojave të grupeve vulnerabël, Ministria e Brendshme, me mbështetjen e MSHMS-së, EUAA, UNHCR-së dhe IOM-it do të kryejnë fillimisht vlerësimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe të burimeve njerëzore në qendrat pritëse për azilkërkues. Në mënyrë që të ofrohen shërbime adekuate dhe efikase, deri në vitin 2026 synohet shtimi i personelit shëndetësor të kualifikuar, transportit të posaçëm, pajisjeve dhe paketave dhe në qendrat pritëse.

Për të harmonizuar qasjen për fëmijët e pashoqëruar, është parashikuar masa e tretë prioritare (mbrojtje e veçantë për fëmijët e huaj të pashoqëruar). Për adresimin e kësaj mase prioritare 4.2.3, për periudhën 2020–2025, planifikohet hartimi i procedurave të specializuara për vlerësimin moshor të fëmijëve të huaj të pashoqëruar. Gjatë periudhës 2024–2026, nëpërmjet MEPJ-së pritet shkëmbimi i informacionit me përfaqësitë diplomatike, për gjurmimin e familjes së fëmijës/ve të pashoqëruar, duke përfshirë sigurimin e dokumenteve përkatëse të identitetit dhe të gjendjes civile. Po kështu, parashikohet përmirësimi i sistemeve të regjistrit civil, me fokus të veçantë në arritjen e personave të paregjistruar, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve dhe investimin në zgjidhjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, me qëllim ruajtjen e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Deri në vitin 2026, do të merren edhe dy masa të tjera për të siguruar mbrojtjen e veçantë të fëmijëve të pashoqëruar. Specifikisht nën drejtimin e MB-së do ngrihet një qendër rezidenciale kombëtare pritëse e dedikuar për fëmijët e huaj të pashoqëruar, si dhe MAS-i dhe MEKI do të udhëheqin zhvillimin e programeve specifike mbështetëse për fëmijët e pashoqëruar në sport, kulturë, art etj.

Fushëveprimi i objektivit specifik 4.3 (integrimi social-ekonomik i refugjatëve dhe azilkërkuesve) përfshin dy masat prioritare si më poshtë:

- Programe me qëllim integrimin social-ekonomik të azilkërkuesve, refugjatëve;
- Ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për personat me mbrojtje ndërkombëtare.

Për masën e parë prioritare (programe me qëllim integrimin social-ekonomik të azilkërkuesve, refugjatëve), MAS-i planifikon organizimin e programeve orientuese të mësimit të gjuhës shqipe, historisë dhe edukatës qytetare për integrimin e tyre në jetën në komunitet. Do të ndërtohen programe mbi praktikat ekzistuese në nivel lokal, që lehtësojnë pjesëmarrjen në jetën e komunitetit, si ndërveprimi me autoritetet dhe aksesi në shërbimet përkatëse, nëpërmjet lëshimit të kartave të regjistrimit për të gjithë personat që jetojnë në një komunë, përfshirë migrantët, që përmbajnë informacione personale bazë, ndërkohë që nuk përbëjnë të drejta për shtetësi ose qëndrim. Deri në vitin 2025, MSHMS-ja do të hartoj një udhërrëfyes për zbatimin e programeve orientuese të integrimit bazuar në përgjegjësitë institucionale dhe, deri në vitin pasardhës (2026), Avokati i Popullit do të kryejë monitorimin periodik të zbatimit të masave integruese, nëpërmjet sondazheve dhe intervistave direkte me përfituesit (refugjatë/azilkërkues).

MEKI, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të vazhdojë përfshirjen e refugjatëve dhe azilkërkuesve në programe të veçanta për nxitjen e punësimit, arsimit profesional, strehimit social, etj., duke raportuar të dhëna konkrete mbi numrin e përfituesve nga këto programe.

Gjatë vitit 2024, ASHMDF-ja do të kryejë një vlerësim se si mund të nxitet pjesëmarrja e të

miturve dhe të rinjve për arsimimin, kualifikimin profesional, trajnimin dhe punësimin e të rinjve/të rejave.

Nga ana tjetër, MAS-i synon përmirësimin e kushteve për shkollimin parësor për fëmijët e azilkërkuesve dhe refugjatëve deri në 2025, bazuar në udhëzimin e datës 17 maj 2021. Për të integruar migrantët në mënyrë efektive, MSHMS-ja do të bëjë të mundur trajnimin dhe kualifikimin e trajnerëve/mediatorëve kulturorë për zhvillimin e programeve integruese deri në vitin 2026.

PJESA III – PROJEKTET/PROGRAMET KOMBË-TARE TË ZHVILLIMIT PËR ZBATI-MIN E STRATEGJISË

Mekanizmat koordinues, zbatues dhe moni-torues

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit do të zbatohen ndërmjet viteve 2024 dhe 2030. Ministria e Brendshme do të marrë rolin udhëheqës në zbatimin e strategjisë, si institucioni përgjegjës për migracionin. Kjo strategji do të ketë dy plane veprimi, njëri që mbulon afatin midis 2024 dhe 2026 dhe tjetri midis 2027 dhe 2030.

Progresi në arritjen e objektivave të strategjisë do të matet me disa tregues të lidhur me objektivat dhe masat specifike, të përcaktuara në Planin e Veprimit. Përgjegjësia për të monitoruar përfundimin në kohë të çdo mase sipas planit do t'i ngarkohet një institucioni drejtues qeveritar, bazuar në masën përkatëse, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe dhe kur kërkohet zbatimi i përbashkët nga disa institucione në të njëjtën kohë, i shoqëruar nga një ose disa institucione të tjera ose organizata mbështetëse/shoqëri civile. Institucioni drejtues do të përcaktojë në detaje nënindikatorët. Ai do të përcaktojë modelin dhe procedurat e raportimit dhe do të mbajë komunikim të rregullt me të gjitha agjencitë përgjegjëse për masën përkatëse. Udhëheqësi do të caktojë një person kontaktues i cili do të ketë për detyrë të shkruajë raporte të rregullta bazuar në të dhënat standarde të mbledhura nga agjencitë/institucionet e tjera.

Detyrat e lidhura me migracionin në Ministrinë e Brendshme mbulohen nga Njësia e Migracionit, e cila shërben në të njëjtën kohë me Sekretariatin Teknik për Migracionin (SKM). Ky entitet do të monitorojë progresin, duke u siguruar që ai të jetë gjithëpërfshirës, të mbulojë të gjitha shtyllat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, të jetë i përditësuar dhe të mbështetet në informacionin aktual dhe standard. Sekretariati Teknik pranë Ministrisë së Brendshme do të koordinojë punën monitoruese dhe ndërveprimin me sekretariatet e tjera teknike për migracionin, të ngritura pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si tre institucionet kryesore për menaxhimin e migracionit. Qeverisja në Shqipëri, të cilat kanë një numër të konsiderueshëm institucionesh dhe agjencish zbatuese në varësi.

Sekretariati Teknik i MB-së do të koordinojë aktivitetet monitoruese të të gjitha agjencive/ institucioneve udhëheqëse, përmes koordinimit dhe raportimit të sekretariateve të tjera, mbledhjes së raporteve tremujore, semestrale dhe vjetore, me qëllim përafrimin, identifikimin e mangësive të të dhënave dhe analizimin e tendencave të migracionit. Sekretariati do të hartojë dhe prezantojë një plan për dorëzimin e raporteve dhe do të ofrojë asistencë teknike për pikat e kontaktit në çdo institucion, duke shpjeguar metodologjinë.

Strategjia e mëparshme Kombëtare e Migracionit ngriti një mekanizëm të dyfishtë monitorimi, të përbërë nga: Komiteti Teknik i Migracionit (KTM), i krijuar me urdhrin e kryeministrit nr. 99, datë 27.7.2020 dhe Grupi Drejtues i Migracionit (GDM), i krijuar me urdhrin e kryeministrit nr. 35, datë 10.3.2021. Strategjia e re Kombëtare për Migracionin, do të vazhdojë të ruaj këtë sistem të dyfishtë monitorimi.

Gjatë identifikimit të masave dhe përgatitjes së planit të veprimit, ka pasur një bashkërendim të mirë të nismave të partnerëve që mbështesin qeverinë dhe fushat përkatëse, përfshirë donatorët dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, që kanë shprehur vullnetin e tyre për të kontribuar në zbatimin e strategjisë. Ky koordinim do të vazhdojë edhe gjatë zbatimit dhe rishikimit të strategjisë. Për këtë qëllim, Mekanizmi Koordinues dhe Monitorues do të zhvillojë takime me partnerë, organizata ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë përkatës në fushën e migracionit, të paktën një herë në vit.

Institucionet që do të luajnë një rol udhëheqës ose mbështetës në realizimin e objektivave/masave /ndërhyrjeve prioritare të përcaktuara në Planin e Veprimit përfshijnë, si më poshtë:

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKPFA	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
AP	Avokati i Popullit
BSH	Banka e Shqipërisë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
DKM	Departamenti i Kufirit dhe Migracionit
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DVKM	Drejtoritë Vendore të Kufirit dhe Migracionit
DVP	Drejtoritë Vendore të Policisë
EUAA	Agjencia Evropiane për Azilin
GPN	Grupi i Punës Ndërinstitucional
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
ISHPSHS	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MD	Ministria e Drejtësisë
MDK	Misionet Diplomatike dhe Konsullore
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MF	Ministria e Financave
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHÇV	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
MB	Ministria e Brendshme
OJF	Organizata Jofitimprurëse NPO
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QPA	Qendrës së Pritjes për Azil
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
ZVMD	Zyrat Vendore për Migracionin dhe Diasporën

Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizimit të informacionit, në lidhje me zbatimin e veprimeve dhe masave prioritare. Monitorimi gjurmon rregullisht veprimet, ndërhyrjet, burimet financiare të alokuara dhe të shpenzuara, dhe i kontrollon ato në raport me planin e veprimit për të vlerësuar shkallën në të cilën po zbatohet strategjia.

Monitorimi i performancës, nga ana tjetër, shikon rezultatet e arritura në nivele të ndryshme:

i. masat prioritare;

ii. objektivat specifikë;

iii. qëllimet afatgjata të cilat përcaktohen si qëllime politikash dhe objektiva specifikë.

Monitorimi do të mbështetet në informacionin e mbledhur rregullisht përmes sistemit të monitorimit (IPSIS). Sidoqoftë, monitorimi i zbatimit të veprimeve dhe ndërhyrjeve nën masat prioritare, dhe monitorimi i burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të bëhet në bazë të një plani vjetor të punës të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë, si dhe në përputhje me planin e veprimit të strategjisë. Nga ana tjetër, monitorimi i performancës ose monitorimi i daljes do të bazohet në kornizën e monitorimit dhe vlerësimit që është zhvilluar për këtë qëllim (shtojca 2), e cila përshkruan treguesit e performancës për masat prioritare, objektivat specifikë dhe qëllimet kryesore të politikës, dhe përcakton përgjegjësinë e mbledhjes së të dhënave.

Për sa i përket rishikimit ose vlerësimit të strategjisë, do të kryhen dy ushtrime vlerësimi. Njëra do të bëhet me përfundimin e fazës së parë të zbatimit (2024–2027) dhe tjetra në përfundim të strategjisë, gjatë vitit 2030, Mekanizmi Ndërinstitucional i Koordinimit dhe Monitorimit (KTM dhe GDM) do të jetë përgjegjës për koordinimin e vlerësimit afatmesëm dhe atij përfundimtar.

Ushtrimi i parë i vlerësimit do të shikojë zbatimin e masave prioritare dhe rezultatet e arritura. Duke krahasuar rezultatet me situatën bazë, vlerësimi i ndërmjetëm do të nxjerrë në pah ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm dhe do të shqyrtojë nëse objektivat, masat prioritare dhe ndërhyrjet mbeten të rëndësishme përpara fillimit të fazës së dytë të strategjisë.

Ky vlerësim do të shqyrtojë, gjithashtu, nëse ka ende konsistencë të plotë midis objektivave të strategjisë dhe prioriteteve, dhe politikave kombëtare. Vlerësimi do të marrë në konsideratë tendencat e migracionit, do të mbështesë informacionin e minuar nga sistemi i monitorimit dhe nga konteksti i përgjithshëm, dhe do të sigurojë udhëzime për rishikimin e planit të veprimit të strategjisë, por edhe për zhvillimin e planeve më të hollësishme vjetore operacionale për mandatin e ardhshëm që do të mbulojë periudhën midis 2028-s dhe 2030-s.

Vlerësimi përfundimtar, që do të kryhet ndërmjet viteve 2030 dhe 2031, do të shikojë progresin e përgjithshëm të strategjisë. Ai do të raportojë mbi efektivitetin (d.m.th. shkallën në të cilën janë arritur rezultatet e pritura), rëndësinë (d.m.th. masën në të cilën objektivat e politikës së punësimit përputheshin me nevojat dhe prioritetet kombëtare), efikasitetin (d.m.th. nëse objektivat u arritën me koston më të ulët të mundshme) dhe qëndrueshmërinë (d.m.th. shkalla në të cilën rezultatet, duke përfshirë ndryshimet institucionale, janë të qëndrueshme me kalimin e kohës) të masave prioritare të strategjisë.

PJESA IV – PLANI I VEPRIMIT DHE ZBATIMI I BURIMEVE FINANCIARE

Pjesa më poshtë është sqarim në lidhje me pjesën narrative të këtij nënseksioni.

Në këtë seksion bëhet një shpjegim narrativ përmbledhës, grafik dhe tabelor, në lidhje me:

- buxhetimin e gjithsej për 3 vitet e para të PBA-së. Për vitet e PBA-së aktuale, mbulimi me financim i strategjisë duhet të jetë 100% (pa hendek financiar), duke specifikuar:

- përqindjen që mbulohet me financim nga PBA-ja, si edhe sa përqindjen që mbulohet nga donatorët, në tri vitet e para;

- tabelën përmbledhëse të buxhetit, të parashikuar sipas qëllimeve të politikave/ programeve të buxhetit për 3 vitet e PBA-së aktuale;

- analiza për koston/buxhetin e nevojshëm gjithsej për zbatimin e strategjisë, duke pasqyruar:

- buxhetimin gjithsej të strategjisë (në shifra dhe %), dhe të specifikuar sipas: i. buxhetimit sipas viteve gjatë të cilave shtrihet strategjia; ii. buxhetimin sipas qëllimit të politikave; iv. sipas burimeve të financimit (buxheti apo financim i huaj); v. buxhet për shpenzime korrente (601; 602) kundrejt buxhetit për investime (231);

- opsionet e mundshëm të buxhetimit, duke modeluar:

- opsionin 0 - me tavanet aktuale të buxhetit dhe angazhimet aktuale efektive të donatorëve;

- opsionet 2 dhe 3 - me rritje minimale dhe rritje maksimale të tavaneve të buxhetit (duke marrë si variabla rritjen ekonomike mesatare të parashikuar në Programin e Reformave Ekonomike (*Economic Reform Program)* më të fundit).

SHTOJCA 1: FORMATI I PËRMBLEDHUR I PLANIT TË VEPRIMIT

Formati 1 i Planit të Veprimit – si shtojcë

SHTOJCA 2: FORMATI I KOSTUAR DHE I DETAJUAR I PLANIT TË VEPRIMIT

Formatet e lidhura me kostimin (instrumentet e kostimit)

SHTOJCA 3: FORMATET E PASAPORTAVE TË INDIKATORËVE

Treguesit e performancës mund të përcaktohen në të gjitha nivelet, si më poshtë vijon:

- Qëllimit të politikës (ndikimi/rezultati);
- Objektivit specifik (rezultatit);
- Rezultatit/produktit;
- Masës prioritare.

Indikatorët mund të jenë nivel i agreguar, i kompozuar nga një ose më shumë indikatorë të thjeshtë; indikatorë në nivel produkti për projektet e investimeve (të programuar në buxhetet vjetore dhe afatmesme të institucioneve).

SHTOJCA 4: FORMATET E MASAVE PRIORITARE

Formatet e lidhura me fishat e masave prioritare (projektet kombëtare dhe/ose programet kombëtare strategjike)

Plotësohen vetëm nëse strategjia parashikon projekte/ programe strategjike kombëtare, të cilat janë në fazën e projektidesë (apo të studimit paraprak të fizibilitetit të projektit, apo studimeve të tjera), me një portofol mbi 100 mln lekë investime, si edhe afat mbi 5 vjet cikël përgatitjeje dhe zbatimi.

Fishat e masave prioritare lidhen me përgatitjen e paketës sektoriale të projekteve/programeve strategjike (National Single Project Pipeline). Nëse sektori nuk ka investime të tilla, kjo pjesë nuk plotësohet.

PLANI I VEPRIMIT NË ZBATIM TË DOKUMENTIT STRATEGJIK TË MIGRACIONIT 2024–2030

II. Qëllimi i politikës 1: Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri

II. Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16), 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (15), 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (14), 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (10), 01330 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike (87), 09230 Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm), 09240 Arsimi i Mesëm (profesional), 10550 Tregu i Punës, 01140 *e-Qeverisja* (87), 01320 Veprimtaria Statistikore (50), 03140 Policia e Shtetit, 01330 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike (89)

Nr.	Titulli	Programi buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i Zbatimit		Kostot treguese/2024			Kostot treguese/2025			Kostot treguese/2026			Kostot treguese totale			Burimi i financimit							Burimi i financimit			Hendeku financiar
																			PBA 2024–2026 (në lekë)			Financim i huaj (në lekë)/ose jashtë buxhetit				Buxheti 2027–2030 (në lekë)			
		Emri i BP/dhe kodi	Institucioni përgjegjës	Institucionet kontribuuese	Afati i fillimit	Afati i realizimit	Korrente	Kapitale	Kostoja totale	Korrente	Kapitale	Total kosto	Korrente	Kapitale	Total kosto	Korrente	Kapitale	Total kosto	Korrente	Kapitale	Totali BSH	Korrente	Kapitale	Emri i donatorit/titulli i projektit	Total financim i huaj	Korrente	Kapitale	Totali BSH	
1.1	**Objektivi specifik 1.1: Menaxhimi i migracionit nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional**																												
	Masat																												
1.1.1	**1.1.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe ndërkombëtar për qeverisjen e migracionit**	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16), 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (15)	MB, MEPJ	MB, MEPJ, MEKI, MSHMS, MD, DNJF, Inspektorati i Punës, AKPA, DKM, ministritë e linjës	2024	2026	18,593,804	0	18,593,804	17,502,251	0	17,502,251	17,574,251	0	17,574,251	53,670,306	0	53,670,306	45,180,306	0	45,180,306	0	0		0	0	0	0	(8,490,000)
1.1.1.1	1.1.1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor të migracionit dhe përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve të përfshira, në nivel qendror dhe vendor	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16)	MB	MEPJ, MEKI, MSHMS	2024	2026	3,636,512	0	3,636,512	3,636,512	0	3,636,512	3,636,512	0	3,636,512	10,909,536	0	10,909,536	10,909,536	0	10,909,536	0	0		0	0	0	0	-
1.1.1.2	1.1.1.2 Propozime për ndërhyrje ligjore në ligjin "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi", ligjin "Për të huajt" dhe ligjin "Për shtetësinë", ligjin "Për azilin në RSH"	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16)	MB	MEPJ, MEKI, MSHMS	2024	2026	9,445,528	0	9,445,528	9,445,528	0	9,445,528	9,517,528	0	9,517,528	28,408,584	0	28,408,584	23,818,584	0	23,818,584	0	0		0	0	0	0	(4,590,000)
1.1.1.3	1.1.1.3 Vlerësimi i nevojave për ndryshime ligjore në ligjin nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", për përfshirjen në target grupin e personave që përfitojnë ndihmë ligjore falas dhe migrantët e parregullt	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16)	MB	MD, DNJF	2024	2026	1,289,441	0	1,289,441	1,289,441	0	1,289,441	1,289,441	0	1,289,441	3,868,323	0	3,868,323	2,968,323	0	2,968,323	0	0		0	0	0	0	(900,000)
1.1.1.4	1.1.1.4 Vlerësimi i statusit të ratifikimit, monitorimit dhe raportimit të nivelit të zbatimit të konventave të ratifikuara që kanë lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me garantimin e të drejtave të migrantëve	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (15)	MEPJ	Të gjitha ministritë e linjës	2024	2026	1,349,776	0	1,349,776	1,349,776	0	1,349,776	1,349,776	0	1,349,776	4,049,328	0	4,049,328	1,349,328	0	1,349,328	0	0		0	0	0	0	(2,700,000)
1.1.1.5	1.1.1.5 Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi të përbashkët për të rregulluar ndërveprimin institucional për monitorimin e periodik për hyrjen, qëndrimin dhe punësimin e të huajve	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16)	MB	Inspektorati i Punës, AKPA, DKM dhe MEPJ.	2024	2024	1,091,553	0	1,091,553	0	0	0	0	0	0	1,091,553	0	1,091,553	791,553	0	791,553	0	0		0	0	0	0	(300,000)
1.1.1.6	1.1.1.6 Përafrimi i politikës së vizave me BE-në, veçanërisht me vendet që paraqesin rrezik migrimi ose sigurie	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (15)	MEPJ	MB	2024	2026	1,780,994	0	1,780,994	1,780,994	0	1,780,994	1,780,994	0	1,780,994	5,342,982	0	5,342,982	5,342,982	0	5,342,982	0	0		0	0	0	0	-
1.1.2	**1.1.2. Rritja e kapaciteteve institucionale dhe rishikimi i strukturave në institucionet në nivel qendror dhe vendor për qeverisjen efektive të migracionit**	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16), 01330 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike (87),	MB, ASPA, Bashkitë	MEPJ, MEKI, MB, MSHMS, MAS, ASPA, DKM, AKPA, AMVV, të gjitha institucionet e përfshira në SKM, Shkolla e Magjistraturës, IOM, UNHCR, EUAA, OJF, NJVV/ZVMD, MSHÇV, GIZ	2024	2026	28,502,712	0	28,502,712	28,617,436	0	28,617,436	29,685,714	0	29,685,714	86,805,862	0	86,805,862	25,108,843	0	25,108,843	55,393,419	0		55,393,419	0	0	0	(6,303,600)
1.1.2.1	1.1.2.1 Vlerësim i nevojave për rritjen e kapaciteteve institucionale për qeverisjen e efektshme të migracionit	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16)	MB	MEPJ, MEKI, të gjitha institucionet e përfshira në SKM	2024	2024	1,277,553	0	1,277,553	0	0	0	0	0	0	1,277,553	0	1,277,553	827,553	0	827,553	0	0		0	0	0	0	(450,000)
1.1.2.2	1.1.2.2 Hartimi/përditësimi i kurrikulave për trajnime mbi forcimin e kapaciteteve mbi çështjet e migracionit	01330 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike (87)	ASPA	MB, MEPJ, MEKI, MSHMS, MAS, GIZ	2024	2025	324,000	0	324,000	324,000	0	324,000	0	0	0	648,000	0	648,000	0	0	0	648,000	0	GIZ	648,000	0	0	0	-
1.1.2.3	1.1.2.3 Ngritja dhe funksionimi i njësisë/strukturës së trajnimeve për Migracionin	01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (16)	MB	DKM, MEPJ, MEKI, MSHMS, MAS, AKPA	2024	2026	2,004,264	0	2,004,264	2,004,264	0	2,004,264	2,004,264	0	2,004,264	6,012,792	0	6,012,792	6,012,792	0	6,012,792	0	0		0	0	0	0	-
	4.1.2 Rritja e kapaciteteve të stafit përgjegjës për procedurat e azilit	Numri i trajnimeve, *worshop*-eve, vizitave studimore	Stafi ka marrë pjesë, në trajnimet e EUAA-së (3), ASPA (1). Është bërë një vizitë e shkurtër studimore në Kosovë.	Rritës 10% Rritja e trajnimeve brenda vendit dhe në rajon. Gjithashtu dhe e vizitave studimore.	Rritës 15%	Certifikimi dhe të dhënat e Drejtorisë së Politikave për Azilin të Huajt dhe Shtetësisë sepse jo të gjitha trajnimet certifikohen.	Action Plan For Sustainable Migration Governance In The Western Balkans GCR 17.18 SDG EC.VI.A2; EC.VI.B2
	4.2.1 Identifikimi i shpejtë i personave me nevoja të veçanta gjatë procedurave të përzgjedhjes	Numri i personave me nevoja të veçanta të identifikuar dhe të asistuar	Një person i akomoduar me nevoja të veçanta gjatë vitit 2023, i cili është identifikuar dhe asistuar	Rritja e cilësisë së shërbimit të ofruar, në identifikim dhe asistim të rasteve me nevoja të veçanta	Rritja e cilësisë së shërbimit të ofruar, në identifikim dhe asistim të rasteve me nevoja të veçanta	Statistika e QPA-së	Action Plan For Sustainable Migration Governance In The Western Balkans Gcr 17.18 SDG EC.VI.A2; EC.VI.B2
	4.2.2 Infrastrukturë dhe burime njerëzore në qendrat pritëse dhe tranzitore për të siguruar plotësimin e nevojave të grupeve vulnerabël	Rritja e numrit të shërbimeve Rritja e numrit të stafit përgjegjës për asistimin e grupeve vulnerabël	Pjesë e ofrimit të shërbimeve direkte është bërë 1 punonjës (kujdestari i natës/kontratë e përkohshme pune) për vitin 2023	Rritës në ofrimin e shërbimeve	Rritës në ofrimin e shërbimeve	Statistika e QPA-së	Action Plan For Sustainable Migration Governance In The Western Balkans Gcr 17.18 SDG EC.VI.A2; EC.VI.B2
	4.2.3 Mbrojtje e veçantë për fëmijët e huaj të pashoqëruar	Numri i fëmijëve të pashoqëruar të asistuar	Nga 2019–2022 janë konstatuar 143 të mitur të huaj të pashoqëruar në vitin 2023 janë konstatuar 38 të mitur të huaj të pashoqëruar	Rritës në ofrimin e asistencës për shqyrtimin e kërkesës (nuk mund të përcaktojmë %)	Rritës në ofrimin e asistencës për shqyrtimin e kërkesës (nuk mund të përcaktojmë %)	ASHMDF Statistikat e Drejtorisë së Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësisë - MB Statistikat e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin - DPPSH	Action Plan For Sustainable Migration Governance In The Western Balkans Gcr 17.18 SDG EC.VI.A2; EC.VI.B2
	4.3.1 Programe me qëllim integrimin social-ekonomik të azilkërkuesve, refugjatëve	Numri i azilkërkuesve dhe refugjatëve që kanë përfituar nga programet integruese	70% e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare kanë përfituar nga shërbimet integruese. Pjesa tjetër kanë qëndruar për një kohë të shkurtër në Qendrën e Pritjes për Azil për vitin 2023	Rritës i integrimit të kërkuesve	Rritës i integrimit të kërkuesve	Statistika e QPA-së	Action Plan For Sustainable Migration Governance In The Western Balkans Gcr 17.18 SDG EC.VI.A2; EC.VI.B2
	4.3.2 Ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për personat me mbrojtje ndërkombëtare	Numri i azilkërkuesve dhe refugjatëve që përfitojnë periodikisht shërbimet publike, sociale, shëndetësore	15 persona me status të mbrojtjes ndërkombëtare janë pajisur me letërnjoftim elektronik. 3 janë pajisur me travel dokument. 10 janë pajisur me leje qëndrimi.	Rritës 10%	Rritës 15%	Të dhënat e Drejtorisë së Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë - MB	Action Plan For Sustainable Migration Governance In The Western Balkans Gcr 17.18 SDG EC.VI.A2; EC.VI.B2

VENDIM
Nr. 277, datë 8.5.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, përmasat e pronës 190 zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin e përditësimit dhe plan-rilevimin, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

1.FORMULARI I PËRDITËSIMIT T TË PRONËS NR. 190 "BAZA AJRORE (ish Regjimenti 4020)" FARKE, TIRANE

Bashkia Tiranë

Identifikoi pronën :
Major Sokol **Hasimllari** Shef Logjistike 3006
N/Kolonel Miri **Jera** Specialist Infrastrukture
Major Olgert **Koroveshi** Shefi I Zbulimit
Civil Sadik **Ismaili** Keshilltar Ligjor

Supervizoi:
N/kolonel Pellumb **Sevdari** Shefi i Logjistikes
Major Sajmir **Germenji** Shefi i Zyres Komandantit
N/Kolonel Shpetim **Gjepali** Shefi Operacioneve
Major Selvie **Iljazi** Shef i Finances

Aprovoi:
Komandanti i Repartit Ushtarak Nr. 3001
Gjeneral Brigade Ferdinant **DIMO**

Nr	Zona Kadastrale & Indeksi I Hartes	Nr. I Pasurisë	Lloji I Pasurisë	Emertesa e Pasurisë , Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip		Funksioni për të cilin përdoret prona /pronari	Institucioni me përgjegjesi administrative /	Institucioni perdorues I pasurisë , statusi juridik I perdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera (Shënime të Veçanta
						Truall (m2)	Ndërtesa (M2)					
190	ZK 1604, ZK 3051, ZK 3550 K-34-100-(13-C-D)			Baza Ajrore (Ish regjimenti 4040)				Per mbrojtjes	MM/Komanda e Forces Ajrore	Komanda e Forces Ajrore/Baza Ajrore Farke	VKM nr. 737, date 16.02.2012	

Nr	Zona Kadastrale & Indeksi I Hartes	Nr. I Pasuris ë	Lloji I Pasuris ë	Emertesa e Pasurisë , Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip		Funksioni për të cilin përdoret prona /pronari	Institucioni me përgjegjesi administrative / pronësi	Institucioni perdorues I pasurisë , statusi juridik I perdorimit	Inventarizua r me VKM	Të dhëna të tjera (Shënime të Veçanta
						Truall (m2)	Ndërtesa (M2)					
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	939/2	Truall	Objekti Nr. 1 me emertim "Zyra shtabi & Depo" Kati perdhe, "Depo & zyra Shtabi" kati i I dhe "Shtese Godine" pjesa anësore Shtabi)	141696	141696	1007.74					
				Objekti Nr. 2 me emërtim "Shtabi"			746.05					
				Objekti Nr. 3 me emërtim "Guzhina e Oficerëve"			321.19					
				Objekti Nr. 4 me emërtim "Fjetinë + Farmaci"			122.87					
				Objekti Nr. 5 me emërtim "Palestra"			651.26					
				Objekti Nr. 6 me emërtim "Infermeri"			133.47					
				Objekti Nr. 7 me emërtim "Depo armatimi"			192					
				Objekti Nr. 8 me emërtim "Repart mekanik"			152					
				Objekti Nr. 9 me emërtim "Depo teknikes Ajrore"			536.58					
				Objekti Nr. 10 me emërtim "Oficina e qendres se mirembajtjes"			598.82					

Nr	Zona Kadastrale & Indeksi I Hartes	Nr. I Pasurisë	Lloji I Pasurisë	Emertesa e Pasurisë , Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip		Funksioni për të cilin përdoret prona /pronari	Institucioni me përgjegjesi administrative / pronësi	Institucioni perdorues I pasurisë, statusi juridik I perdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera (Shënime të Veçanta
						Truall (m2)	Ndërtesa (M2)					
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	939/2	Truall	Objekti Nr. 11 me emërtim "Oficina e tranportit"			206.14					
				Objekti Nr. 12 me emërtim "MNZ"			300.27					
				Objekti Nr. 13 me emërtim "Parku i makinave"			970.24					
				Objekti Nr. 16 me emërtim "Truproje +Depo"			238.7					
				Objekti Nr. 17 me emërtim "Hangar Strehimi Cougar"			1472					
				Objekti Nr. 18 me emërtim "Hangar Strehimi Cougar"			1472					
				Objekti Nr. 19 me emërtim "Hangar mirembajte"			1163					
				Objekti Nr. 20 me emërtim "Pike karburanti"			22.68					
				Objekti Nr. 21 me emërtim "Postblloku"			22.5					
				Objekti Nr. 22 me emërtim "Depo uji"			15.63					
				Objekti Nr. 23me emërtim "Depo uji"			15.72					
				Objekti Nr. 24 me emërtim "Depo"			107.93					
				Objekti Nr. 25 me emërtim "Kabine elktrike"			42					

Nr	Zona Kadastrale & Indeksi I Hartes	Nr. I Pasuris ë	Lloji I Pasuris ë	Emertesa e Pasurisë , Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip		Funksioni për të cilin përdoret prona /pronari	Institucioni me përgjegjesi administrative / pronësi	Institucioni perdorues I pasurisë , statusi juridik I perdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera (Shënime të Veçanta
						Truall (m2)	Ndërtesa (M2)					
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	939/2	Truall	Objekti Nr. 26 me emërtim "Depo"			67.2					
				Objekti Nr. 27 me emërtim "Menze Kuzhine"			235.85					
				Tunele te pabetonuara			cope 2					
				Tunele te betonuar			Cope 1					
	ZK 3550 K-34-100-(13-C-D)	207/8	Truall	Objekti Nr. 14 me emërtim "Hangar i ri"	149700	149700	630					
				Objekti Nr. 15 me emërtim "Hangari VIP"			656					
				Tunel I pabetonuar			Cope 3					
	ZK 3051 K-34-100-(13-C-D)	67/1	Truall	Tunel I pabetonuar	79461	79461	Cope 1					
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	939/3	Are		4567	4567						
	ZK 3550, K-34-100-(13-C-D)	207/35	Pyll		17755	17755						
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	68/9	Are		2700	2700						
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	365/1	Perrua		3108	3108						
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	58/15	Are		1300	1300						

Nr	Zona Kadastrale & Indeksi I Hartes	Nr. I Pasurisë	Llloji I Pasurisë	Emertesa e Pasurisë , Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip		Funksioni për të cilin përdoret prona /pronari	Institucioni me përgjegjesi administrative / pronësi	Institucioni perdorues I pasurisë, statusi juridik I perdorimit	Inventarizua r me VKM	Të dhëna të tjera (Shënime të Veçanta
						Truall (m2)	Ndërtesa (M2)					
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	68/15	Are		297	297						
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	68/16	Rruge		194	194						
	ZK 1604, K-34-100-(13-C-D)	68/17	Are		213	213						
	Totali				400,991	400,991	12099.84					


PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
FARKE E MADHE
1604
PRISKE E MADHE
3051
SURREL
3550
K – 34 – 100 – (13–C)
K – 34 – 100 – (13–D)

VENDIM
Nr. 278, datë 8.5.2024

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT), QË, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, SI AUTORITET SHITËS, TË KRYEJË PROCEDURAT E ANKANDIT PUBLIK TË ARTIKUJVE TË NDRYSHËM PËR SKRAP

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, "Për ankandin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit), që, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, si autoritet shitës, të kryejë procedurat e ankandit publik të artikujve të ndryshëm për skrap, deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.

2. Kryeministria t'i dorëzojë Ministrisë së Mbrojtjes të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e procedurës së ankandit publik, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohet struktura përgjegjëse në Kryeministri për mbikëqyrjen e kryerjes së procedurës së ankandit publik, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 280, datë 8.5.2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi institucionit të Presidentit të Republikës për ushtrimin e veprimtarisë administrative.

Lista përbëhet nga 1 (një) fletë formulari dhe 1 (një) plan-rilevim dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen institucioni i Presidentit të Republikës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucion i Pushtetit Qëndror: Intitucioni i Presidentit të Republikës Identifikoi **Bilbil Nurçe, Inxhinier**

Bashkia: Tiranë Supervizo **Enri Mato, Specialist**

Fusha e përdorimit të Pronës: Administratë Aprovoi: **Fuat Zhabjaku, Drejtor**

	A		B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Emërtesa e Pronës Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet përbërës të Pronës	Adresa/Vend ndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në m^2 ose ml	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			**Institucioni i Presidentit të Republikës**							
	ZK.8270	4/101		Truall	Blv. "Dëshmorët e Kombit"	**11552**	Administratë	Institucioni i Presidentit të Republikës	Institucioni i Presidentit të Republikës	
	TR-S-11,12	4/101		Ndërtesa e Institucioni i Presidentit të Republikës (S1)	Blv. "Dëshmorët e Kombit"	**1769.3**	Administratë	Institucioni i Presidentit të Republikës	Institucioni i Presidentit të Republikës	Ndërtesa është 2 dhe 3 kate me një kat -1 (Konfidenciale)
		4/101		Ndërtesa e Kapanoneve (S2)	Blv. "Dëshmorët e Kombit"	**527.7**	Administratë	Institucioni i Presidentit të Republikës	Institucioni i Presidentit të Republikës	Ndërtesa është 1 kat

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Valbona Lusha

PLAN-RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET DATË 04/03/2024 QËLLIMI INVENTARIZIM/REGJISTRIM

VENDNDODHJA
BASHKIA: Tiranë DVASHK/ZVASHK: TIRANA - VERI ZONA KADASTRALE: 8270 NUMRI I PASURISË: 4/101 INDEX HARTE: TR; S-11, S-12

TË DHËNAT E PASURISË
LLOJI PASURISË: TRUALL SIP.PASURISË: 11529 m² SIP. GJURMËS NDËRTIMI: 1609 m² NUMRI KATEVE: (1K, 2K, 3K) NUMRI PEMËVE _____

484780.661
4576094.179

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

485046.405
4576094.179



484780.661
4575895.156

SH.1:1000

485046.405
4575895.156

ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
VERI			PAS. 4/94		
LINDJE			PAS. 4/455, 4/456, 4/102		
PERËNDIM			PAS. 4/104		
JUG			PAS. 4/100, 4/160, 4/98		

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT
EMRI: BILBIL NURÇE
LIÇENSA: T.0220/5 DATË 12.10.2020
KOMPANIA: Digitally signed by Bilbil Nurce Date: 2024.03.04 17:38:45 +02'00'
NIPT:
NËNSHKRIMI/VULA:
REALIZOI PËR ASHK:
SPECIALISTI:
DVASHK:
NËNSHKRIMI:
KONFIRMOI:
PËRGJEGJËSI/DREJTORI:
NËNSHKRIMI/VULA:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z, G, S, O.
Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash.

PËRCAKTIMI KUFIRIT: HK
Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale.

SHËNIME TË VEÇANTA:

KY PLAN RILEVIMI U HARTUA MBI KËRKESËN E INSTITUCIONIT "PRESIDENCA E REPUBLIKËS"

PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT

EMRI: SHTET
NËNSHKRIMI _____

SHPJEGUES

PËR NDARJE PASURIE:
Parcela:____m² vijon Parcela1=_____m²
Parcela2=_____m²
Parcela3=_____m²

PËR BASHKIM PASURIE:
Parcela1=_____m²
Parcela2=_____m² vijon Parcela:____m²
Parcela3=_____m²

KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE:
SIPËRFAQE TRUALLIT S=11552m²
SIPËRFAQE GJURMËS SË NDËRTIMIT S1=1769.0m² S2=520.7m²

Plan-Rilevimi u hartua sipas V.K.M-së Nr. 28, Datë 27.01.2023 *"Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve".*

VENDIM
Nr. 281, datë 8.5.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën "b", të pikës 1, të kreut I, dhe në pikën 25, të lidhjes nr. 3, fjalët "...Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike..." dhe "...Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike..." zëvendësohen përkatësisht me "...Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike..." dhe "...Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike...".

b) Në shkronjën "ç", të pikës 1, të kreut I, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. emërtesa "Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve" zëvendësohet me "Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve";

ii. emërtesa "Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar" zëvendësohet me "Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar";

iii. pas emërtesës "Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura" shtohet "Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve".

c) Në pikën 1, të kreut IV, fjalët "... Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve..." zëvendësohen me "...Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve...".

ç) Lidhja nr. 9/6 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Në lidhjen nr. 12, pas emërtesës "Përgjegjës të degëve të tjera vendore të thesarit" shtohet emërtesa "Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi:

a) për përcaktimet e shkronjave "a", "b" "c" dhe "d", të pikës 1, të këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit/transferimit të nëpunësve në detyrë dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit;

b) për përcaktimin e shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij vendimi, fillojnë nga data 1 korrik 2024 dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave të përcaktuara në ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 9/6

KLASAT E PAGAVE DHE SHTESAT PËR KUSHTE PUNE (NATYRË TË VEÇANTË PUNE) PËR POZICIONET E PUNËS SË NËPUNËSVE NË AGJENCINË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË CANNABIS-IT

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lekë/muaj)
Titullar i institucionit.	I-3	1	120 000
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes. Koordinator në varësi të drejtpërdrejtë të titullarit.	II-1	1	110 000
Koordinator me funksione drejtuese në njësitë organizative të përmbajtjes.	II-1	1	100 000
Koordinator në njësitë organizative të përmbajtjes.	II-1	1	90 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1	0
Përgjegjës i sektorëve mbështetës.	III-2	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes.	IV-1	1 ose 2	90 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		0

VENDIM
Nr. 282, datë 8.5.2024

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AUTORITETIT PORTUAL DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, "Për Autoritetin Portual", me propozimin e zëvendës-kryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Autoriteti Portual Durrës organizohet dhe funksionon sipas këtij statuti.
3. Vendimi nr. 596, datë 10.9.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij", shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Portual Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STATUTI I AUTORITETIT PORTUAL DURRËS

Neni 1
Emërtimi dhe selia

Autoriteti Portual Durrës është person juridik, i cili organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, "Për Autoritetin Portual", të këtij statuti dhe të legjislacionit në fuqi. Selia e Autoritetit Portual Durrës është në qytetin e Durrësit.

Neni 2
Objekti i statutit

Objekt i këtij statuti është përcaktimi i formës së organizimit, i rregullave të funksionimit dhe të administrimit, i marrëdhënieve me operatorët, me organet shtetërore dhe të përfaqësimit të Autoritetit Portual Durrës.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë statut termat kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9130, datë 8.9.2003, "Për Autoritetin Portual", ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr.

168/2013, datë 30.10.2013, "Për sigurinë në anije dhe në porte", dhe në akte të tjera që normojnë veprimtarinë e portit në tërësinë e elementeve të infrastrukturës së portit për realizimin e shërbimeve dhe të veprimtarisë portuale të transportit detar të mallrave dhe pasagjerëve.

Neni 4

Qëllimi i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës

1. Autoriteti Portual Durrës është organi përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e infrastrukturës portuale në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano, sipas modelit të administrimit të integruar të disa porteve nën një autoritet të vetëm portual.

2. Qëllimi i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës është:

a) të realizojë drejtimin administrativ të veprimtarisë në fushat e detarisë dhe të zonës detare përkatëse, si dhe të bashkërendojë marrëdhëniet me organet shtetërore;

b) të drejtojë dhe të kontrollojë ofrimin e shërbimeve portuale në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano dhe në portet e tjera tregtare ose turistike nën administrimin e tij;

c) të bëjë të frytshëm dhe më të orientuar në drejtim të ekonomisë së tregut autoritetin portual, të rrisë konkurrencën, të zhvillohet ekonomikisht përmes investimeve të drejtpërdrejta nga sektori privat për zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe modernizimin e porteve;

ç) të shndërrojë portet që ka nën administrim dhe mbikëqyrje, nga "porte shërbimi" në "porte administruese toke" për të rritur pavarësinë e tyre tregtare;

d) të sigurojë zgjerimin, modernizimin dhe rehabilitimin e infrastrukturave portuale;

dh) të përafrojë shërbimet portuale me praktikat ndërkombëtare dhe standardet evropiane të fushës;

e) të sigurojë nivel shërbimesh të shkallës së lartë, në funksion të rritjes së vëllimeve tregtare dhe uljes së kohës së përpunimit të mallrave dhe pasagjerëve, me kosto të arsyeshme për transportin vendas dhe atë rajonal, veçanërisht drejt Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut;

ë) të garantojë një nivel të lartë sigurie dhe mbrojtje të mjedisit;

f) të mundësojë marrjen e masave për tranzicionin ekologjik të porteve nën administrimin e tij, në përputhje me praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare për transportin detar të gjelbër;

g) të sigurojë një shkallë të lartë autonomie për administrimin dhe zhvillimin e porteve, si dhe për operatorë të ndryshëm, që kryejnë shërbimet në to;

gj) të sigurojë qiradhënie ose koncesion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontratat e qirasë dhe të legjislacionit në fuqi për koncesionet për disa pajisje të caktuara për veprimtarinë e portit;

h) të bashkërendojë veprimtarinë detare dhe sistemin e transportit, sipas legjislacionit në fuqi;

i) të bashkërendojë veprimtarinë e organeve shtetërore, subjekteve publike dhe private, që kryejnë veprimtarinë në një port nën administrimin e tij, të cilët nga ana e tyre kanë detyrimin për të respektuar të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi për organizimin dhe funksionimin e portit, duke përfshirë këtu edhe planin e administrimit të tokës dhe planin e sigurisë së portit dhe faciliteteve portuale;

j) të bashkojë pikat e forta dhe funksionet e specializuara të faciliteteve portuale nën administrimin dhe kompetencën e tij;

k) të krijojë një sistem unik portual nëpërmjet bashkëpunimit, koordinimit, me qëllim përgjigjen e shpejtë dhe fleksible ndaj nevojave të përdoruesve dhe ndjekjen e objektivave të përbashkët, për sa i takon performancës dhe mjedisit konkurrues rajonal;

l) të ndihmojë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Infrastrukturave Pritëse e Shpërndarëse Portuale, me qëllim integrimin në nyjat kyçe të Bashkimit Evropian dhe Evropës Juglindore, përmes Korridorit VIII dhe infrastrukturave ndërlidhëse energjetike, rrugore, hekurudhore dhe digjitale;

ll) të planifikojë burimet tokësore dhe financiare, duke promovuar intermodalitetin, me qëllim rritjen e vëllimeve të mallrave dhe pasagjerëve;

m) të mbështesë ndërtimin e terminaleve logjistike dhe zonave ekonomike tërheqëse për investimet e huaja, në funksion të rritjes së vëllimeve tregtare dhe vlerës së shtuar ekonomike në zonat portuale;

n) të mbështesë veprimtarinë e Forcës Detare (Roja Bregdetare) në ushtrimin e kompetencave dhe plotësimin e nevojave të tyre në zonat portuale përkatëse;

nj) të mbështesë Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit për koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det, me qëllim minimizimin e pasojave në ambientin detar dhe eliminimin e humbjeve në jetët njerëzore.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës

1. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës është:

a) të administrojë tërësinë e hapësirave portuale në Durrës dhe në Porto Romano, përfshirë terminalet ekzistuese nën regjim koncesionar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe ato pasuri shtetërore dhe infrastruktura portuale që mund t'i kalojnë në administrim në të ardhmen, duke bashkërenduar veprimtaritë e mëposhtme:

i. veprimtaritë portuale për transportin e mallrave, lundrimin, drejtimin e anijeve, transportin e pasagjerëve, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat;

ii. veprimtarinë e ndërtimit, zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës portuale që bëhet prej tij, enteve të tjera publike ose prej sektorit privat;

iii. veprimtari të tjera, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarive të përshkruara më sipër.

b) të adresojë, të koordinojë, të rregullojë, të promovojë edhe përmes zyrave operacionale, administrative ose territoriale, kur është rasti, shërbimet portuale të ofruara nga operatorët e autorizuar dhe nga operatorët e tjerë të portit apo porteve pjesë të Autoritetit Portual Durrës;

c) të propozojë te ministri përgjegjës për portet shqiptare shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e porteve detare në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano, si dhe në portet e tjera nën administrimin apo mbikëqyrjen e tij;

ç) të rregullojë, në koordinim me kapitenin e portit, hyrjen e mjeteve lundruese në kalatat dhe terminalet e porteve që ka në administrim dhe mbikëqyrje, si dhe të gjitha lëvizjet e mjeteve lundruese brenda tyre;

d) të hartojë dhe të realizojë strategji marketingu dhe tregtare;

dh) të propozojë shërbime dhe politika tarifore të harmonizuara;

e) të sigurojë hartimin e masterplaneve dhe projekteve të detajuara inxhinierike, në funksion të zgjerimit, modernizimit dhe rehabilitimit të infrastrukturave portuale;

ë) të këshillojë dhe të mbështesë ministrinë përgjegjëse për portet dhe institucione të tjera në lidhje me përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian, praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe implementimin e tij për sa i përket shërbimeve dhe infrastrukturës portuale;

f) të sigurojë zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të Dritares Detare Unike, në përputhje me praktikat më të mira evropiane e ndërkombëtare të fushës, duke bashkërenduar përpjekjet e agjencive shtetërore në këtë fushë;

g) të mundësojë integrimin e sistemeve dhe infrastrukturës *on-line* të përpunimit të anijeve, mallrave dhe pasagjerëve, duke promovuar inovacionin dhe automatizimin e proceseve të përpunimit në port;

gj) të mundësojë mbrojtjen kibernetike të infrastrukturave portuale kritike;

h) të monitorojë kontratat koncesionare, në të cilat APD-ja është palë apo e autorizuar, të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet, me objekt veprimtarie transportin detar, shërbimet detare, përpunimin portual të mallrave dhe hidrokarbureve dhe raportimin periodik për autoritetet kontraktore përkatëse, bazuar në autorizimin apo delegimin e autoritetit kontraktor;

i) të propozojë për miratim te ministri përgjegjës për transportin detar, përcaktimin e terminaleve dhe kategoritë e përpunimit, sipas planeve të administrimit të tokës;

j) të miratojë lejet e përdorimit të portit nëpërmjet lejes, licensës ose autorizimit për subjektet që operojnë shërbime dytësore në zonat portuale;

k) të vendosë marrëdhënie financiare tregtare me subjektet e licencuara nga ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë për të operuar në port;

l) të sigurojë përshtatshmërinë e kërkesave për licensim pranë autoritetit kompetent të subjekteve, me objekt veprimtarie përpunimin e transportit të mallrave ose pasagjerëve që transportohen në rrugë detare;

ll) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për

themelimin e shoqërive tregtare ose entiteteve të tjera për ushtrimin e veprimtarive të veçanta;

m) të nxjerrë apo të propozojë akte rregullatore në fushën e sigurisë në punë në zonat portuale, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe përcaktimet e këtij statuti;

n) të nxjerrë apo të propozojë rregulloret e nevojshme të shërbimeve portuale;

nj) mund të krijojë zyra operacionale, administrative ose territoriale pranë porteve nën juridiksionin e tij, me qëllim koordinimin, mbikëqyrjen, monitorimin e veprimtarisë portuale, në përputhje me kompetencat e Autoritetit Portual Durrës;

o) të programojë, të planifikojë, të projektojë dhe të realizojë kurse të formimit profesional për punonjësit që operojnë në hapësirat portuale, si dhe të lëshojë dëshmi të aftësive mbi bazën e këtyre programeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

p) të propozojë rregullore në fushën e aftësimit të drejtuesve të makinerive portuale;

q) të realizojë detyra të tjera, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe përcaktimet e këtij statuti.

Neni 6
Pasuria e Autoritetit Portual Durrës

1. Autoriteti Portual Durrës ushtron kompetencën e tij tokësore dhe detare në të gjitha zonat portuale dhe në infrastrukturën përkatëse, duke përfshirë, por pa u kufizuar, kanalet hyrëse, dallgëthyesit, basenet, kalatat, pontilet, vendbregëzimet, rrugët dhe hekurudhat.

2. Autoriteti Portual Durrës gëzon të drejtat e administrimit të pronave shtetërore, të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë portuale, të kaluara nën administrim të tij, si dhe të entiteteve të krijuara apo të zotëruara prej tij, me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave dhe çdo të drejtë të lidhur me to, duke respektuar strukturën e organizimit, si "port administrues toke".

3. Pasuria e Autoritetit Portual Durrës përbëhet nga pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, nën përgjegjësi administrimi të Autoritetit Portual Durrës, ku përfshihen:

a) të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme që ka nën përgjegjësi administrimi të tij apo shoqërive tregtare të krijuara ose të zotëruara prej tij;

b) të gjitha pasuritë e paluajtshme që përbëjnë terminale logjistike në tokë, porte të thata, nën administrimin e tij, si dhe çdo infrastrukturë tjetër që i kalohet në përgjegjësi administrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit.

4. Pasuria e Autoritetit Portual Durrës përbëhet edhe nga pasuritë e luajtshme të trashëguara, sipas vendimit nr. 596, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij".

5. Autoriteti portual nuk mund të shesë apo të lërë garanci asnjërën nga pronat shtetërore që administron, por mund:

a) të ofrojë lehtësi, të japë të drejta ose leje dhe autorizime për shërbimet ose të krijojë mundësi për t'i përdorur ato, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

b) të shesë pajisjet dhe të hartojë dokumentacionin e kërkuar për atë qëllim;

c) të sigurojë territoret tokësore dhe ujore për zgjerimin e porteve, për t'i ardhur në ndihmë veprimtarisë së tyre.

Neni 7
Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të Autoritetit Portual Durrës, janë:

a) Këshilli Drejtues;

b) Drejtoria Ekzekutive.

2. Organet e Autoritetit Portual Durrës ndihmohen dhe këshillohen nga Këshilli Konsultativ i Portit.

Neni 8
Përbërja dhe emërimi i këshillit drejtues

1. Përbërja e këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës është, si më poshtë vijon:

a) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për portet shqiptare;

b) një përfaqësues nga ministria përfaqësuese e pronës shtetërore;

c) një përfaqësues nga institucioni i Prefektit Durrës;

ç) një përfaqësues nga Bashkia Durrës;

d) dy përfaqësues nga sektori privat, të propozuar nga këshilli konsultativ i portit.

Këshilli konsultativ i portit mund të propozojë më shumë se 2 persona, por ministri përgjegjës për portet shqiptare emëron 2 (dy) prej kandidatëve.

2. Anëtarët e këshillit drejtues duhet të kenë një përvojë pune në transport mbi pesë vjet, të kenë njohuri e përvojë të gjerë për menaxhimin e biznesit në operacionet e portit ose në marinën tregtare, si dhe

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të jetë i diplomuar në ciklin e dytë të studimeve universitare apo i përzgjedhur si personalitet i njohur në fushën e tij profesionale;

c) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, për të cilën nuk është rehabilituar apo kundërvajtje administrative për evazion fiskal, shkelje të dispozitave të Kodit Doganor ose të veprimtarisë në port;

ç) të mos ketë marrë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

dh) të jetë rezident në Shqipëri;

e) të mos jetë kontraktues i një përdoruesi të portit ose personi që është drejtor, nëpunës apo i punësuar i kontraktuesit të përdoruesit të autoritetit portual;

ë) të mos ketë detyrime falimenti të papër-mbushura.

3. Të gjithë anëtarët emërohen nga ministri përgjegjës për portet shqiptare, me propozim të institucioneve përkatëse.

4. Anëtarët e këshillit drejtues emërohen për një afat jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Anëtarët e këshillit drejtues kanë statusin e punës me kohë të pjesshme.

5. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet me më shumë se gjysmën e anëtarëve të këtij këshilli. Në rast largimi të anëtarëve të këshillit drejtues, zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me parashikimet e këtij neni.

6. Këshilli drejtues, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh me shumicë votash kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Kryetari, si rregull, zgjidhet nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për portet shqiptare.

7. Këshilli drejtues përcakton pagesën e anëtarëve, të kryetarit dhe të drejtorit ekzekutiv, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Përgjegjësia e anëtarëve të këshillit drejtues dhe të nëpunësve

1. Çdo anëtar i këshillit drejtues dhe nëpunës i Autoritetit Portual Durrës, gjatë ushtrimit të përgjegjësive dhe kryerjes së detyrës duhet:

a) të veprojë me ndershmëri dhe përgjegjësi në interes të autoritetit portual;

b) të jetë profesionist në realizimin e detyrave;

c) të ndjekë hap pas hapi objektivin e kthimit të portit në një "port administrues toke", zbatimin e legjislacionit për autoritetin portual dhe rregullat e këtij statuti;

ç) të sigurojë përdorimin e mundësive dhe të rrisë shfrytëzimin maksimal të portit për të plotësuar kërkesat e klientit dhe të tregut;

d) të realizojë shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të portit;

dh) të respektojë rregullat e përcaktuara në legjislacionin e punës, si dhe në Kodin Etik të Sjelljes;

e) të njohë mirë rregullat e legjislacionit detar, në përgjithësi dhe veçanërisht, legjislacionin për autoritetin portual dhe aktet e dala në bazë e për zbatim të tyre.

Neni 10

Papajtueshmëria me postin e anëtarit të këshillit drejtues

1. Anëtar i këshillit drejtues nuk zgjidhet personi që:

a) nuk është shtetas shqiptar;

b) nuk është rezident në Shqipëri;

c) është kontraktues i një përdoruesi të Autoritetit Portual Durrës ose personi që është drejtor, nëpunës apo i punësuar i kontraktuesit të përdoruesit të këtij autoriteti portual;

ç) ka qenë i dënuar për vepra penale apo kundërvajtje administrative për evazion fiskal, shkelje të dispozitave të Kodit Doganor ose të veprimtarisë në port;

d) është përjashtuar nga shërbimi civil;

dh) ka konflikt interesash me detyrën;

e) nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga falimentimi.

Neni 11
Largimi nga detyra

1. Ministri përgjegjës për portet shqiptare largon nga detyra anëtarin e këshillit drejtues kur:

a) e shkarkon nga detyra për arsye se:

i. nuk vepron në përputhje me kërkesat e përgjegjësisë së anëtarëve të këshillit drejtues, të përcaktuara në ligjin "Për Autoritetin Portual" dhe rregullat e parashikuara në këtë statut;

ii. kryen vepra penale ose shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe të veprimtarisë në port.

b) e liron nga detyra kur:

i. jep dorëheqjen me shkrim;

ii. i kufizohet zotësia për të vepruar ose humb jetën;

iii. i mbaron mandati;

iv. konstatohen kushte të papajtueshmërisë me postin e anëtarit të këshillit drejtues;

v. mbush moshën për daljen në pension pleqërie.

2. Në rastin e nënparagrafit "v", të pikës 1, të këtij neni, kur anëtari i këshillit drejtues mbush moshën për daljen në pension pleqërie, ministri ka të drejtë ta lërë të vazhdojë funksionin e tij deri në mbarimin e mandatit, sipas kërkesës së anëtarit të këshillit drejtues, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 12
Detyrat dhe të drejtat e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual dhe ushtron të drejtat mbi pronën si "port administrues i pronës".

2. Këshilli drejtues harton, ndryshon dhe shfuqizon rregulloret e brendshme dhe vendimet që rregullojnë ecurinë e autoritetit portual.

3. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës dhe miraton planin strategjik të auditimit të brendshëm.

4. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës miraton marrjen e kredisë apo huas për qëllime të portit. Propozimi i marrjes së kredisë apo huas diskutohet paraprakisht nga këshilli konsultativ i portit.

Autoriteti Portual Durrës nuk mund të hipotekojë apo të lerë si garanci pronën shtetërore që menaxhon apo administron. Garanci mund të lihet vetëm nga të ardhurat e kësaj prone.

5. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës merr vendime, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për miratimin e lidhjes së kontratave të huadhënies apo huamarrjes mes Autoritetit Portual Durrës dhe subjekteve të treta tregtare.

6. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, pasi merr mendimin e komisioneve teknike, financiare dhe të këshillit konsultativ të portit përcakton kritere të qarta të dhënies së koncesionit, në përputhje me legjislacionin për koncesionet. Çdo rast, procedura e koncesionit bëhet në përputhje me legjislacionin e posaçëm për koncesionet.

7. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës për arritjen e objektivave në investime të miraton masa të nevojshme për të investuar me fondet e veta apo fondet e buxhetit të shtetit të miratuar për ministrinë përkatëse në zgjerimin, modernizimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës portuale.

8. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës nuk mund të shesë asnjërën nga pronat shtetërore që administron, por mund:

a) të ofrojë lehtësi, të japë të drejta ose leje për shërbimet ose të krijojë mundësi për t'i përdorur ato, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.;

b) të shesë pajisjet dhe të hartojë dokumentacionin e kërkuar për këtë qëllim;

c) të sigurojë territoret tokësore dhe ujore për zgjerimin e portit për t'i ardhur në ndihmë portit.

9. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës cakton tarifat, për:

a) anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;

b) ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar, brenda kufijve të portit ose magazinimin në port;

c) shërbimet që sigurohen nga Autoriteti Portual Durrës ose nga një operator i autorizuar ose për ndonjë të drejtë të dhënë prej tij në lidhje me portin;

Tarifat me propozimin e Autoritetit Portual Durrës miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për portet shqiptare dhe të ministrisë përgjegjëse për financat.

10. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës cakton normën e interesit që kërkohet për pagesat e vonuara.

11. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës aprovon planbiznesin e Autoritetit Portual Durrës me të dhënat e përcaktuara në ligjin "Për Autoritetin Portual", i cili miratohet nga ministri përgjegjës për portet shqiptare.

12. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës miraton pasqyrat financiare të vitit fiskal pararendës, në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, të shoqëruara me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

13. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës miraton strukturën dhe organigramën e Autoritetit Portual Durrës.

14. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës përcakton pagesën dhe strukturën e pagave të Autoritetit Portual Durrës, sipas legjislacionit në fuqi, me miratimin e ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

Neni 13
Mbledhja e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, si rregull, mblidhet, jo më pak se një herë në tre muaj.

2. Mbledhjet e këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës, si rregull bëhen me prezencë fizike, por në raste të veçanta mund të zhvillohen me pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, përfshirë komunikimin video dhe audiokonferencë.

3. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e kryetarit do të jetë vendimtare.

4. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës zhvillon mbledhjen vjetore, jo më vonë se një muaj pas mbylljes së llogarive të Autoritetit Portual, për miratimin e pasqyrave financiare të vitit fiskal pararendës, në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, të shoqëruara me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

5. Mbledhjet vjetore të autoritetit portual janë të hapura për publikun dhe çdo mbledhje tjetër që gjykohet prej tij.

6. Autoriteti Portual Durrës bën njoftimin në një nga gazetat kryesore në vend ose në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Portual Durrës, të paktën 30 ditë përpara mbledhjes, ku përcakton orën dhe vendin ku do të mbahet mbledhja dhe krijon mundësinë që pasqyrat financiare t'u vihen në dispozicion pjesëmarrësve.

7. Në mbledhjen vjetore, këshilli drejtues siguron:

a) numrin e mjaftueshëm të kopjeve të pasqyrave financiare të autoritetit portual për personat e pranishëm në mbledhje;

b) që drejtori ekzekutiv dhe anëtarët e këshillit drejtues t'u përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve për veprimtarinë e Portit Durrës.

8. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve të mbledhjeve të tij.

Neni 14
Emërimi i drejtorit ekzekutiv

1. Këshilli drejtues emëron drejtorin ekzekutiv dhe zëvendësin e tij, mbi bazën e propozimit të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

2. Drejtori ekzekutiv emëron nëpunësit e tjerë dhe personelin e nevojshëm për menaxhimin e portit.

3. Drejtori ekzekutiv nuk është anëtar i këshillit drejtues.

Neni 15
Marrëdhëniet ndërmjet këshillit drejtues dhe drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv është përgjegjës përpara këshillit drejtues për drejtimin dhe administrimin e Autoritetit Portual Durrës. Ai bashkërendon punën për planifikimin dhe caktimin e burimeve të të ardhurave të departamenteve dhe të njësive të tjera.

Neni 16
Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nëpunësit

1. Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv, janë:

a) Siguron drejtimin dhe administrimin efektiv të portit;

b) Zhvillon, zbaton dhe realizon veprimtaritë e përcaktuara nga ligji "Për Autoritetin Portual", si dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij;

c) Përgatit dokumentacionin e autoritetit portual për burimet njerëzore dhe i administron këto burime;

ç) Përfaqëson autoritetin portual në ministrinë përgjegjëse për portet shqiptare dhe në marrëdhënie me të tretë;

d) Siguron zbatimin e politikave të Autoritetit Portual Durrës dhe të kërkesave të tjera ligjore për këtë autoritet;

dh) Nxit rritjen e nivelit dhe profesionalizmin në anëtarët e stafit të tij;

e) Siguron të dhëna për këshillin drejtues për çështjet që lidhen me autoritetin portual dhe vë në dijeni këshillin drejtues për këto çështje dhe politikat që lidhen me to;

ë) Kontribuon në hartimin e politikave që synojnë rritjen e frytshme të autoritetit portual dhe vë në dijeni këshillin drejtues për këto politika;

f) Zbaton detyrat e tjera, të caktuara nga këshilli drejtues.

2. Drejtori ekzekutiv është menaxheri i përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga këshilli drejtues, duke i raportuar drejtpërdrejt atij.

3. Nëpunësit e njësive të tjera janë përgjegjëse përballë drejtorit ekzekutiv.

4. Drejtori ekzekutiv zbaton politika për forcimin e autoritetit portual dhe përgjegjësive, qartëson stafin për nivelin e punës së tyre dhe kryen detyrat publike, duke ruajtur mirëbesimin, integritetin dhe profesionalizmin e shërbimeve të kryera, të drejtën e publikut për t'u informuar lidhur me aktivitetin e portit.

5. Drejtori ekzekutiv, në mbështetje të kërkesave, i jep leje për të hyrë në port çdo personi që ushtron veprimtari në port.

6. Drejtori ekzekutiv gjithashtu, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mëposhtme:

a) Veprimtarinë portuale për transportin e mallrave, lundrimin, drejtimin e anijeve, transportin e pasagjerëve, ngarkim-shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat;

b) Veprimtari të tjera, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarive të mësipërme.

7. Drejtori ekzekutiv lidh kontrata në emër të autoritetit portual.

8. Drejtori ekzekutiv, në emër të Autoritetit Portual Durrës, në çdo mbledhje vjetore që organizohet, sipas detyrimeve që përcakton ligji "Për Autoritetin Portual", lidhur me veprimtarinë ekonomiko-financiare të këtij autoriteti, është i detyruar të paraqesë:

a) pasqyrat financiare krahasuese;

b) raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;

c) çdo të dhënë tjetër për pozitën financiare të autoritetit portual.

9. Drejtori ekzekutiv, në emër të Autoritetit Portual Durrës, i paraqet ministrit përgjegjës për portet shqiptare pasqyrat financiare të miratuara nga këshilli drejtues dhe është i detyruar t'i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare.

10. Drejtori ekzekutiv propozon strukturën e organizimit të Autoritetit Portual Durrës dhe strukturën e pagave, e cila miratohet nga këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës dhe nga ministri përgjegjës për portet shqiptare.

11. Drejtori ekzekutiv nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve ushtron veprimet e administrimit të veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës, të përcaktuara nga ligji "Për Autoritetin Portual", si dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij.

12. Drejtori ekzekutiv ka të drejtën të shqyrtojë ankesat e ndryshme për dallime në vendosjen e tarifave. Ai është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i ankesës.

13. Drejtori ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës, në zbatim të ligjit "Për Autoritetin Portual", ka të drejtë të shqyrtojë ankesat kundër gjobave për kundërvajtje administrative të vëna nga agjentët kontrollues në bazë të ligjit të mësipërm, të paraqitura brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit. Ai është i detyruar ta shqyrtojë ankesën brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

Neni 17
Këshilli konsultativ

Autoriteti Portual Durrës, në këshillim me ministrin përgjegjës për portet shqiptare, krijon një këshill konsultativ me 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, përfaqësues nga sektori privat dhe shtetëror, që kanë ndërveprim me aktivitetin portual dhe detar, ku shumicën e zë sektori privat, i cili këshillon Autoritetin Portual Durrës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, "Për Autoritetin Portual".

Neni 18
Librat e llogarive dhe sistemet

1. Autoriteti Portual Durrës mban librat e llogarive, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin "Për Autoritetin Portual", si më poshtë vijon:

a) ruan librat e llogarive dhe të raporteve llogaritëse;

b) siguron kontrollin financiar dhe menaxherial, përmes sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, duke garantuar dhe përditësimin e tyre, sa herë që ndryshojnë kushtet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Librat e llogarive, regjistrimet, sistemet dhe praktikat mbahen dhe përpunohen në mënyrë që të japin garanci se:

a) aktivet e autoritetit portual janë të siguruara dhe të kontrolluara;

b) veprimet e autoritetit portual janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) burimet njerëzore, financiare dhe fizike të autoritetit portual janë menaxhuar në mënyrë të frytshme dhe se operacionet e këtij autoriteti janë kryer realisht.

3. Autoriteti Portual Durrës mban një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së tij, në pajtim me kërkesat ligjore, dhe sigurohet që menaxhimi i aktiveve të investuara të jetë efektiv dhe i kujdesshëm.

Në mbylljen e vitit ushtrimor financiar, Autoriteti Portual Durrës harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar dhe përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen gjatë vitit ushtrimor financiar.

4. Subjektet portuale publike apo private që operojnë me asete të Autoritetit Portual Durrës kanë detyrimin të përdorin sistemet elektronike të inventarizimit të aktiveve të autoritetit portual në mënyrë që të jenë të siguruara dhe kontrolluara.

5. Subjektet portuale publike apo private të licencuara, që përdorin infrastrukturën portuale apo asete të Autoritetit Portual Durrës për të përmbushur shërbimet e përcaktuara në kontratë ose licencë kanë detyrimin t'i nënshtrohen tarifave portuale.

6. Çdo operator portual publik apo privat, institucione qendrore apo vendore, agjenci ligjzbatuese, që ushtrojnë aktivitetin në territorin, nën përgjegjësi administrimi nga Autoriteti Portual Durrës, kanë detyrimin të përdorin apo të shkëmbejnë informacion nëpërmjet sistemeve të komunitetit portual të implementuara nga autoriteti portual.

Neni 19
Kontrolli i Autoritetit Portual Durrës

1. Organet shtetërore që kanë objekt të veprimtarisë së tyre kontrollin e organeve publike ushtrojnë kontroll mbi Autoritetin Portual Durrës, sipas kompetencave respektive për të përcaktuar nëse veprimet e tij, janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Organet e kontrollit, në përfundim të kontrollit, u paraqesin këshillit drejtues dhe ministrit përgjegjës për portet shqiptare një raport për përfundimet e kontrollit dhe masat e sugjerimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për përmirësimin e punës, kur këto janë të domosdoshme.

3. Autoriteti Portual Durrës i nënshtrohet dhe kontrollit të auditit të brendshëm të tij, si dhe kontrollit që ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, që përzgjidhet me procedurë konkurruese dhe që kryejnë misionin e tyre, në pajtim me ligjin.

Neni 20
Planet e administrimit dhe përdorimit të tokës

1. Autoriteti Portual Durrës harton planin e administrimit të tokës (*masterplan)* të hollësishëm, i cili përmban objektivat dhe politikat për zhvillimin material të pronave shtetërore që administron. Hartimi ose rishikimi i një plani për administrimin e tokës, mbështetet në ligjet në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare. Planet duhet të përmbajnë dispozitat për rishikime, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ndryshimet e strategjisë së zhvillimeve të porteve.

2. Plani i administrimit të tokës (*masterplan*), me propozim të ministrit përgjegjës për portet shqiptare, miratohet nga strukturat përgjegjëse për miratimin e *masterplan*-eve.

3. Autoriteti Portual Durrës harton planet e përdorimit të porteve, të cilët miratohen nga këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, bazuar në planet e administrimit të tokës dhe përcaktojnë llojin

dhe kategoritë e aktiviteteve të lejueshme dhe ato të ndaluara në portin apo facilitetin portual përkatës.

4. Autoriteti Portual Durrës përcakton terminalet e përpunimit të mallrave, përfshirë terminalet logjistike në tokë, porte të thata nën administrimin e tij, brenda ose jashtë vendit, kategoritë e përpunimit, të cilët miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

Neni 21
Rregullimi i lëvizjeve brenda porteve

APD-ja planifikon dhe përcakton kalatën e akostimit të anijeve dhe të gjitha mjeteve lundruese të tjera, të cilat hyjnë në portet dhe terminalet nën administrim dhe mbikëqyrje të Autoritetit Portual Durrës, në përputhje me rregulloret e APD-së, profilin e terminalit ku do të operohet, bazuar në informacionin për mallin dhe anijen, gjendjen teknike të faciliteteve portuale, kohën e përpunimit, si dhe duke marrë në konsideratë nevojën e anijes për shkarkimin e mbeturinave dhe furnizimet e nevojshme.

Neni 22
Tarifat

1. Tarifat portuale për portet, nën administrim dhe mbikëqyrje të Autoritetit Portual Durrës, përcaktohen me propozimin e Autoritetit Portual Durrës dhe me miratimin e ministrisë përgjegjëse për portet shqiptare dhe të ministrisë përgjegjëse për financat.

2. Tarifat portuale, të caktuara nga Autoriteti Portual Durrës, duhet të jenë në nivel që i lejojnë atij të veprojë në baza vetëmbështetëse financiare dhe ato duhet të jenë të arsyeshme dhe të favorshme njëkohësisht për autoritetin dhe operatorët portualë.

3. Autoriteti Portual Durrës cakton tarifat për:

a) anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;

b) ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar, brenda kufijve të portit ose magazinimin në port;

c) shërbimet që sigurohen nga autoriteti portual ose nga një operator i autorizuar ose ndonjë të drejtë të dhënë prej tij, në lidhje me portin, si dhe për efekt të mirëmbajtjes së infrastrukturës të lidhura për to;

4. Kur tarifat portuale janë propozuar nga një operator që punon në port, Autoriteti Portual Durrës, pas këshillimit me këshillin konsultativ të portit, cakton një kufi tavan të këtyre tarifave. Tarifat portuale tavan, të propozuara nga Autoriteti Portual Durrës, sipas kësaj pike, nuk duhet të rrezikojnë arritjet ekonomike dhe financiare të operuesit.

5. Autoriteti Portual Durrës cakton normën e interesit që kërkon për pagesat e vonuara.

6. Kur cakton tarifat, Autoriteti Portual Durrës nuk i lejohet të shkelë barazinë e subjekteve përdoruese. Nuk përbën diskriminim apo shkelje të barazisë, nëse bëhen dallime në bazë të vëllimit të mallrave apo të sasisë së të mirave që tregtohen ose mbi baza të tjera, që nga ana tregtare janë të pranueshme.

7. Tarifat portuale këshillohen me këshillin konsultativ të portit dhe i nënshtrohen konsultimit publik, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

8. Udhëzimi i ministrive përgjegjëse për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 23
Shërbimet portuale kryesore

1. Shërbimet portuale kryesore përfshijnë çdo lloj veprimtarie që lidhet me mbërritjen dhe nisjen e mjeteve lundruese, si dhe me lëvizjen e pasagjerëve e të mallrave, brenda dhe jashtë porteve.

2. Shërbimet portuale kryesore kryhen nga subjekte publike ose private të licencuara.

3. Autoriteti Portual Durrës, në cilësinë e drejtuesit dhe kontrolluesit të shërbimeve portuale, vendos marrëdhënie tregtare e financiare me subjektet e licencuara nga ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë për të operuar në port, si dhe subjektet që gëzojnë një autorizim apo leje për të operuar në hapësirën portuale nën administrimin e Autoritetit Portual Durrës.

Neni 24
Shërbimet portuale jokryesore

1. Shërbimet portuale jokryesore përfshijnë çdo lloj veprimtarie tjetër të aktiviteteve tregtare dhe ofrimi i shërbimeve nga subjekte fizike apo juridike, që lidhen me veprimtaritë dhe shërbimet kryesore tregtare në Autoritetin Portual Durrës.

2. Autoriteti Portual Durrës, në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit të zbatueshëm dhe rregullave të përcaktuara nga këshilli drejtues, drejton, kontrollon dhe përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve dhe ushtrimin e veprimtarive jokryesore në portet, nën administrim dhe mbikëqyrje nga Autoriteti Portual Durrës, duke pajisur me lejet dhe autorizimet përkatëse çdo operator, kur ky i fundit provon në mënyrë të kënaqshme se plotëson kriteret, sipas parashikimeve ligjore.

Autorizimit i nënshtrohen dhe veprimtaritë e uljes, ngritjes, mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve lundruese të ankoruara në kalata, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

3. Autoriteti Portual Durrës, në cilësinë e drejtuesit dhe kontrolluesit të shërbimeve portuale, lidh kontratë me këta operatorë, duke bërë përcaktimin e marrëdhënies financiare të Autoritetit Portual Durrës.

Neni 25
Mbështetja e autoritetit kompetent për licencimet

Autoriteti Portual Durrës, në cilësinë e drejtuesit dhe kontrolluesit të shërbimeve portuale, siguron përshtatshmërinë e kërkesave për licencim pranë autoritetit kompetent të subjekteve, me objekt veprimtarie përpunimin e transportit të mallrave ose pasagjerëve që transportohen në rrugë detare

Neni 26
Masat për kundërvajtjet dhe e drejta e ankimit

1. Dënimet me gjobë të kundërvajtjeve, sipas përcaktimeve të neneve 45 dhe 46, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, "Për Autoritetin Portual", vendosen nga agjentët kontrollues, të caktuar nga drejtori ekzekutiv.

2. Kundër dënimit administrativ me gjobë bëhet ankim te drejtori ekzekutiv, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Drejtori ekzekutiv është i detyruar ta shqyrtojë ankesën dhe të kthejë përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ankimit.

4. Kundër vendimit të drejtorit dhe në rastin kur ai nuk përgjigjet brenda afatit të caktuar, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e dhënies së dënimit administrativ.

Neni 27
Shërbimi i sigurisë në anije dhe në port

1. Autoriteti Portual Durrës, për të siguruar personat nga rreziku për jetën dhe plagosja e për të siguruar materialet nga dëmtimi ose humbja në portet e Shqipërisë, krijon Forcën e Sigurisë Portuale Durrës (FSPD) dhe cakton stafin e nevojshëm, bazuar në kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Portual Durrës, në varësi të rritjes së vëllimit të punës, ka të drejtë të rrisë ose të pakësojë numrin e punonjësve të FSPD-së.

2. FSPD-ja regjistron të gjitha aksidentet e ndodhura dhe zbaton rregulloret dhe udhëzimet e hartuara sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe sistemet e praktikat e pranuara nga shteti shqiptar për mbrojtjen e personave dhe të materialeve në port.

3. FSPD-ja e zhvillon veprimtarinë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Porteve, të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), me Konventën SOLAS, të ndryshuar, me ligjin "Për sigurinë në anije dhe porte", dhe me aktet e tjera nënligjore në fuqi.

4. Detyrat e shërbimit të sigurisë përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës të objekteve dhe vlerave të portit;

b) krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për Autoritetin Portual Durrës dhe operatorët e ndryshëm në të gjitha terminalet logjistike në tokë, porte të thata, nën administrimin apo monitorimin e tij, brenda ose jashtë vendit, për një punë 24-orëshe me tri turne;

c) përgatitjen e rregulloreve të sigurisë për transportimin, lëvizjet ose magazinimin e eksplozivëve a të substancave të tjera që përbëjnë rrezik për jetën dhe pronën;

ç) përgatitjen e planeve dhe të rregullores së sigurisë për personat dhe mjetet e transportit në port;

d) sugjerimet për përgatitjen e planit të biznesit dhe të planit të përdorimit të tokës.

5. Drejtori i FSPD-së është në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës dhe përgjigjet para tij për të gjithë veprimtarinë e sigurisë në port dhe në anijet e ankoruara, në lëvizje nga dhe në drejtim të portit, në

radë, si dhe vepron në përputhje me udhëzimet e drejtorit ekzekutiv.

6. FSPD-ja i paraqet nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, këshillit drejtues çdo vit një raport për problemet e sigurisë.

7. Përcaktimi i kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes FSPD-së përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

8. FSPD-ja pajiset me uniformë të veçantë dhe është e pajisur me armatimin dhe mjetet e nevojshme, për të siguruar mbrojtjen e portit dhe të anijeve nga çdo sulm i mundshëm, terrorist apo keqbërës ose nga hyrja, në mënyrë të kundërligjshme, e shtetasve dhe e mjeteve në zonën, që ka objekt kontrolli.

Pajisjet, mjetet dhe armatimi i lejuar janë armë tipit pistoletë, shkop zgjatues dhe mbajtës, mjete transporti dhe patrulluese tokësore dhe lundruese, mjetet e ndërlidhjes radiostacionare VHF, radio dore VHF.

9. FSPD-ja, kur, gjatë ushtrimit të veprimtarisë vëren kryerjen e një vepre penale, njofton strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe të Prokurorisë, si dhe bashkëpunon me ta për ndalimin e autorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, FSPD-ja kur vëren shkelje apo shmangie nga detyrimet doganore, i raporton menjëherë degës së doganave, Durrës.

10. Rregullorja e brendshme e FSPD-së, pas aprovimit të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë Portuale dhe këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

Neni 28
Bashkërendimi i detyrave me komitetin e sigurisë

1. Komiteti i sigurisë në anije dhe në portet e hapura, nën përgjegjësi administrimi dhe mbikëqyrje të APD-së, i ngritur sipas ligjit nr. 9281, datë 23.9.2004, "Për sigurinë në anije dhe në porte", vlerëson projektplanet e sigurisë dhe bashkërendon punën me palët operuese në port për zbatimin e këtyre planeve.

2. Autoriteti Shtetëror i Sigurisë apo Autoriteti Portual Durrës, në rast se e vlerësojnë të nevojshme, mund të kërkojnë mbledhjen e komitetit të sigurisë në çdo kohë.

3. Autoriteti Portual Durrës siguron dhe koordinon integrimin e sistemeve të sigurisë portuale, sisteme, në të cilat kanë detyrimin për tu integruar të gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet që ushtrojnë detyrat, sipas kompetencave në territoret e Autoritetit Portual Durrës.

Neni 29
Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit

1. Autoriteti Portual Durrës për mbrojtjen e mjedisit në port, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për lejet mjedisore krijon shërbimin e kualifikuar të mbrojtjes së mjedisit dhe ndan përgjegjësitë e përcakton detyrat e këtij shërbimi.

2. Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit regjistron të gjitha rastet e veprimeve që cenojnë mjedisin dhe zbaton rregulloret, vendimet dhe udhëzimet e Autoriteti Portual Durrës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, me sistemet dhe praktikat e pranuara nga shteti shqiptar për mbrojtjen e mjedisit dhe të tokës së portit.

3. Detyrat e shërbimit të mbrojtjes së mjedisit përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) garantimin, monitorimin e cilësisë së mjedisit ujor dhe në tokë të portit, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit apo inspektimit për operatorët portualë të licencuar dhe nënkategorive të tjera;

b) hartimin e planeve të kontingjencës, si dhe të rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja gjatë transportimit, lëvizjes ose magazinimit të substancave që përbëjnë rrezik për mjedisin;

c) pjesëmarrjen në përgatitjen e planit të biznesit dhe të planit të përdorimit të tokës.

4. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit, si rregull, çdo vit, por edhe për çdo rast ndotjeje, i paraqet këshillit drejtues një raport të hollësishëm për problemet mjedisore të portit.

5. Personeli i shërbimit të mbrojtjes së mjedisit dhe i shërbimit të sigurisë, të emëruar nga autoriteti portual, duhet të bashkërendojnë detyrat e tyre me Kapitenerinë e Përgjithshme të Porteve dhe me organizmat e tjerë, rajonalë ose kombëtarë, përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe për sigurimin industrial.

6. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit dhe nëpunësi i sigurisë janë përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë në zonën tokësore, ndërsa kapiteni i portit është përgjegjës për zonën ujore të portit dhe për anijet.

7. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit është pjesë e procedurave të konsultimit bashkë me institucionet e tjera përgjegjëse para, gjatë, apo pas licencimit të veprimtarive me ndikim në mjedis në territorin tokësor ose operatorët portualë që licencohen, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 30

Shërbimi i mbikëqyrjes së sigurisë dhe shëndetit në punë

1. Autoriteti Portual Durrës siguron shërbimin e mbikëqyrjes për garantimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë nga vetë punonjësit nga operatorët portualë dhe nga kontraktorët e tij.

2. Ky shërbim mund të realizohet nga ekspertë të punësuar ose të kontraktuar nga autoriteti portual dhe të ngarkuar me kryerjen e detyrave, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.

3. Detyrat e shërbimit të mbikëqyrjes së sigurisë dhe të shëndetit në punë përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, formimit të punëmarrësve të Autoritetit Portual Durrës;

b) marrjen e masave që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi sigurinë dhe shëndetin në punë;

c) dhënien e ndihmës së parë, mbrojtjen kundër zjarrit dhe evakuimin e punëmarrësve;

ç) dhënien e informacionit për vlerësimin e rreziqeve, masat mbrojtëse, regjistrin dhe raportet e aksidenteve në punë, si dhe raportet nga inspektoratet ose institucionet përgjegjëse për sigurinë e shëndetin në punë;

d) hartimin e planit dhe organizimin e trajnimeve;

dh) sigurimin që punëmarrësit e Autoritetit Portual Durrës të jenë të pajisur me lejet e ushtrimit të profesioneve, të cilat parashikohen me akte ligjore të veçanta;

e) sigurimin e funksionimit të vazhdueshëm dhe të duhur të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse, mjeteve të matjes dhe të kontrollit, si dhe të pajisjeve të diktimit, mbajtjes nën kontroll dhe neutralizimit të substancave të rrezikshme, që çlirohen gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike;

ë) vënien në dispozicion të inspektorëve të punës gjatë inspektimit ose hetimit të ngjarjeve, dokumentacionin e nevojshëm dhe informacionin e kërkuar;

f) bërjen e rregullimeve të nevojshme për të realizuar masat, që kërkohen nga inspektorët e punës gjatë inspektimeve ose hetimeve të ngjarjeve;

g) bashkërendimin e punës me kontraktorët e portit dhe operatorët portualë:

i. për zbatimin e dispozitave për sigurinë, higjienën dhe shëndetin, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë së punës;

ii. për mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve profesionale, duke siguruar që çdo operator apo kontraktor të caktojë një koordinator për sigurinë dhe shëndetin në punë;

iii. për shkëmbimin reciprok të informacioneve për këto rreziqe, për të cilat duhen vënë në dijeni punëmarrësit përkatës ose përfaqësuesit e tyre.

gj) kryerjen e një vlerësimi të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve të autoriteti portual, përfshirë edhe për grupet e operatorëve ose kontraktorëve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta;

h) përcaktimin e masave mbrojtëse që duhen marrë dhe, nëse është e nevojshme, pajisjet mbrojtëse që do të përdoren;

i) mbajtjen e regjistrit të aksidenteve në punë, për rastet kur punëmarrësit përfitojnë paaftësi të përkohshme në punë, për më shumë se 3 (tri) ditë pune, për shkak të aksidenteve e të sëmundjeve profesionale;

j) hartimin e raporteve për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale, të cilat ia vë në dispozicion autoriteteve përkatëse;

k) detyrime të tjera për punëdhënësin që parashikon ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë.

4. Shërbimi i mbikëqyrjes për garantimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe me Inspektoratin Sanitar Shtetëror.

5. Autoriteti Portual Durrës ushtron kontroll pranë operatorëve portualë dhe kontraktorëve të tij, me qëllim garantimin prej tyre të sigurisë dhe

shëndetit në punë në zonat portuale përkatëse, si dhe i propozon këshillit drejtues ose ministrit përgjegjës rregullore, të cilat përcaktojnë kriteret për garantimin dhe sigurinë e shëndetit në punë gjatë kryerjes së operacioneve portuale, riparimit dhe mirëmbajtjes së anijeve në hapësirën portuale.

VENDIM
Nr. 284, datë 8.5.2024

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 13, pas fjalëve "...(CFSP) 2024/951...." shtohen "...(CFSP) 2024/1025, (CFSP) 2024/1074...";

b) Në pikën 19, pas fjalëve "...(CFSP) 2023/1780..." shtohen "...(CFSP) 2024/1019...'".

2. Në aneksin 13, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2024/1025 dhe (CFSP) 2024/1074, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në aneksin 19, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/1019, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Fletorja Zyrtare
e Bashkimit Evropian

AL
seritë L

2024/1019

5.4.2024

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/1019

i datës 4 prill 2024

mbi ndryshimin e Vendimit 2011/235/CFSP në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë,

Ndërsa:

(1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/CFSP ([1]).

(2) Në bazë të një rishikimi të Vendimit 2011/235/CFSP, Këshilli konsideron se masat kufizuese të përcaktuara në të duhet të rinovohen deri më 13 prill 2025.

(3) Këshilli ka arritur në përfundimin se shënimi në lidhje me një entitet të caktuar në Aneksin e Vendimit 2011/235/CFSP duhet të hiqet dhe se shënimet në lidhje me 17 persona duhet të përditësohen.

(4) Vendimi 2011/235/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/235/CFSP ndryshohet si më poshtë:

(1) në nenin 6, paragrafi 2 zëvendësohet si vijon:

'2. Ky vendim do të zbatohet deri më 13 prill 2025. Ai do të mbahet në shqyrtim të vazhdueshëm. Ai do të rinovohet, ose do të ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.';

(2) Aneksi ndryshohet në përputhje me Aneksin e këtij vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Bërë në Bruksel, më 4 prill 2024.

Për Këshillin

Presidenti
H. LAHBIB

([1]) Vendimi i Këshillit 2011/235/CFSP i 12 prillit 2011 në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (OJ L 100, 14.4.2011, f. 51).

ANEKS

Aneksi i Vendimit 2011/235/CFSP ("Lista e personave dhe subjekteve të përmendura në nenet 1 dhe 2") është ndryshuar si më poshtë:

(1) në listën e titulluar "Entitete", hyrja 11 (në lidhje me Arvan Cloud (alias Abr Arvan; Noyan Abr Arvan Co.; Arwan Company; Arvancloud)) është fshirë;

(2) në listën e titulluar "Personat", shënimet për 17 personat e mëposhtëm zëvendësohen me sa vijon:

Personat

	Emri	Informacion Identifikues	Arsyet	Data e listimit
'4.	FAZLI Ali علی فضلی	Gjinia: mashkull Kombësia: Iraniane Grada: Gjeneral brigade Pozicioni: Komandant i Universitetit Imam Hossein (alias Universiteti Imam Husein)	Që nga maji 2017, komandant i Universitetit Imam Hossein me urdhër të Kryekomandantit të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC). Ish-shefi i Kolegjit Kadet Imam Hossein (2018-qershor 2020). Ish zëvendës komandant i Basij (2009-2018). Ish kreu i Korpusit të IRGC-së Seyyed al-Shohada, provinca e Teheranit (deri në shkurt 2010). Korpusi Seyyed al-Shohada është përgjegjës për sigurinë në provincën e Teheranit dhe luajti një rol kyç në shtypjen brutale të protestuesve në vitin 2009.	12.4.2011
8.	MOTLAGH Bahram Hosseini بهرام حسینی مطلق	Gjinia: mashkull Kombësia: Iraniane Grada: Gjeneral brigade Pozicioni: Anëtar i stafit pedagogjik të Universitetit Imam Hossein (Gardianët e Revolucionit) (alias Universiteti Imam Husein) dhe shef i departamentit të planifikimit dhe operacioneve të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	Anëtar i stafit pedagogjik të Universitetit Imam Hossein (Gardianët e Revolucionit) dhe shef i departamentit të planifikimit dhe operacioneve të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ish-shefi i Kolegjit të Komandës së Ushtrisë dhe Shtabit të Përgjithshëm (DAFOOS). Ish kreu i Korpusit Seyyed al-Shohada të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike, provinca e Teheranit. Korpusi Seyyed al-Shohada luajti një rol kyç në organizimin e shtypjes së protestave në vitin 2009.	12.4.2011
10.	RADAN Ahmad-Reza احمدرضا رادان	VENDLINDJA: Isfahan (Iran) DATËLINDJA: 1963 Gjinia: mashkull Kombësia: iraniane Pozicioni: Shefi i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF)	Që nga janari 2023, kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF), referuar gjithashtu si policia kombëtare iraniane. Ish-drejtues i Qendrës për Studime Strategjike të LEF-it iranian, një organ i lidhur me LEF. Zëvendëskryetar i LEF nga viti 2008 deri në qershor 2014. Në atë pozicion, Radan ishte përgjegjës për rrahje, vrasje dhe arrestime arbitrare dhe ndalime të protestuesve që u kryen nga forcat e policisë. Si ish-komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike, ai ishte përgjegjës për trajnimin e forcave "anti-terroriste" irakene.	12.4.2011

13.	TAEB Hossein حسین طائب	VENDLINDJA: Teheran (Iran) DATËLINDJA: 1963 Gjinia: mashkull Kombësia: iraniane Pozicioni: këshilltar i Komandantit të Përgjithshëm të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC)	Që nga viti 2022, këshilltar i Komandantit të Përgjithshëm të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), Hossein Salami. Ish kreu i organizatës së inteligjencës IRGC (tetor 2009–deri në qershor 2022). Përgjegjësitë e tij u zgjeruan në maj 2019 me bashkimin e Zyrës së Zëvendësit të Inteligjencës Strategjike të IRGC-së dhe Organizatës së Inteligjencës së IRGC-së. Komandant i Basij deri në tetor 2009. Forcat nën komandën e tij morën pjesë në rrahje masive, vrasje, ndalime dhe tortura të protestuesve paqësorë.	12.4.2011
45.	JOKAR Mohammad Saleh محمد صالح جوکار	VENDLINDJA: Yazd (Iran) DATËLINDJA: 1957 Gjinia: mashkull Kombësia: iraniane Pozicioni: Deputet i provincës së Yazdit dhe kryetar i Komisionit të Punëve të Brendshme dhe Këshillave Parlamentare	Deputet i provincës Yazd dhe kryetar i Komisionit të Punëve të Brendshme dhe Këshillave Parlamentare. Gjeneral i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) dhe ish-zëvendës për Çështjet Parlamentare të IRGC. Nga viti 2011 deri në vitin 2016, deputet i provincës së Yazdit dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme. Ish komandant i Forcave të Basijit Studentor. Në atë rol, ai u përfshi në mënyrë aktive në shtypjen e protestave dhe indoktrinimin e fëmijëve dhe të rinjve me synimin për të vazhduar shtypjen e fjalës së lirë dhe disidencës. Si anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme, ai mbështeti publikisht shtypjen e opozitës ndaj qeverisë dhe politikave të saj represive. Pas vdekjes së Mahsa Amini në vitin 2022, ai luajti një rol qendror në propozimin e amendamenteve në ligjin e zgjedhjeve parlamentare të krijuara për të fuqizuar palët e vijës së ashpër në zgjedhjet parlamentare dhe për të mbyllur kërkesat e protestuesve.	10.10.2011
51.	SALARKIA Mahmoud محمود سالار کیا	Gjinia: mashkull Kombësia: iraniane	Mahmoud Salarkia aktualisht punon si avokat dhe vazhdon të shtypë të drejtat individuale të qytetarëve iranianë në mbrojtje të politikave represive të regjimit. Ai figuron në listën e avokatëve kompetentë sipas nenit 48 të kodit të procedurës penale iraniane, në bazë të të cilit të pandehurve për disa krime politike dhe të sigurisë u mohohet zgjedhja e një avokati gjatë fazës së marrjes në pyetje dhe hetimit nga prokuroria. Ish-kreu i Komisionit të naftës dhe transportit të qytetit të Teheranit. Zëvendës i Prokurorit të Përgjithshëm të Teheranit për Çështjet e Burgjeve gjatë goditjes së vitit 2009. Në atë pozicion, ai ishte drejtpërdrejt përgjegjës për shumë prej urdhër arresteve kundër protestuesve dhe aktivistëve të pafajshëm, paqësorë. Shumë raporte nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut tregojnë se pothuajse të gjithë të arrestuarit, me udhëzimin e Salarkia-s, mbaheshin të pa komunikuar pa akses me avokatin ose familjet e tyre dhe pa akuza, për periudha të ndryshme kohore, shpesh në kushte që çonin në zhdukje të detyruar. Shpesh familjarët e të arrestuarve nuk njoftoheshin për arrestimin.	10.10.2011

83.	JAFARI Asadollah اسدالله جعفری	Gjinia: mashkull Kombësia: iraniane Pozicioni: Shef i Administratës Gjyqësore në Isfahan dhe Shef i Shtabit të Ekonomisë së Rezistencës	Shef i Administratës Gjyqësore në Isfahan dhe Shef i Shtabit të Ekonomisë së Rezistencës. Ish-Prokuror i Përgjithshëm në Isfahan. Në atë pozicion, ai urdhëroi reagime të dhunshme kundër protestuesve që dolën në rrugë në nëntor 2021 për të protestuar kundër mungesës së ujit. Sipas disa raportimeve, Asadollah Jafari ka njoftuar formimin e një zyre speciale për hetimin e protestuesve të arrestuar dhe ka urdhëruar dënimin e disa protestuesve të përfshirë në protestat e vitit 2022. Nga viti 2017 deri në vitin 2021, ai mbajti postin e Prokurorit të Përgjithshëm në provincën e Khorasanit të Veriut. Si ish-prokuror i provincës Mazandaran (2006-2017), Jafari rekomandoi imponimin e dënimit me vdekje në rastet që ai ndiqte penalisht, gjë që ka rezultuar në shumë ekzekutime, duke përfshirë ekzekutime publike, dhe në rrethana kur imponimi i dënimit me vdekje është në kundërshtim me të drejtat ndërkombëtare njerëzore, duke përfshirë dënimin jo-proporcional dhe të tepruar. Jafari ka qenë gjithashtu përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe shkelje të të drejtave të të burgosurve të Bahá'í–t që nga arrestimi fillestar deri në mbajtjen e tyre në izolim në Qendrën e Paraburgimit të Inteligjencës.	12.3.2013
86.	MUSAVI-TABAR Seyyed Reza سیدرضا موسوی تبار	VENDLINDJA: Jahrom (Iran) DATËLINDJA: 1964 Gjinia: mashkull Kombësia: iraniane Pozicioni: Përfaqësues i Prokurorit Disiplinor për Gjyqtarët në Shiraz	Që nga viti 2014, Seyyed Reza Musavi-Tabar është përfaqësues i Prokurorit Disiplinor për Gjyqtarët në Shiraz. Ish-drejtues i Prokurorisë Revolucionare të Shirazit. Përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe keqtrajtime të aktivistëve politikë, gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, Bahá'í- dhe të burgosurve të ndërgjegjes, të cilët u sulmuan, torturuan, u morën në pyetje dhe iu mohuan aksesi ndaj avokatëve dhe procesit të rregullt ligjor. Musavi-Tabar nënshkroi urdhra gjyqësorë në Qendrën Famëkeqe Nr 100 të Paraburgimit (një burg për meshkuj), duke përfshirë një urdhër për të mbajtur të burgosuren femër Bahá'í Raha Sabet për tre vjet në izolim.	12.3.2013

93.	ZIAEI Gholamreza غلامرضا ضیایی	Gjinia: mashkull Kombësia: iraniane Pozicioni: Ish Drejtor i Burgut Evin; ish-drejtor i qendrave të tjera të paraburgimit	Nga korriku 2019 deri në qershor 2020, Gholamreza Ziaei ishte Drejtor i Burgut Evin në Teheran. Gjatë mandatit të tij, kushtet tashmë të vështira për të burgosurit u përkeqësuan më tej, përfshirë edhe për Narguess Mohammadi. Të burgosurve femra iu mohua kontakti telefonik me familjet e tyre. Të burgosurve politikë u refuzohej vizita javore nga të afërmit, të cilat lejoheshin vetëm çdo dy muaj. Gjatë protestave të vitit 2009, Ziaei ishte në krye të Qendrës së Paraburgimit në Kahrizak, ku të paktën pesë të burgosur, të cilët ishin arrestuar në lidhje me protestat masive në rrugët të Teheranit në vitin 2009, vdiqën pasi u torturuan. Nga viti 2017 deri në vitin 2019, para se të merrte përgjegjësinë e burgut Evin, Ziaei ishte Drejtor i Burgut Rajaee Shahr në Karaj, në perëndim të Teheranit, ku ka pasur protesta të shumta nga të burgosurit politikë kundër abuzimeve dhe kushteve çnjerëzore të jetesës.	12.4.2021
94.	SHAHVARPOUR Hassan حسن شاهوارپور	VENDLINDJA: Safi Abad, në jug të Dezful, Khuzestan (Iran) Gjinia: mashkull Kombësia: Iraniane Numri i pasaportës: 20016240001 (numri i identitetit kombëtar) Pozicioni: Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) komandant i provincës Khuzestan (korpusi Vali Asr) Grada: Gjeneral Brigade	Gjeneral brigade Hassan Shahvarpour ka qenë komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në provincën Khuzestan (Vali Asr Corps) që nga viti 2009. Në vitin 2023, Korpusit Vali Asr iu dha një certifikim nga Komandanti i Përgjithshëm i IRGC-së për të qenë Korpusi më i suksesshëm në menaxhimin e hapësirës kibernetike. Hassan Shahvarpour është përgjegjës për komandimin e forcave, të cilat përdorën mitralozë kundër protestuesve dhe civilëve të tjerë në qytetin Mahshahr gjatë protestave të nëntorit 2019. Nën komandën e tij, 148 persona u vranë nga IRGC nga të shtënat me mitraloz të rëndë nga automjetet e blinduara që rrethonin protestuesit që iknin të fshehur në kënetat aty pranë.	12.4.2021
117.	KOCHZAEI Ebrahim (alias KOCHZAI Ebrahim, KOUCHAKZAEI Ebrahim) ابراهیم کوچزایی	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Kolonel Funksioni: ish Shefi i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në qytetin Chabahar në provincën Sistan dhe Baluchestan	Kolonel Ebrahim Kochzaei ishte Shefi i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në qytetin Chabahar në provincën Sistan dhe Baluchestan deri më 3 dhjetor 2022. Forcat e sigurisë në provincën Sistan dhe Baluchestan, përfshirë në Chabahar, përdorën dhunë brutale kundër protestuesve paqësorë në protestat e vjeshtës 2022, duke përfshirë edhe fëmijët. Kochzaei përmendet gjithashtu si autori i përdhunimit në shtator 2022 të një vajze 15-vjeçare e cila u mbajt në paraburgim nga policia në Chabahar. Prandaj, Ebrahim Kochzaei është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	14.11.2022

118.	TAHERI Ahmad احمد طاهری	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral Brigade Funksioni: këshilltar i kreut të forcave iraniane të zbatimit të ligjit (LEF); ish kreu i LEF iranian në provincën Sistan dhe Baluchestan	Gjeneral brigade Ahmed Taheri ka qenë këshilltar i kreut të forcave iraniane të zbatimit të ligjit (LEF) (gjeneral brigade Radan i listuar në BE) që nga vjeshta 2023. Ai ishte kreu i LEF iranian në provincën Sistan dhe Baluchestan gjatë protestave të vitit 2022 /2023. Forcat e sigurisë në provincën Sistan dhe Baluchestan përdorën dhunë brutale kundër protestuesve paqësorë në protestat e vjeshtës 2022, duke përfshirë edhe fëmijët. Si Kryetar i LEF-it iranian në provincën Sistan dhe Baluchestan, Ahmed Taheri është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	14.11.2022
144.	SOURI Majid مجید سوری	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral brigade i dytë Funksioni: Drejtues i Organizatës Rahian-e Noor dhe Turizmit; ish Zëvendës Komandant i Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në provincën Lorestan	Majid Souri është një gjeneral brigade i dytë i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC). Ai ishte zëvendës komandant i IRGC-së në provincën e Lorestanit. Që nga dhjetori 2022, ai është Kryetar i Organizatës Rahian-e Noor dhe Turizmit, të lidhur me IRGC-në dhe Basij-in. Ai është përgjegjës për shtypjen e dhunshme të protestave nga forcat e sigurisë në vitin 2022, veçanërisht në qytetin Khorramabad, ku njerëzit u mblodhën për të mbajtur zi për vdekjen e Nika Shakrami, një adoleshente iraniane që u zhduk menjëherë pas vdekjes së Mahsa Amini. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	12.12.2022
145.	KARIMI Mohsen محسن کریمی	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral Brigade Funksioni: Komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në provincën Markazi	Gjeneral brigade Mohsen Karimi është komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në provincën e Markazit, i njohur gjithashtu si Korpusi Ruhollah. Korpusi Ruhollah është një njësi ushtarake e IRGC-së me sellinë e saj të vendosur në Arak dhe është përgjegjëse për komandimin dhe kontrollin e të gjitha njësive të IRGC dhe Basij të vendosura në provincën Markazi. Ai është përgjegjës për shtypjen e dhunshme të protestave nga forcat e sigurisë në vitin 2022, që çuan në vdekjen e 19-vjeçarit Mehrshad Shahidi në një qendër paraburgimi të IRGC-së në Arak. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	12.12.2022

146.	HEYDARNIA Alireza علیرضا حیدرنیا	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral Brigade Funksioni: Komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në provincën Alborz	Gjeneral brigade Alireza Heydarnia është komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në provincën Alborz, i njohur gjithashtu si Korpusi Imam Hassan Mojtaba. IRGC është përgjegjëse për shtypjen e dhunshme të protestuesve, veçanërisht në qytetin e Karaj, Alborz, në vitin 2022. Në atë qytet, forcat e sigurisë goditën protestuesit me rastin e mitingjeve për të ndëruar viktimat e protestave në ditën e 40-të pas vdekjes së tyre. Më 17 tetor 2022, forcat e sigurisë në Karaj rrëmbyen nga spitali dhe dhunuan në mënyrë të përsëritur Armita Abbasin, një vajzë 20-vjeçare. Prandaj, Alireza Heydarnia është përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	12.12.2022
156.	SAJJADI Seyed Hamid Hazaveh سید حمید هزاوه سجادی	DATËLINDJA: 21.3.1969 VENDLINDJA: Iran Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Funksioni: Anëtar i Këshillit të Lartë të Sportit; ish ministri iranian i Sportit dhe Rinisë	Hamid Sajjadi ka qenë anëtar i Këshillit Suprem të Sporteve që nga 22 gusht 2023. Ai ka qenë Ministër i Sportit dhe Rinisë i Iranit nga 15 gusht 2021 deri në gusht 2023. Ai është përgjegjës për presionin ndaj atletëve të Iranit për të heshtur dhe për t'i penguar ata të flasin ndërkombëtarisht kundër represionit në Iran. Ai ka qenë i përfshirë personalisht në rastin e Elnaz Rekabit, një alpiniste iraniane që konkurroi pa hijabin në garën e kampionatit aziatik të ngjitjes shkëmbore në Seul në vjeshtën e vitit 2022. Pas konkurrimit të saj, Rekabi u mashtrua për të hyrë në ndërtesën e ambasadës iraniane në Seul, ku me urdhër të autoriteteve në Teheran iu konfiskuan pasaporta dhe celulari. Pas mbërritjes së saj të mundshme me forcë në Teheran, ajo u mor në pyetje nga dy nga institucionet politike dhe sportive të Iranit dhe u takua me Sajjadi. Në atë takim ajo u detyrua të bënte një deklaratë duke kërkuar falje për konkurrimin pa hijabin dhe u kërcënua me konfiskim të tokës familjare. Në dhjetor 2022, u bë e qartë se shtëpia e familjes së Elnaz Rekabit në Zanjan ishte prishur. Prandaj Hamid Sajjadi është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	23.1.2023

224.	NIKVARZ Mohsen محسن نیک ورز	VENDLINDJA: Iran Gjinia: mashkull Kombësia: Iraniane Funksioni: Prokuror Publik i Sirjan-it	Si Prokuror Publik i Sirjanit, Mohsen Nikvarz ishte përgjegjës për disa arrestime arbitrare të avokatëve dhe dënime me vdekje në Sirjan gjatë protestave të vitit 2019. Në vitin 2023, ai u gradua në krye të Qendrës për Mbrojtjen dhe Inteligjencën e Gjyqësorit të provincës Kerman. Në kuadër të protestave që shpërthyen në shtator 2022, Nikvarz u përfshi edhe në qështjen Maryam Arvin, duke e ndjekur penalisht për aktivitetet e saj si avokate mbrojtëse e protestuesve. Pas arrestimit të saj, për të cilin Nikvarz mban përgjegjësi personale, Maryam Arvin u torturua brutalisht në burg. Prandaj, Mohsen Nikvarz është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	22.5.2023’

Official Journal of the European Union
EN
L series

2024/1019
5.4.2024

COUNCIL DECISION (CFSP) 2024/1019

of 4 April 2024

amending Decision 2011/235/CFSP concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Iran

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 12 April 2011, the Council adopted Decision 2011/235/CFSP [1].

(2) On the basis of a review of Decision 2011/235/CFSP, the Council considers that the restrictive measures set out therein should be renewed until 13 April 2025.

(3) The Council has concluded that the entry concerning one entity designated in the Annex to Decision 2011/235/CFSP should be removed, and that the entries concerning 17 persons should be updated.

(4) Decision 2011/235/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision 2011/235/CFSP is amended as follows:

(1) in Article 6, paragraph 2 is replaced by the following:

'2. This Decision shall apply until 13 April 2025. It shall be kept under constant review. It shall be renewed, or amended as appropriate, if the Council deems that its objectives have not been met.';

(2) the Annex is amended in accordance with the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 4 April 2024.

For the Council
The President
H. LAHBIB

[1] Council Decision 2011/235/CFSP of 12 April 2011 concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Iran (OJ L 100, 14.4.2011, p. 51).

ANNEX

The Annex to Decision 2011/235/CFSP ('List of persons and entities referred to in Articles 1 and 2') is amended as follows:

(1) in the list headed 'Entities', entry 11 (concerning Arvan Cloud (a.k.a. Abr Arvan; Noyan Abr Arvan Co.; Arwan Company; Arvancloud)) is deleted;

(2) in the list headed 'Persons', the entries for the following 17 persons are replaced by the following:

Persons

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
'4.	FAZLI Ali علی فضلی	Gender: male Nationality: Iranian Rank: Brigadier-General Position: Commander of Imam Hossein University (a.k.a. Imam Hussein University)	Since May 2017, Commander of Imam Hossein University by order of the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC) Chief Commander. Former Chief of the Imam Hossein Cadet College (2018-June 2020). Former Deputy Commander of the Basij (2009-2018). Former Head of the IRGC's Seyyed al-Shohada Corps, Tehran province (until February 2010). The Seyyed al-Shohada Corps is in charge of security in Tehran province and played a key role in the brutal repression of protesters in 2009.	12.4.2011
8.	MOTLAGH Bahram Hosseini بهرام حسینی مطلق	Gender: male Nationality: Iranian Rank: Brigadier-General Position: Member of the teaching staff of Imam Hossein University (Guardians of the Revolution) (a.k.a. Imam Hussein University) and Head of the planning and operations department of the General Staff of the Armed Forces	Member of the teaching staff of Imam Hossein University (Guardians of the Revolution) and Head of the planning and operations department of the General Staff of the Armed Forces. Former Head of the Army Command and General Staff College (DAFOOS). Former Head of the Seyyed al-Shohada Corps of the Islamic Revolutionary Guard Corps, Tehran province. The Seyyed al-Shohada Corps played a key role in organising the repression of protests in 2009.	12.4.2011
10.	RADAN Ahmad-Reza احمدرضا رادان	POB: Isfahan (Iran) DOB: 1963 Gender: male Nationality: Iranian Position: Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF)	Since January 2023, Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF), also referred to as the Iranian national police. Former Head of the Centre for Strategic Studies of the Iranian LEF, a body linked to the LEF. Deputy Chief of the LEF from 2008 until June 2014. In that position, Radan was responsible for beatings, murder, and arbitrary arrests and detentions of protestors that were committed by the police forces. As a former Commander of the Islamic Revolutionary Guard Corps, he was in charge of training Iraqi "anti-terrorist" forces.	12.4.2011

13.	TAEB Hossein حسین طائب	POB: Tehran (Iran) DOB: 1963 Gender: male Nationality: Iranian Position: advisor to the Commander-in-Chief of the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC)	Since 2022, advisor to the Commander-in-Chief of the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC), Hossein Salami. Former Head of the IRGC intelligence organisation (October 2009 to June 2022). His responsibilities were expanded in May 2019 with the merging of the Office of the Deputy of Strategic Intelligence of the IRGC and the IRGC's Intelligence Organisation. Commander of the Basij until October 2009. Forces under his command participated in mass beatings, murders, detentions and tortures of peaceful protestors.	12.4.2011
45.	JOKAR Mohammad Saleh محمد صالح جوکار	POB: Yazd (Iran) DOB: 1957 Gender: male Nationality: Iranian Position: Member of Parliament for the province of Yazd and Chairman of the Internal Affairs Commission and Parliamentary Councils	Member of Parliament for the province of Yazd and Chairman of the Internal Affairs Commission and Parliamentary Councils. General of the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC) and former Deputy for Parliamentary Affairs of the IRGC. From 2011 to 2016, Member of Parliament for the province of Yazd and Member of the Parliamentary Committee for National Security and Foreign Policy. Former Commander of Student Basij Forces. In that role, he was actively involved in suppressing protests and indoctrinating children and young people with a view to continuing suppression of free speech and dissent. As a Member of the Parliamentary Committee for National Security and Foreign Policy, he publicly supported the suppression of opposition to the government and its repressive policies. After the death of Mahsa Amini in 2022, he played a central role in proposing amendments to the parliamentary election law designed to empower hardliners in parliamentary elections and shut down the demands of protestors.	10.10.2011
51.	SALARKIA Mahmoud محمود سالارکیا	Gender: male Nationality: Iranian	Mahmoud Salarkia is currently working as a lawyer and continues to suppress individual rights of the Iranian citizens in defence of the regime's repressive policies. He figures on the list of lawyers competent under Article 48 of the Iranian criminal procedure code, on the basis of which the defendants of some political and security crimes are denied the choice of a lawyer during the interrogation and investigation stages by the prosecutor's office. Former Head of the Petrol and Transport Commission of the City of Tehran. Deputy to the Prosecutor-General of Tehran for Prison Affairs during the crackdown of 2009. In that position, he was directly responsible for many of the arrest warrants against innocent, peaceful protesters and activists. Many reports from human rights defenders show that virtually all those arrested were, on Salarkia's instruction, held incommunicado without access to their lawyer or families, and without charge, for varying lengths of time, often in conditions amounting to enforced disappearance. Often the families of those arrested were not notified of the arrest.	10.10.2011

83.	JAFARI Asadollah اسدالله جعفری	Gender: male Nationality: Iranian Position: Head of the Judicial Administration in Isfahan and Head of the Resistance Economy Headquarters	Head of the Judicial Administration in Isfahan and Head of the Resistance Economy Headquarters. Former Attorney General in Isfahan. In that position, he ordered violent reactions against protesters who took to the streets in November 2021 to protest against water shortages. According to some reports, Asadollah Jafari has announced the formation of a special office to investigate the arrested protesters and he ordered the condemnation of some protesters involved in the 2022 protests. From 2017 to 2021, he held the position of Attorney General in North Khorasan province. As former Prosecutor of Mazandaran province (2006-2017), Jafari recommended the imposition of the death penalty in cases he prosecuted, which has resulted in many executions including public executions, and in circumstances where the imposition of the death penalty is contrary to international human rights, including by being disproportionate and excessive punishment. Jafari has also been responsible for illegal arrests and violations of the rights of Baha'i detainees from initial arrest to keeping them in solitary confinement in the Intelligence Detention Centre.	12.3.2013
